

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-32

263.

**MIHALLAQ  
QILLERI**

**DEBIMI**

**IHIJEVE**

**NOVELE ETREGJME**


814-52

IV/63

MIHALLAQ QILLERI

# DEBIMI I HIJEVE

*Novelë e tregime*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KËNGË E NGROHUR NËN SHARK

### I

Mëngjesi zbardhi i vrenjtur. Një natë më parë qielli ishte qartësuar, dhe yjet e largëta kishin mbirë në hapësirën blu. Por, kur u gdhi, u pa që dëbora kishte rënë tinëz, kishte shkrirë përsëri dhe vetëm në anët perëndimore të çatave kishte lënë gjurmë të bardha. Tani dielli dilte e fshihej prapa reve të mëdha e të zeza që vozisnin në qiell. Më pas gjithçka u errësuar. Frynte erë e lehtë dhe e ftohtë. Dalgandalë mjegulla la malet dhe u shty më poshtë mbi fshat. Era solli me vete një shtrat dëbore kokërrimë. Julia shikonte nga dritarja se si hidheshin harabelët e vegjël sa nga një plis te tjetri. Gropëzat e tokës së punuar u zbardhën.

Përballë dukej shkolla, dyqani dhe një cep i godinës së furrës. Drurët e gjatë e të zhveshur, me degët që u lëkundeshin lehtë nga era, filluan të visheshin ngadalë me dëborë. Një gushkuq qëndroi në parvazin e dritares, cicëriu me ankim dhe fluturoi mbi një degë ferre. Toka u zbardh krejt. Vetëm kërcenjët e barit të korrur gjatë verës nxinin akoma. Soba kërciste lehtë dhe nën rrathët e sipërm dalloheshin gjuhëzat e kuqe të flakës. Dhoma ishte errësuar. Julia mënjanoi perdet. Korenti ishte prerë na-

tën. Në sobë drutë e djegur u shembën dhe zjarri u gjallërua akoma më shumë.

Ra zilja e shkollës.

Julia u kujtua se atë orë kishte mësim në klasën e gjashtë dhe u ngrit të dilte. Dëbora e kishte tërhequr gati si një fëmijë. Në qytetin e saj bregdetar nuk binte kurrë dëborë. E shumta, në dimrat e vështirë, kokërrizat e dendura të breshrit formonin mbi asfaltin e rrugëve një shtresë të hollë, që zhdukej pas disa minutash. Veshi shoshonet, pallton, lidhi pas qafës një shall të leshtë dhe mori çantën. Te pragu i shtëpisë u kujtua për çadrën. Por... Buzëqeshi me vete dhe hodhi hapin e parë. Dëbora kishte nisur të binte flokërendë. Në rrugë gjurmët e saj linin brazda të stërgjatura, ngaqë dëbora ishte akoma shumë e butë.

Oborri i shkollës gumëzhinte. Ajo qëndroi një çast në hyrje të tij. Topat e dëborës fluturonin mbi kokat e nxënësve. Kishte rrezik të thyhej ndonjë xham. Mësuese Julia ishte gati të ndërhynte, që nxënësit të pushonin lojën, por vuri re e habitur se bashkë me ta luanin edhe mësuesit. Maria, për shembull, kishte zënë kokën me duar dhe, me supe të mbledhura, priste që Jani ta godiste me topin e dëborës. Ajo, nga frika, vazhdoi të ecte ngadalë, thua se tinëz, mirëpo kaloi gjithë oborrin pa u prekur. Pas xhamit të sallës së mësuesve vuri re fytyrën e ngushtë me buzë të mbledhura të mësuesit të letërsisë. Ai, herë pas here, me gishtin dëftues të dorës së djathtë ngrinte syzet e bardha. Julia i pa këto të gjitha vetëm në dy-tri minuta dhe për herë të parë ndjeu një farë keqardhjeje për të; iu duk fare i vetmuar mes gjithë asaj hareje që kishte pushtuar shkollën. Sa hapi derën e sallës së mësuesve, pa shpinën

masive të Fatmirit, që ato çaste kishte kryqëzuar duart dhe përplaste lehtë këmbën e majtë. Salla ishte gjysmë e errët. Siç duket, ai nuk e ndjeu që u hap dera, sepse vazhdonte të qëndronte akoma me fytyrë nga dritarja. Pikërisht atë çast një top dëbore kërciti në dritare dhe mësuesi u hodh përpjetë. Julia buzëqeshi.

— Çmenduri!, — klithi befas ai.

— Bukur, hë?, — pyeti atë çast Julia duke qeshur.

Ai u kthye rrëmbimthi drejt saj dhe rregulloi syzet.

— Bukur?!, — tha pa e dalluar akoma mirë atë që foli. Bardhësia e dëborës i kishte vrarë sytë miopë. Dalngadalë figura që qëndronte përballë tij u lëkund dhe ai shpejt dalloj Julinë. — Ju thatë «bukur»?

— E pse jo?, — vazhdonte të buzëqeshte Julia. — Vetëm ti nuk paske dalë të luash.

— Të luaj?! Edhe ju... as ju nuk ju pashë... Të luaj? — Ai mblodhi buzët me përçmim.

Ajo iu afrua më pranë.

*Ky djalë, njëzet e shtatë vjeç, trupgjatë, fytyrimtë, me flokë të verdhë të shkurtër, që i mbante të krehur përpjetë, kishte ardhur në atë fshat më 30 gusht, një ditë pas Julisë. Pesë vjet me radhë pat dhënë mësim në qytetin e tij të lindjes dhe tani e kishin transferuar këtu. Ai erdhi krejt i heshtur, — kishte buzëqeshur vetëm kur i patën thënë se disa net do të flinte së bashku me shokët në një barrakë të bonifikimit, — dhe i heshtur mbeti për pesë muaj me radhë. Flitej se shkruante poezi, por gjatë atyre pesë muajve nuk kishte botuar asnjë. Në dhomë flinte së bashku me dy shokë të tjerë, por gatuante veç, hante ve-*

tëm në pjatat e tij, pinte ujë me gotën e tij, dhe duhani e nervozonte. Orët e tij të mësimit ishin një model i përsosur, dhe drejtoresha shpesh druhej të hynte për kontroll tek ai.

Këto të gjitha Julisë i kaluan nëpër mend vetëtimthi dhe vetëm tani ajo besoi gjithçka. Mund mos të të pëlqejë muhabeti me dy shokë, mund të jesh nazeli në të ngrënë, por mos të të pëlqejë loja e gjithë shkollës, në një ditë aq të bukur, ç'dreq poeti të jesh ti?

— Ti duhej të dilje, Miri!, — i tha ajo, duke e kapur lehtë nga cepi i mëngës së palltos. — Është vërtet shumë bukur! Fshati i murmë është zbardhur... Ti shkruan dhe...

— Këto i ndiej edhe unë, — u përgjigj ai kokulur. Kjo vajzë gjithmonë e mundte me logjikën e saj. — Virgjëria e dëborës së parë, ja ç'duhet të jetë e bukur. Kurse këta, — ai tregoi me gisht nxënësit që luanin përjashta, — këta e ndyjnë këtë virgjëri... Ja ç'desha të them. Ndoshta nuk e shpreha drejt mendimin... Ju... ti, më kuptove? — Vështroi orën, dhe duke mos mundur të dallonte qartë akrepat, u afrua pranë dritares. Kërciti një top dëbore. Kësaj radhe xhami krisi dhe në sipërfaqen e tij shkanë rrëke me copëza dëbore të butë.

— Vandalizëm!, — klithi përsëri mësuesi i letërsisë. — Po tani? Kush e ka shërbimin sot, xhanëm? Pse nuk i bien ziles? Kaloi dy minuta!

Julia i ktheu shpinën dhe doli. Në korridor, mbi një tavolinë, ishte vendosur zilja e shkollës, një zile e vogël bronci. Ajo i ra. Tingujt shtuan një çast zhurmën e nxënësve, që shpejtonin të hidhnin, kush e kush më parë, topat e fundit të dëborës... Pastaj ra qetësi... Dëbora vazhdonte të binte flokërendë.

## II.

Pas mësimit Fatmiri doli i fundit nga shkolla. Zbriti deri afër xhadesë së makinës, pastaj iu kthye mendja dhe nisi të ngjitej në pjerrësinë e një kodre. Atje dëborë kishte krijuar togje të mëdha mbi përrallet e shkurtra dhe bardhësia të merrte sytë. Fatmiri qëndroi disa minuta duke vështruar peisazhin. Pastaj, me bishtin e çadrës vizatoi në dëborë dy iniciallet e emrit të tij. Këtë e bëri aq i druajtur, sa më pas u pendua që çënoi bardhësinë.

Në dhomë, Jani kishte ndezur zjarrin në oxhak dhe po skuqte vezë. Ja, kështu i ndodhte gjithmonë. Fatmiri do të mbetej i fundit për të gatuar. Ndërkohë shtrihej në krevat dhe lexonte diçka. Por atë ditë nuk i pëlqente të shtrihej. Doli përsëri jashtë. Që në prag të derës vuri re se si lugjet e tjegullave të çatisë kishin nisur të formonin stalaktite të akullta. Gorrica, atje tej, ishte rënduar aq shumë me dëborë, sa ngjante me një çadër të bardhë.

— Mbarova!, — tha Jani, duke i rënë lehtë në sup. — Eja të gatuash. Zjarr ka plot.

— Po, — iu përgjigj ai pa kthyer kurrizin.

Gjysmë ore më vonë ai ishte shtrirë në krevat dhe shikonte tavanin me duar të kryqëzuara nën kokë. I pëlqente kjo qetësi, që pushtonte aq rrallë dhomën e tyre. Zakonisht aty bëhej zhurmë dhe ai inatosej për hijgjë. Jani me Gjarin i dukeshin tipa tepër të ekzaltuar, që grindeshin për gjëra të vogla. Natyrisht që, nga të dy, Jani i pëlqente më shumë. Të paktën, ai lexonte letërsi artistike dhe kjo për Fatmirin kishte shumë rëndësi. Sa për Gjarin, ai dukej sikur nuk çante kokën për asgjë më shumë sesa për orët e mësimit. Thua jse gati çdo ditë zhdukej

nga dhoma dhe, kur kthehej, tregonte ndodhira nga jeta e fshatit. Kishte raste kur në dhomën e tyre vinin edhe vajzat. Maria i ngjante Gjarit, ndërsa me Julinë ndryshonte puna. Ai e ndiente se ajo kishte një zemër të butë e të bardhë, «ja, ashtu si dëborë», mendoi Fatmiri. Megjithatë edhe asaj sikur i pëlqente zhurma, sepse të qeshurën e kishte në majë të buzëve.

Ai u kthye përmbys. Mbi kokë të krevatit ishte dritarja e vogël me dy shufra hekuri paralele. Dikur këtu ishte shkolla e vjetër, vetëm me dy klasa kolektive, ndërsa tani që u bë e reja, njërën nga dhomat ua liruan arsimtarëve. Kurse vajzat flinin në një familje të fshatit. Nga dritarja ai po shikonte tani vijën e përthyer të kodrës, ku ishte ngritur njëra nga lagjet e sipërme. Konturi ishte fare i zbetë, sepse kodra dhe qielli kishin gati të njëjtën ngjyrë. Ja, të rrije kështu, shtrirë, dhe të mendoje... të mendoje... të mendoje pa pushim, ishte padyshim kënaqësia më e madhe.

Fatmiri ndjeu se Jani u ngrit nga shtrati. Zgjati dorën dhe mori nga parvazi i dritares syzet. Pa se si ai veshi këpucët, pallton, lëmoi me dorë flokët e verdhë dhe u pa në pasqyrën mbi oxhak.

— Unë po dal, — i tha ai Fatmirit. — Në vatrën e kulturës bëhen provat për festivalin. Fillojnë në orën katër. Nuk do të vish?

— Jo, — iu përgjigj shkurt Fatmiri.

Jani hapi derën. Në prag të saj qëndroi gjatë me duar në xhepa, duke vështruar diçka përtej oborrit.

— Po zbresin edhe vajzat, — tha ai.

Si nuk mori përgjigje, mbylli derën dhe doli.

Tani po! Mund të rrije dy a tri orë fare i qetë.



Të lexoje pa të shqetësuar njeri. Bile dhe mund të shkruaje. Kjo bardhësi dëbore, ku nuk dallohej asnjë gjurmë, kishte në vetvete diçka nga qetësia e shpirtit. Mendimi nuk përplaslet gjëkund; vetëm fluturon, ulet e ngrihet, dridhet e ngrohet, kënaqet e hidhërohet... Vetmi... Por befasi ai u drodh. «Jo! Kjo nuk bën pjesë në natyrën njerëzore. Gjersa rreh një zemër, shfryn një vullkan», — tha ai me vete. Ky mendim iu duk i saktë dhe shpejtoi ta shënonte. Në të thelluarën e dritares ishin rradhitur librat dhe fletoret e tij. Blloku i shënimeve me kapakë blu ishte në cepin tjetër. Zgjati dorën dhe e mori.

Befasi dikush trokiti në derë. Fatmiri futi shpejt e shpejt nën jastëk bllokun e vogël dhe u kthye në njërin krah. Kushdo që të ishte, atij nuk i pëlqente kjo vizitë. Për disa sekonda me radhë heshti. Trokitën përsëri. Pastaj dera u hap dhe në prag të saj u dha Petriti, elektrikisti i fshatit. Ai buzëqeshi që atje tej. Zgjati dorën dhe rrotulloi çelësin e dritave. Dhoma u ndriçua.

— Si u ngryse, profesor?, — tha Petriti.

— Mirë.

— Të qenka shuar fare edhe zjarri! Nuk mbërdhin?

— Jo.

Petriti fërkoj duart. Ishte lagur. Opingat i llokoçitnin, dhe që atje tej mund t'ia dalloje pantallonat e lagura. Mbi vetullën e djathtë kishte zënë vend një flokëz dëbore që i rëndonte shikimin. Ai ishte një burrë trupvogël rreth të tridhjetave, i dobët, një grusht njeri, siç thoshte vetë, kurse Gjari mendonte se nuk duhej të peshonte më shumë se një thes me çimento. Po ishte shpuzë! Ja, tani kushedi se nga vinte. Linjat elektrike zgjateshin mbi një re-

liev tepër të thyer dhe, që të vërtetonte difektin, duhej të ngjiste dhe të zbriste shumë kilometra rrugë. Dhe në dimër kjo ndodhte shpesh. Në verë ndryshonte puna, ndaj edhe fshati i kishte ngarkuar edhe vatrën e kulturës.

Tërhoqi me zhurmë një karrige dhe e vendosi pranë oxhakut. Mblodhi njërën mbi tjetrën copat e druve të mbetura në vatër dhe me majën e gishtit grumbulloi një e nga një thëngjijtë e ndezur poshtë tyre. Pastaj u fryu e u fryu, derisa zjarri u ndez. Gjithë këtë punë e bëri pa folur. Kur flaka mori për-pjetë oxhakun, hoqi opingat dhe drejtoi nga zjarri tabanet e lagura.

— U plevitosa, beson? Në Mallkeq e gjeta. . .

— Çfarë?

— Difektin. Ishin përdredhur dy tela. . .

Petriti zgjati duart e vogla drejt flakëzës e luajti ca minuta me të. Mundohej të rrëmbente një grusht flakë.

— E di përse erdha?, — tha pastaj.

Fatmiri e vështroi drejt në sy.

— Jo, — tha.

— Kemi një hall dhe vetëm ti mund të na ndihmosh. Më kanë thënë se bën vjersha. Tani, për festivalin, na duhen ca tekste të reja këngësh. Si thua?

Fatmiri u mendua.

— Do të mundohem, — iu përgjigj, pa e parë drejt në sy.

— Tani. . . ti e di vetë. Ç'të të mësoj unë! Jo dritat, jo shkolla e re, jo gruri që vitin e kaluar u bë si asnjëherë tjetër, jo bagëtia. . . Punët e fshatit, me një fjalë! Se ishim shumë të varfër dikur dhe tani kemi bërë shumë.

— Do të mundohem. . . , — tha përsëri Fatmiri.

— Unë tani po iki. Janë mbledhur poshtë për provat. Ti, po të duash, eja. . .

— Kam punë, — tha Fatmiri. — Të tjerët atje kanë vajtur.

— I pashë. Që andej vij. Nga Mallkeqi në vatër të kulturës. Jani më dërgoi te ti. . .

— Jani?

— Edhe Julia. Të dy bashkë.

Ai tundi kokën në mënyrë të pakuftueshme.

Petriti mbathi opingat dhe iku.

Zjarri kishte marrë përpjetë dhe dhoma ishte ngrohur mirë. Fatmiri u zbulua. Dëbora kryqëzohej nga hekurat e dritares dhe formoheshin kështu katrorë të shumtë. Sa u mbyll dera, ai u afrua më pranë dritares. Po mugej. Fshati dukej sikur kishte rënë në gjumë. Ditët ishin të shkurtra, ndërsa netët mezi mbaronin. Kërciti një dru në vatër dhe një shkëndijë u shkëput nga zjarri e ra mbi krevat të Gjarit. Ai e dalloj dhe u ngrit ta shuante. Pastaj u shtri përsëri dhe vështroi jashtë. Pejsazhi ishte po aty, veç pak më i errët. Dëbora binte e rrallë. Në majë të kodrës përballë ishte ndezur një dritë elektrike. Shkëlqimi i saj vinte i zbetë në sytë e tij dhe rreth dritës ishte krijuar një rreth i kuq, siç ndodh ngandonjëherë me hënën, kur qielli nuk është fare i pastër. U mundua të shkruante diçka për këtë pamje të re, por e ndjeu se mendimi diku pengohej. Pra, nuk ishte aq i lirë sa pat menduar aty më parë. Pështjellimi shtohej. Me kalimin e kohës, e ndiente se dhoma do të mbushej me zërat e shokëve dhe. . . lamtumirë qetësi! Kjo e nervozonte. Shkroi e shoi disa vargje. Koka iu rëndua. Hoqi syzet dhe fshiu sytë me dorë. Ora po i afro-

hej gjashtës dhe ai nuk kishte bërë as ditarin për të nesërmen.

Kur erdhi Gjari, ai po lexonte. Zjarri kishte marrë për bukuri dhe Gjari e mburri:

— Kur e di se dikush të pret në dhomë, të kënaqet shpirti. Ka lezet! Të paktën, ngopesh me zjarr. Megjithatë, edhe ti mund të mos ndaheshe nga shokët... Dëbora mezi çahet. Ra shumë, djalli e mori!

— Unë do të doja të mos pushonte kurrë!

— Flet për vete, më duket!, — ia ktheu Gjari.

— Po fshatarëve, që po u ngordh bagëtia brenda?

— Pse?

— Se nuk kanë ç'të hanë! Në dëborë nuk duket asnjë fije bari.

Fatmiri tundi kokën dhe mblodhi supet.

— Të tha gjë Petriti?, — pyeti Gjari.

— Po...

— Do të bësh gjë?

— Do të mundohem.

— Duhet shpejt, — tha Gjari. — Sa të mësohen këngët...

— Nuk janë simite, — ia ktheu Fatmiri. — Kjo punë do qetësi dhe frymëzim. U mundova të shkruaja diçka sa iku Petriti, po ishte punë që s'bëhej! Ngandonjëherë edhe një xixë që shkëputet nga zjarri të prish punë...

— Nuk e mendoja aq të vështirë!

Fatmiri nuk iu përgjigj.

Jani erdhi me vajzat. Maria mbante në dorë një top dëbore dhe, sa hyri ia vërviti Fatmiri.

— Ke luajtur?, — thirri ai.

— Akoma jo, — tha Maria duke qeshur.

Julia e shikonte dhe shtrëngonte buzët. «Pse kaq

qull ky njeri, xhanëm?!», — mendonte ajo. Megjithatë i vinte keq për të.

— Të rrimë për darkë?, — pyeti Maria. — Ç'do të na gatuani?

— Na gatuani ju, — tha Gjari. — Harxhet i vëmë ne. Kemi makarona, oriz, vezë, djathë, gjalpë... .

— Mjaft, se u bërë inventarin, — thirri Fatmiri.

— U turpërova!, — ia ktheu Gjari. — Se mos kanë këto më shumë!

— Keni miell?, — pyeti Maria.

— Po, — tha Jani. — Për petulla?

— Të bëjmë byrek. Njëzet petë i holloj brenda gjysmë ore.

Me të thënë e me të bërë. Fatmiri nuk luajti nga vendi. Julia iu afrua pranë.

— Bëj një këngë për fshatin, — i tha ajo. — Veç, qaje... !

— O byreku, o kënga!, — iu përgjigj ai.

— Të ikim ne?!, — u habit ajo.

Nuk e thashë atë fjalë. Veç këtu bëhet aq shumë zhurmë, sa nuk mund të përqëndrohesh dot.

— E mirë, lëre për nesër, a derëbardhë!

Vajzat ikën vonë. I përcolli Jani. Maria nguli këmbë që t'i përcillte Fatmiri, po ai nuk u përgjigj. Veç u zëmërua. Tha se nuk lejonte njeri të tallej me të!

Gjari u ul këmbëkryq mbi vatër. Ishte një djalë njëzet e pesë vjeç, truplartë, ballëgjerë, që gjithë dimrit vishej hollë. Në mëngjes lahej në çesmë i zhveshur deri në brez, pastaj vraponte ndonjë gjysmë orë të mirë kodrave. Në fillim Fatmirit i ishte dukur fare çapraz, por më pas, kur e njohu mirë, ndryshoi mendim. Për shoqërinë linte kokën, por ja që nuk kishte një çikë finesë. Si mësues, duhej ta mbante

veten pakëz më mirë dhe të ruante autoritetin. «Ndryshe, — mendonte në fillim Fatmiri, — nxënësi s'ta var dhe puna të shkon kot!» Mirëpo në fund të semestrit të parë klasa e tij kishte kaluar e gjitha dhe drejtoresha e tregonte si shembull. Kjo i kishte bërë përshtypje Fatmirit. Megjithatë, atë njeri akoma nuk e kuptonte.

— Ç'numër ishte ai Batua, more!, — i tha Jani Fatmirit. — Na shkriu, për nder!

— I mrekullueshëm!, — tha Gjari. — Çoban mali, a derëzi! Gjithë shëndet. Ta them unë, që edhe zemrën të pastër e ka!

— Veç ta dëgjoje, Miri!, — vazhdoi Jani. — Sajoi, aty për aty, një këngë, që na la të gjithë gojëhapur. Pa kur ia mori vetë, për nder, të kënaqte!

— E njoh unë?, — pyeti Fatmiri.

— Duhet ta kesh parë, — tha Gjari, — ka ardhur nja dy herë edhe në shkollë. Ka një motër të vogël në klasën e Maries. Alketa e quajnë.

— Nuk e njoh. . . Bën vjersha the?

— Do të thosha, këngë!, — iu përgjigj Jani. — Me atë gjuhë të bukur, gjithë figura. . .

— As i mohon njeri vlerat. . ., — tha Fatmiri. — Veç, disa poetë popullorë përsëritin njëri-tjetrin. . .

— Për nder, Batua është shumë origjinal!, — tha Gjari. — Unë nuk marr vesh shumë nga letërsia, po vjershat e tij më pëlqejnë. Unë do ta quaja, pa frikë, poet!

— Ka shumë kohë çoban ai?, — pyeti Fatmiri.

— Kushedi, — iu përgjigj Gjari. — Vetëm se është djalë i ri. Në moshën tënde mund të jetë. . .

Jani qeshi befas.

— I lezeçëm!, — tha ai. — Nuk do t'i harroj ato

dy vargje që i thuri aty për aty dhe ia tha Maries, kur po dilnin nga vatra e kulturës:

*Ika, moj, të mbledh stanin,  
Në dëborë ma ngroh ti xhanin. . .*

— Qenka dhe shakaxhi!, — tha Fatmiri.

— Lëre ç'është!, — ia ktheu Jani. — Kur dolëm jashtë më kapi për krahu dhe, si më futi një copë herë nën shark, më pëshpëriti: «Mos ma keqkuptojë ajo mësuesja, more?» E sigurova se nuk do ta keqkuptonte njeri.

Një copë herë heshtën. Fatmiri kishte lënë mënjane librin dhe mundohej të përfytyronte Baton. Kurrë nuk kishte njohur një çoban të vërtetë! Shumë fshatarë kishte dëgjuar të thoshin se në të kaluarën gjithë jetën e ngrysnin dhe gdhinin maleve me pak kokë bagëti, por, se si ishte në të vërtetë jeta e tyre, ai nuk e përfytyronte dot!

— Dhe iku në stan?, — pyeti befas ai.

— Po, — tha Gjari. — Iku.

— Edhe tani në janar ka bagëti në mal?

— I zbresin më poshtë, — iu përgjigj Gjari. — Dhentë i dimërojnë në Vrinë, ndërsa dhitë i mbajnë këtu. . . Nën Shpat te Maret.

— Po kjo dëborë?

— Keq e kanë punën me të. Ndjaj të thashë qëparë se kjo kohë është e rrezikshme për bagëtinë...

— Nuk pushoi akoma?

— Bie më pak, — tha Jani duke vështruar nga dritarja. — Flëmë tani? Vdiqa për gjumë!

Fatmiri u zhvesh dhe u shtri. Po gjumi nuk po i vinte. Në fantazinë e tij nisën të ndriçoheshin ca kuadro të bardhë. Batoja, i mbuluar me shark, ecte nëpër dëborë me gazin e tij shpotitës në buzë.

### III.

Disa ditë më vonë koha u qetësua. Qielli u kaltërua dhe dëbora e trashë reflektonte mijëra vezullime. Bënte shumë ftohtë. Fshatarët kishin nisur t'ua shkundnin përralleve dëborën dhe të prisnin prej tyre degë për bagëtinë.

Në mbrëmje dielli ulej mbi malin që ndante krahinën nga bregdeti. Ky ishte një mal jo shumë i lartë, i dhëmbëzuar, me kurriz të stërgjatur, thuajse pa maja të mprehta, që tani, në ditët e pastra të fundit të janarit, në mëngjes, kur mbi të përplasen rrezet e para të diellit, afrohet fare pranë, ndërsa në mbrëmje duket si një udhëtar vigan që largohet nëpër muzg, drejt perëndimit, me diellin mbi shpinë...

Fatmiri i vështronte të gjitha këto nga pragu i derës së dhomës. Mbrëmja po vinte e qetë dhe shumë e ftohtë. Ai kishte ngritur jakën e palltos, por e ndiente se fytyra po i thahej, sytë i lotonin dhe gishtat e këmbëve i ngrinin. Jani me Gjarin kishin shkuar në vatrën e kulturës për provat përfundimtare. Thanë se atë mbrëmje shfaqja do të jepej e plotë para gjithë fshatit. Tekstin e një kënge për fshatin që kishte shkruar vetë, ia kishte dhënë Petritit tri ditë më parë. Julisë i kishte pëlqyer shumë. Ishte po ky peisazh madhështor që shikonte tani, i vizatur me fjalë të bukura... Vetë Fatmiri kishte mbetur mjaft i kënaqur. E kishte shkruar gati me një frymë e më pas i kishte limuar frazat. Besonte se nuk kishte krijuar gjë tjetër më të bukur...

Duke qëndruar në prag të derës së dhomës, shikonte se si fshatarët zbrisnin rrugëve të pjerrëta të lagjeve për në qendër të fshatit. Në të vërtetë, ajo nuk mund të quhej akoma qendër por drejt saj po



synonte. Shtëpitë e reja po ngriheshin në të dyja anët e rrugës automobilistike, duke vënë në mes dyqanin, sallën e kulturës, shkollën e re dhe furrën e bukës. Ai mendonte për të gjitha këto dhe e ndiente se atë ditë duhej të shkonte ta shikonte shfaqjen. Së paku, për këngën e vet...

Në pjerrësinë e rrugës së akullt këpucët i shkisnin dhe ai, për të mos rënë, mbahej nga degët e dru-rëve. Para sallës së kulturës Fatmirin e takuan disa fshatarë, e pyetën për shëndetin, për njerëzit e shtëpisë dhe ai e ndjeu se këta njerëz ishin mjaft të afrueshëm. Vetëm se e ndiente veten keq, ngaqë s'dinte ta zgjaste më tej muhabetin. Vështroi rreth e rrotull për të parë ndonjë nga shokët, por nuk i zuri syri njeri. Siç dukej, duhej të ishin brenda. Ndërko-hë gjindja po shtohet dhe pas pak ai dalloj të afrohej një djalë i shëndetshëm, faqekuq, me një palë mustaqe të holla mbi buzë, mbuluar me shark të zi, që zbriste nga rruga kundruall dhe lëshonte ca fjalë gjithë romuze.


— Erdhi edhe Batua!, — tha njëri nga fshatarët.

Fatmiri e vështroi me kureshtje.

— Si u ngrysët!, — tha Batoja me zë të fortë dhe u fut brenda.

Pas pak hynë edhe të tjerët. Fatmiri mbeti një çast në derë të sallës. Së andejmi dalloj Julinë. Ajo i bëri shenjë të shkonte afër saj. Ai ngurroi disa minuta; duhej të kalonte përmes një rreshti të mbushur plot. Po rrugë tjetër nuk gjeti dhe, sa të rrinte në këmbë gjatë gjithë shfaqjes, shkoi pranë saj.

— I kam ndjekur pothuajse të gjitha provat, —



tha Julia. — Vetëm më mbeti merak që nuk e dëgjo-  
va dot mbrëmë këngën që ke shkruar ti...

— Vetëm këngë e valle popullore kanë?

— Natyrisht. Prgatitja bëhet për festivalin fol-  
klorik të rrethit... juria vlerëson edhe tekstet e kë-  
ngëve. Unë të thashë edhe dje.... Ajo që shkrove ti  
ishtë e bukur!

Ai ngriti supet, dhe hodhi vështrimin nëpër sallë.  
Ishtë e gjatë dhe e ngushtë. Kishte hyrë nja dy-tri  
herë aty, por atë ditë i bëri përshtypje gjallëria e saj.  
Interesimi i njerëzve për shfaqjen ishtë i madh. Nga  
fragmentet e bisedave mund të kuptoje preokupimin  
e tyre. I bëri përshtypje gjithashtu që në radhën e  
parë ishin ulur pleqtë e fshatit. Jani e Gjari nuk po  
dukeshin gjëkund. Dëgjoheshin këmbë pas perdes,  
dhe një fisarmonikë binte lehtë.

— Po të tjerët?, — pyeti ai Julinë për arsimta-  
rët.

— Janë në skenë. Do të doja të veja edhe unë,  
por u druajta. Si të them? Kur nuk je aktivizuar ndo-  
njëherë....

— Sikur të jepje programin?

Julia u skuq.

— Ata e kanë prgatitur me kohë spikeren, — tha  
ajo. — Është një vajzë e shkathët, që flet mjaft mi-  
rë.

U lëkund perdja. Aty ku pritej spikerja, doli Pe-  
triti. Duke vështruar në një pikë, diku mbi kokat e  
njerëzve, u mendua një hop, pastaj tha:

• Para se të fillojmë do t'ju luteshim të men-  
donit të gjithë për shfaqjen. Në fund, është mirë që  
gjithsecili të na thotë fjalën e vet. Dakord?

— Dakoord!!!, — u dëgjuan thirrje nga salla.

— ... dhe tani mbani qetësi...

Pleqtë, megjithatë, vazhduan edhe disa minuta akoma bisedat e lëna përgjysmë.

Kënga e Fatmirit u këndua e katërta. Julia e vështroi atë në sy dhe dalloi se në faqet e tij, zakonisht të zbeta, ra një i kuq i lehtë. Shumë vetë nga salla kthyen kokën nga mësuesi. Kënga nisi shtruar dhe rreshtat e parë të tekstit, të përsëritur dy herë, shkuan mirë. Më pas kënga nisi të zbehej, e vajza që ia merrte mbeti. Fatmiri ndjeu pakënaqësi. Nuk ndërhyri. Pleqtë nisën të bënin zhurmë dhe qetësia u prish. Dikush duhej të kishte folur pas perdes, sepse disa nga vajzat që këndonin, kthyen kokën andej...

— Nuk shkon... — tha befaz me zë të lartë e duke ngritur supet vajza që ia merrte.

— Edhe një herë!, — u ngrit e tha njëri nga pleqtë. — Dhe thoni se janë provat e fundit.

Kënga filloi përsëri, po zërat nuk përputheshin më. Shpejt e kuptuan të gjithë se kjo vinte ngaqë fjalët nuk shkonin me ritmin e këngës.

Befaz perdja u mbyll. Në skenë u ndien zëra. Edhe në sallë po ashtu. Julia përdridhte duart me njëra-tjetrën. Fatmiri rrinte si mbi gjemba. I vinte të fuste kokën përfund karrigeve, që të mos e shikonte më njeri...

Pas disa minutash perdja u hap përsëri. Ishte po ai grup vajzash. Veç tani, që pa filluar, ato ndiheshin aq të sigurta, sa buzëqeshnin. Kënga e dytë për fshatin ishte e Batos, «Kur dola në brinjë të malit».

Ajo që filloi pas pak, ishte me të vërtetë një shpërthim gëzimi. Vërshimi i këngës derdhej nga

brinja e malit dhe binte mbi fshat si rreze të ngrohta dielli. Vajza ia merrte me një zë të kthjellët. Isoja madhështore përhapej si një prarim pranvere, që vjen papritur. Nëpër rreshtat e këngës shikimi ulej nga lart poshtë e shtrihej në luginë:

*Kur dola në brinjë të malit,  
Fshatin pashë, njëqind shtëpi,  
Ku kish ferra dhe kasolle,  
Lulëzonte gruri i ri...*

...

*Kur dola në brinjë të malit,  
I rashë fyellit me gëzim,  
Deshtë tundënë këmborët,  
E kuptuan gazin tim...*

Salla dëgjonte e përpirë. Julia e përfytyronte veten në ato lartësi ku dëborat nuk shkrin kurrë, dhe çobanin Bato, të rrethuar nga bagëtia e tij, duke shikuar fshatin e bardhë. Njerëzit e kishin harruar dimrin që ishte përjashta dhe u dukej sikur pranvera ishte në prag. Fatmiri mbeti. Jo, këtë nuk e kishte dëgjuar kurrë! Vargu dukej i lehtë në të ndërtuar, po melodia e rëndonte si një kallë guri kokulur. Dhe kjo këngë kërkonte shtratin e saj, të ecte, të vërshonte, të kaltëronte. Ai nuk e njihte akoma atë forcë. Tani sapo e ndjeu, sapo e kuptoi... Forca buronte nga vetë jeta, nga malet, nga gazi shpotitës i Batos dhe deri te kënga e tij. Vështroi Julinë. Përqëndrimi i saj ia shtoi më shumë këto ndjesi. «Ç'duhet tjetër?, — tha me vete dhe shtrëngoi buzët... — Vargje të kaltra, ku lëvizin qiej dhe re të bardha?»

Duartrokitjet e sollën në vete. Sa heshti salla, ai u ngrit e tha:

— E Batos është më e mirë, ajo të mbetet!

Në këto fjalë nuk kishte asnjë lloj smire. Julia e pa e habitur. Ato tri-katër fjalë sikur nuk ishin në natyrën e tij aq monotone e të mjegullt; sikur shkellmuan në një çast një karakter të tërë, sikur e burrrëruan papritur! U ul dhe buzëqeshi. Ç'të thoshte tjetër? Ai ishte mik në atë fshat dhe ndofta dikush mund të përpiquej t'i rregullonte sedrën e fyer. As kjo nuk duhej të ndodhte. Goditja nuk ishte një shkellm që të flak tej. Jo, jo, jo! Përkundrazi. Të afronte më shumë, të tregonte rrugën për te burimi i vërtetë i poezisë... Julia u mat të thoshte diçka, por ai i mbajti dorën. Nuk donte t'i fliste askush. Një dëshirë kishte ato çaste: të përfundonte shfaqja sa më shpejt dhe të takonte Baton.

Gjysmë ore më vonë ai e la Julinë dhe iu afrua skenës. Pleqtë e vështruan gati të gjithë njëherësh dhe ai e ndjeu merakun e tyre. U buzëqeshi. Duke pritur të dilnin ata të grupit, ai filloi një ecejakë të ngadaltë përpara radhës së parë të karrigeve.

— Djalo!, — dëgjoi befas.

Ktheu kokën dhe pa njërin nga pleqtë. Vështrimi i tij iu duk pakëz i mjegullt, mbuluar nga fjollat e tymit që dilnin nga çibuku. Iu afrua. Plaku hodhi këmbën mbi këmbë, lëmoi kupën e gjurit me dorë dhe i drejtoi çibukun e ndezur në gjoks.

— Ti na i mëson mirë kalamajtë, o mësues!, — i tha.

Fatmiri nuk iu përgjigj.

— Edhe këngët i bën të mira, — vazhdoi plaku. Ai fliste me pauza të gjata, dhe mësuesi pati kohë të

mendonte se po mundoheshin t'i përkëdhelnin sedrën. U bë gati t'i kundërshtonte, po plaku nuk e la. — Ta them unë që i bën të mira! Këtë kuvendonim pak më parë... Por ja që nuk të kemi parë kurrë të na shkelësh pragjet... Atëherë do të na i bësh këngët edhe më të mira... Ashtu!, — përfundoi ai dhe çibuku i ndezur u drejtua përsëri në gjoks të mësuesit.

Në hyrje të skenës takoi vajzën që ia mernte këngës. Shkëmbyen një vështrim të shpejtë. Fatmiri e dalloj pozitën e saj dhe pas xhamave të syzeve mund të dalloje se si nëpërmjet shikimit u mundua t'i kërkonte ndjesë. Pas saj doli Batoja. Sharkun e zi e kishte hedhur krahëve. Fatmiri i nxori dorën përpara. Çobani mbajti këmbët.

— Do të doja ta shikoja atë tekst... — tha ai.

Çobani futi dorën nën shark dhe nxori prej andej një fletë fletoreje të palosur më katërsh. Fatmiri e mori në dorë. Letra ishte e ngrohtë dhe mbante një aromë gjethesh të thara.

— Do të ta kthej përsëri!, — tha Fatmiri.

— E di përmendsh, o mësues!, — ia ktheu Batoja.  
— Ndoshta ma rregullon një çikë më mirë...

«Ta rregullonte?» — Fatmiri u hutua pakëz duke vështruar atë fytyrë të gjerë e të zeshkët.

— Nuk i stis dot me gramatikë!, — tha Batoja.  
— Vijnë e më gjëmojnë zemrën, por unë dua të jenë vetëtima, se ti e di që ato gjarpërushe duken me sy e shihen nga të tërë, kurse gjëmimet bëjnë zhurmë e s'lënë vazhdë!

— Falemnderit!, — tha Fatmiri.

Mbi supin e Batos ai dalloj sytë e Gjarit që shkëlqenin nga admirimi. Jani kishte ulur kokën dhe

mënjante me këmbë një bisht cigareje të shuar e të hedhur mbi dysheme. Maria ishte në krah të Fatmirit dhe ia kishte ngulur sytë çobanit Bato. Julia kafshonte gishtin.

Kur dolën nga salla, të ftohtët ishte bërë gjilpërë, ndërsa qielli ishte fare i pastër. Ylli i Mëngjesit varej mbi kurrizin e malit, ndërsa xixëllonja të tjera ndiqnin pas të parin e yjeve...

## NDJEKJA E BISHAVE

Tomi iku dhe unë mbeta vetëm. Shterpasi ato çaste m'u duk aq i zhveshur dhe i ftohtë, sa asnjëherë tjetër. Sezoni i kërkimeve kishte mbaruar papritmas dhe, siç i thonë fjalës, ramë të flinim ngroh të dhe u gdhimë akull. Dëbora e parë erdhi e furishme dhe zuri vend mbi malet e gjata e të pafund. Kjo ndodhi natën. Mëngjesi ishte përsëri i pastër, po era të përlante. Zaten, ajo s'kishte pushuar kurrë dhe çadrën tonë e kishte sa për të luajtur. Herë i shkulte një anë, herë një tjetër dhe ne vraponim të mblidhnim gurë për ta forcuar përsëri. Megjithatë, njëri nga kulmet nuk kishte shpëtuar pa u çjerrë dhe tani era depërtonte në brendësi, si zonjë shtëpie.

Tomi iku në mesditë. Do ta shoqëronte Dani. E vetmja kafshë që mundëm të siguronim, ishte një mushkë e përhimtë, që rrallë ngarkohej. Atë na e dhanë çobanët, sa u thamë fjalën. Përsëri as që mundeshim t'i ngarkonim të gjitha në të. Në qoftë se në fillim të sezonit ne u ngjitëm në Qafë të Lekës fare të lehtësuar dhe me dy mushka plaçkë, tani duhej të ktheheshim të rënduar. Ishte një sezon i mbarë kërkimesh dhe vetëm qeskat e kampioneve përbënin tri barrë të mira. I ngarkuam paq dhe unë i shoqë-



rova një copë rrugë. Te Brinja e Krekzit u përshëndoshëm me njëri-tjetrin dhe unë u ktheva. Çadra m'u duk e zbrazët. Për të mos u lagur etiketat e kampioneve, kishim menduar t'i mbështillnim qeskat me dhomëzat ngjyrë portokalli që përbënin ndarjet e brendshme të çadrës. Ja se si dukej tani ajo mbulesë e brishtë, që na mbrojti nga vesa, shiu, erërat dhe tani së fundi nga dëbora e maleve: mbi krevatet portative në çrregullim të plotë, binte një dritë jeshile e bukur, ndërsa në dysheme, bari ishte tharë dhe toka ishte plasaritur. Pjatat dhe tenxheret, në të cilat kishim ngrënë mëngjesin e fundit, ishin kapicë aty në një qoshe. Nga e çara në kulm depërtonte një fashë e vakët dielli dhe ndoshta kjo ishte arsyeja që çadra dukej aq e blertë. Nga jashtë ajo e kishte humbur me kohë jeshillëkun, ashtu si edhe malet rreshtën së vegjetuari barin e njomë. Qeska kampionesh, çekiçë, tavolina portative e përmbysur, arka e ushqimeve e hapur, kaminetoja e nxirë, copa fitilash të djegur nën krevatin e Danit, ja tabloja e kësaj shtëpie në shpërngulje. I vetëm, në mes të kësaj rrëmuje, e ndjeva urinë më shumë se kurrë e, prapëseprapë, nuk më bënë duart të gatuaja asgjë.

Dola jashtë. Currili i ujit që binte në lugun e thellë prej çimentoje, vazhdonte zhurmën monotone. Pastaj uji mbushte ca lugje më të cekëta e të gjata, ku verës vinin e shuanin etjen mijëra kokë bagëti që kullosnin në ato male. Griba madhështore, me shpate të buta nga perëndimi, zbardhte nga dëbora e parë dhe dukej sikur i vështronte me ironi malet pranëbregdetarë. Kufiri i dëborës, i parë nga lart, u ishte afruar fshatrave poshtë në luginë, si një bishtë që druhet të sulmojë pa ardhur akoma nata...

Poshtë mbillej grurë dhe tokat e punuara ngjyrë kafe ngjanin si tabela shahu.

Megjithëse në prag të dimrit dhe në mes të maleve, vetmia ishte një ndjesi që e kishte humbur me kohë pushtetin e saj. Po njeriu nuk ka si i shpëton ndikimit të natyrës e veçanërisht kulmeve të saj. Vetë dëbora shënonte një kufi midis punëve. Për ne, gjeologët, ky kufi ishte i prerë dhe në ato lartësi prej një mijë e shtatëqind metrash as që mund të mendoje ndryshe. Megjithatë, fare pranë nesh, jetonin ca njerëz të tjerë, që dëborën e konsideronin vetëm si një sinjal. Për ata dimri i vërtetë ishte akoma larg, derisa bagëtia gjente bar të këpuste aty më poshtë. Veç bërrucet e trasha tani zvariteshin në kurriz jo vetëm natën, por edhe ditën. Qumështi kishte shteruar me kohë. Baxhot po mbylleshin njëra pas tjetrës dhe ujërat ishin në të shterur. Ka një periudhë të tillë në male. Në fillim të nëntorit gjësimet akoma nuk ndihen siç duhet dhe ujërat e dëborës së parë nuk arrijnë të depërtojnë përmes shkëmbinjve dhe të shpërthejnë në burimet.

Mbylla hyrjen e çadrës dhe u nisa për te çobanët. Njëzet metra nën sheshin ku kishim ngritur çadrën, ndodhej një shpellë e hershme, që breza të tërë çobanësh e kishin pasur si strehë të mrekullueshme në atë shpat të zhveshur mali. Pak më parë se të mbërrinim ne aty, rruga për të zbritur nga burimi i Shterpasit në shpellë ishte e gjatë dhe e mundimshme. Po Dani harxhoi vetëm disa kile dinamit për të shkatërruar shkëmbin dhe hapi një rrugë më të shkurtër. Breza të tjerë do të na falënderonin për këtë, sepse ajo shpellë ishte një mrekulli. Zbrita rrugën e porsahapur dhe dola në shtrungë. Dëbora

kishte njomur plehun dhe këmba të zhytej në të. Hithrave të dendura, që rriten aq tepër nëpër mezhdat e shtrungave, po u zverdheshin gjethet. Gjembagëve, dikur me lule vishnje në të kaltër, u kishin mbetur vetëm kërcenjtë e trashë gri.

I pari më përshëndeti Gudoja trimosh, duke tundur veshët e mëdhenj e të zinj, me pulla të bardha. I vura dorën në kokë dhe e pashë se edhe ai më vështroi me mirënjohje.

— Pse të kanë lidhur?, — e pyeta, duke i futur gishtat e dorës nën rripin e gjerë që i shtrëngonte qafën.

Qeni kuasi me pakënaqësi dhe zhvati me këmbë një copë plis dheu fare të zi. I lirova zhinxhirin dhe u futa në shpellë. Nuk kishte njeri. Zjarri në vatër ishte në të fikur. Dielli që po perëndonte, zbardhte vetëm tavanin e nëndheshëm dhe vetëm një rreze e tij kishte mundur të depërtonte në një të çarë të largët. Dola jashtë, mblodha ca shkarpa dhe vendosa të ndizja zjarrin. Pas pak bubulloi një flakë e bukur. Qeni hyri brenda. Erdhi e më lëpiu dorën. Më pas u ul në bisht dhe zbuloi para meje barkun e bardhë pushbutë. Kur ishim përqafuar për herë të parë me njëri-tjetrin, Hatja më pati thënë se ky qen zemrën e kishte të bardhë. Një mizë a insekt fluturoi në ajër dhe Gudoja zgjati me rrëmbim qafën e gjatë dhe e gëlltiti. Gjuha e kuqe iu hollua dhe dhëmbët e sipërm i shkëlqyen.

— Të ka marrë uria?, — e pyeta përsëri duke i tundur me qortim gishtin para gojës.

Në njërin krah të vatrës ishte shtruar një shark i vjetër dhe vajta e u shtriva atje. Herë pas here i hidhja dru zjarrit dhe shpejt e ndjeva veten ngrohtë.

Zgjata këmbët dhe çmpiva gishtat. Qeni, i ulur në bisht, siç ishte, vazhdonte të më shikonte në dritë të syrit. . . Nga tavani i shpellës u shuan rrezet e fundit të diellit dhe një errësirë e befasishme shpejtoi muzgun. Drita e zjarrit ra më tepër në sy dhe muret e gurta u përflakën.

Kjo shtëpi e nëndheshme nuk ishte më e madhe se njëzet metra katrorë, po të përjashtonim këtu zgavrat pa formë që thelloheshin në faqet e saj. Hyrja kishte pasur dikur një trajtë trekëndëshi me bazë në tavan, kurse tani ishte rregulluar si një derë e vërtetë me mur gurësh të palidhur. E njëjta gjë ishte bërë edhe me zgavrat. Ato ishin kthyer në dollapë të thellë, të rregulluar po me mur të thatë, ku vendoseshin enët e llamarinta, kacekët e lëkurtë ku mbahej gjiza e dimrit, thasët me miell të misërt për ushqimin e qenve, zile, sharqe, deri te mashtrapatë e ujit e bidonat e qumështit. Dyshemeja ishte shtruar me plloça me forma të çrregullta dhe ngjante kështu si një mozaik i madh natyral. Të gjitha këto rregullime nuk ishin bërë njëherësh. Çdo vit shpella transformohej e bëhej një banesë gjithmonë e më e këndshme. . .

Errësira sa vinte dhe bëhej më e dendur. Ora nuk kishte kaluar as katër, po mjegulla e zezë ishte ngritur nga lugina dhe kishte nxirë malet. Qeni vazhdonte të më shikonte drejt në sy dhe herë pas here hante diçka. Ishte koha kur bagëtia duhej të kthehej në shtrungë, dhe kjo vonesë më shtoi merakun. Hatja ishte çoban i rregullt, ndaj errësira që po binte, më shtoi ankthin. Dola jashtë, ngjita të përpjetën e porsahapur dhe iu afrova buzës së shkëmbit. Qeni më ndoqi pas. Bile ai, siç duket, mendoi se

unë do të shkoja në çadër, sepse vrapoi para meje dhe qëndroi te hyrja e saj. Aty më priti dy-tri minuta, pastaj erdhi e më qëndroi pranë. Ishim rrethuar tani nga një natë e dendur, e parakohshme, ku nuk ishim në gjendje të dallonim asgjë. Vorbullat e mjegullës shtyheshin në drejtim të veriut dhe të thanin fytyrën. Befas gjëmoi. Gjëmimi ishte aq i fortë, sa u duk sikur vetëtima shkarkoi fare afër nesh. Qeni ngriti veshët. Pas kësaj plasi stuhia. Ishte një rrebesh që nuk e kisha parë kurrë. Kisha përshtypjen se ndodhesha në mes të një lumi të rrëmbyer dhe nuk mundesha të bëja as edhe një hap përpara. Stuhia ishte e padukshme dhe litarët e shiut as që dalloheshin. Mjegulla që zvaritej përtokë i fshihte të gjitha. Rashë në gjunjë dhe u mundova të ecja këmbodoras. Mendimi i parë që më pushtoi ishte frika se mos çadra fluturonte në hava me gjithçka kishte brenda. Rrëketë e ujit mbinë menjëherë në sipërfaqen shkëmbore të sheshit dhe nisën të rrokulliseshin në buzë të humnerës që fillonte mbi shpellë. U afrova ngadalë, zvarë dhe pashë se çadra po qëndronte akoma. Brenda disa sekondash nuk më kishte mbetur asnjë pjesë e trupit pa u lagur. Tani i vetmi strehim ishte çadra. Qeni, që më kishte ndjekur pas edhe ai, duke u zvaritur, befas lehu me të madhe dhe u ngrit në këmbë. Zgjata dorën dhe u mbështeta pas kurrizit të tij. Kokat tona ishin afruar aq pranë njëra-tjetrës, sa munda të dalloja tek ai një vështrim gjilpërë në mes të errësirës dhe stuhisë. Ky ishte vetëm një çast. Pastaj edhe unë u mundova të ngrihesha në këmbë. Si i dehur, iu afrova hyrjes së çadrës. Atje rashë përsëri në gjunjë. Por, sa kapa tokëzën metalike të zinxhirit të trashë që mbyll hyrjen, një dorë e fuqishme

më preku supin dhe më foli thua jse duke bërtitur:

— Po e hape, mbaroi!

Ishte Hatja. Nga llabania i derdheshin mbi shark currila uji, dhe fytyra e gjerë, futur në thellësi, kishte një shprehje të tillë qetësie, sa më habiti.

— Futet era brenda dhe e ngre në hava!, — më tha përsëri me zë të lartë. — Kupton?

Më zgjati dorën dhe u ngrita në këmbë. U hap një cep i sharkut të tij dhe unë u ndodha menjëherë nën një mburojë të vërtetë. Veç trupin e kisha qull dhe nga flokët më zbrisnin në fytyrë rrëke uji. Pastaj hapi cepin tjetër të sharkut dhe futi nën të qenin. Dy njerëz dhe një kafshë, shtrënguar pas njëri-tjetrit, qëndronin në mes të stuhisë së furishme në prag të një çadre që tani nuk vlente më për asgjë.

— Po bagëtinë?, — e pyeta.

— E strehuam nën guvat e Bejkës, — m'u përgjigj. — Pisk e kemi sonte. Po vjen natë e keqe!

Qeni futi kokën përmes këmbëve të tij të hapura dhe shkundi trupin. Ai ngushtoi kofshët dhe nisi ta ngrohte kafshën me nxehtësinë e trupit të vet.

— Erdha për ty!, — më tha pastaj. — Në këtë furnë çdo gjë mund të ndodhë.

— Tomi të ketë sosur në Plloskë?

— Në mos në vend, ka zbritur shpatin, — m'u përgjigj. — Ky kiamet mund të pushtojë vetëm malet. Por do të kalojë shpejt. E keqe është dëbora. Sonte do të bjerë përsëri. . .

Fytyrën ia kishte pushtuar një ngjyrë e zbetë dhe kapilarët e gjakut, që zakonisht ia skuqnin faqet, i ishin mavijosur. Hija e llabanes i bënte më të theksuara këto ngjyra dhe sytë e kaltër, me qerpikë të gjatë kurorë u bënë të menduar. M'u kujtua rasti,

këtu e dy muaj më parë kur bisha i kishte çarë kopënë dhe i kishte rrëmbyer dy pëlla. Atëherë e ndjeva hidhërimin e tij si të më kishte humbur edhe mua një gjë e shtrenjtë. Po minerali që na kishte treguar po atë ditë në humnerat e Panjës, ma kishte fshirë shpejt këtë ndjenjë. Tani po e shikoja përsëri po aq të preokupuar.

Ai u mundua të fuste dorën në xhep, siç duket për të nxjerrë kutinë e duhanit, por unë e pengoja. Shiu reshti papritur, ashtu siç kishte ardhur.

Dola nga sharku dhe kontrollova çadrën. Nga jashtë nuk kishte pësuar gjë. Brenda ishte bërë një kënetë e vërtetë. Hatja më tha se kishte buruar vendi. Ujë duhej të kishte futur edhe nga e çara në kulm. Rrobat e krevateve portative ishin bërë qull.

— Sonte fli te ne!, — tha Hatja, kur më pa të menduar. — Mbjaj edhe Gudon me vete. Unë me djemtë do të jemi në mal. Mirë do të qe ta sillnim bagëtinë në nome, po sot nuk ka kullotur hiç. Shyqyr që janë Guvat e Bejkës. Veç ua kam frikën bishave. Gudon ma lësho, kur të dëgjosh krismë pushke. Nxite të vijë te ne...

Tunda kokën. Nuk e kisha dëgjuar herë tjetër të fliste aq i menduar. Të gjitha këto i tha gati me një frymë. Sikur e pengonte diçka përbrenda gjoksit.

Zbritëm në shpellë. Zjarri kishte humbur flakën, po prush kishte mjaft. Hatja hoqi opingat në prag të shpellës. Këtë punë e bënin të gjithë çobanët. Kisha përshtypjen se ata respektonin kështu shtëpinë e tyre. I zbatha edhe unë. Shpejt i vumë përsëri dru zjarrit. Pastaj unë u zhvesha. Ai më hodhi mbi sup sharkun. Ishte aq i rëndë nga shiu, sa m'u drodhën

gjunjët nga pesha. Ngrohtësia e trupit të Hates më solli zemrën në vend.

Pasi u thamë mirë e mirë, ndezëm nga një cigare. Më pas ai u ngrit dhe në çengelën e nxirë, që varej nga tavani i shpellës nëpërmjet një zinxhiri të trashë, vendosi kusinë ku gatuanin për qentë. E pashë që, derisa të ngrohej uji, u ngut dy-tri herë dhe i hodhi sytë nga qielli. E pikasa. Ziente nga padurimi. Mendjen e kishte te kopeja. Dy çobanët e tjerë ishin djem fare të rinj në moshë dhe shpesh e kisha parë t'i qortonte për axhamillëqet e tyre.

— Ti mund të shkosh, Hate!, — thashë. — Qullin për qenin e bëj edhe unë. Ju kam parë se si e gatuan. — Ai më vështroi një cop herë dhe buzëqeshi.

— As që më kishte shkuar mendja se një inxhinier do të gatunte qull për qentë në shpellën time!, — tha. — Mirë atëherë. Po iki... Gatuj edhe për të tjerët... Ndoshta kthehem natën dhe do të jenë të uritur. Për vete nxirr nga kaçupi ca gjizë dhe... ha! Sharqet për të fjetur i ke atje te guva e djathtë.

— Mos ki merak!

— Ashtu si të porosita. Gudon lëshoje vetëm po të dëgjosh krismë pushke. Sa të hajë, lidhe...

Pas pak dola dhe e përcolla një copë rrugë. Më saktë, e ndoqa pas, sepse ai nuk më vuri re. Mjegu-lla ishte zbardhur. Nata e vërtetë nuk kishte ardhur akoma. M'u zhduk shpejt nga sytë. Kishte po atë hap të gjatë, të sigurtë. Disa minuta më vonë dëgjova rrokullimën e gurëve të lagur që zhvendoseshin nga pesha e trupit të tij dhe merrnin tatëpjetën. I hodha edhe një sy çadrës dhe zbrita përsëri në shpellë. Uji po valonte, prandaj nxitova të hidhja në të miellin e



misërt. Ndërkohë e trazoja me shkop, derisa u krijua një qullë i vërtetë. Arapashi që na bënte nëna në fëmijëri gatuhej po në të njëjtën mënyrë. Vetëm se këtu mungonte yndyra dhe mielli ishte i pasitur. E hoqa kutinë nga zjarri dhe e nxora jashtë të ftohej. Pastaj mblodha zinxhirin e çengelit dhe stivosa mbi vatër një krah dru. Sa mbarova këto punë, u shtriva në anë të zjarrit... E ndieja veten mirë e ngrohëte. Nga sharku vinte erë leshi i palarë, që zakonisht më pëlqente...

...Kështu, pra, ai kishte ardhur të kujdesej për mua. Ndaj këtyre njerëzve e patëm ndier gjithmonë veten borxhlinj. Megjithëse jetuam dy muaj bashkë, ata na konsideruan gjithë kohën si miq të vërtetë. Nuk do t'ua harronim kurrë këtë! Bile Tomi, para se të nisej, kishte shprehur një ide të bukur. Meqë Hatja na kishte treguar i pari mineralin në Humnerat e Panjës, emrin e tij do ta shënonim në relacionin gjeologjik. Më pas, ndoshta kur të krijohet historiku i minierës, emri i tij do të zinte një vend të nderuar. Por kjo mua më dukej fare e paktë... Veç, mënyrë tjetër për t'ua shpërblyer nuk gjeja. Ne ishim dy grupe njerëzish që punonim gati në të njëjtat kushte, në majat e maleve të Gribës dhe secili, me punën e tij, kryente vetëm detyrën. Por nga çobanët ne mësuam ta shihnim veten si njerëz të pamposhtur, sepse natyra e ashpër duhej të na bindej tërësisht. Ne na bashkonin aq shumë gjëra dhe nuk na ndante asgjë... Këto mendoja i mbështjellë me sharkun e ngrohtë. Gudoja kishte mbaruar së ngrëni dhe qëndronte në hyrje të shpellës duke vështruar zjarrin. I buzëqesha së largu. Nuk më vu-ri re.

— Gudo!, — i thirra.

Ngriti veshët prej ujku dhe m'u zgërdhi. I bëra shenjë të afrohej. Ngurroi ca, pastaj ngadalë zuri vend në fund të sharkut. Atje u mblodh kulaç dhe mbështeti kokën mbi këmbët e mia. Të them të drejtën, më vinte keq ta lidhja. Ishte i vetmi mik, me të cilin mund të shkëmbeja dy fjalë. Megjithatë, Gudoja m'u duk atë darkë tepër i menduar dhe nuk kishte dëshirë të luante me mua. Trupi i madh, ai vështrim i nderur, veshët me pulla të bardha që zakonisht i mbante përpjetë, goja e madhe me dhembë të mprehtë, të gjitha e tregonin pakëz të ashpër edhe për mua që isha mësuar me të. Përkëdheljet që të falin zakonisht qentë e tjerë, sidomos ata që nuk i kanë mbushur akoma të dy vjeçët, ishin të huaja për Gudon. Zemërgjerësia e tij më e madhe ishte të lëpirët e dorës ose prekja e këmbëve. Ishte e rrezikshme ta teproje me të.

Ishte errësuar krejt, kur u ngrita të haja diçka për darkë. Nxora nga kaçupi tri lugë gjizë dhe i vura përpara. . .

Gjumi po më rëndonte sytë. Mbarova së ngrëni dhe u ngrita e lidha Gudon. M'u bind pa vështirësi, por e pashë se nuk i erdhi mirë. Ndërkohë, stivosa në vatër edhe një krah dru dhe u shtriva të flija. Fenerin e lashë ndezur. U mbuloval me shark dhe sakaq më zuri gjumi. . .

U zgjova nga të lehurat e forta të qenit. Sa u ngrita ndenjmur, dallova në lëvizjet e tij një tërbim të atillë, që nuk ia kisha parë kurrë. Lehte herë në drejtim të errësirës e herë në drejtim të brendësisë së shpellës. Zinxhiri me të cilin ishte lidhur, herë tendosej e herë lirohej. Ç'kishte ndodhur? U ngrita

shpejt dhe iu afrova. E para gjë që më ra në sy, ishte dëbora, që kishte shtruar nja dy gisht përtokë e që vazhdonte të binte me flokë të rëndë. Gjithçka tjetër ishte errësirë. Erë nuk frynte. Vështrova rreth e rrotull. Kishte një qetësi të tillë, sa mund të dëgjohej edhe zhurma e pikave të rralla të ujit që binin nga shkëmbinjtë e lagur. I përkëdhela kokën Gudos për ta qetësuar, por kjo ishte punë që s'bëhej. Tërbimi i tij sa vinte e shtoej. Nuk po kuptoja fare se çfarë e shqetësonte aq tepër atë natë të qetë. Kështu kaluan disa minuta. Befas u dëgjua një e shtënë pushke. Krisma kaloi përmes qetësisë si një trup i huaj në shtat të qiellit. U përqëndrova një çast dhe vendosa ta liroja qenin nga zinxhiri. Por aty për aty u përmbajta; kjo do t'i jepte mundësi Gudos të çante natën dhe unë të mbetesha në shpellë fare i vetmuar. Hatja me shokë kishin aq nevojë në ato çaste të vështira dhe unë duhej t'u ndodhesha pranë. Vetëtimthi më kaloi nëpër mend vështrimi i tij i menduar atëherë kur bisha i kishte rrëmbyer dy dele. U ktheva në shpellë, mora fenerin dhe u ngjita deri në çadër. Atje gjeta me vështirësi peliçen time dhe zbrita përsëri të zgjidhja qenin. Gudoja, gjatë këtyre pak minutave, ishte tërbuar fare. E ndjeva që m'u vërsul sikur të më shihte për herë të parë dhe vetëm zinxhiri i trashë më shpëtoi kësaj radhe nga dhëmbët e tij.

— Gudo!, — i fola ashpër dhe rrëmbeva nga toka një copë guri. Nëpër trup më kaluan mornica të ftohta.

Qeni u qetësua vetëm një çast. Përfitova nga ky rast të zgjidhja zinxhirin jo në qafën e tij, por atje ku kapej me shkëmbin. Këtë e kisha menduar mirë pak më parë. Kështu Gudoja nuk do të më largohej nga sytë. Unë do të vrapoja pas tij, duke mbajtur në

dorë fundin e zinxhirit. Vrulli i tij i parë ishte i papërmbajtshëm. Pas një sekonde ne u ndodhëm mes errësirës. Fuqia e tij ishte e tillë, sa mua gati më zvariste. Vetëm kur e përpjeta u bë e madhe, vrapi i tij u ngadalësua disi. Nuk e dija se ku po shkonim. Guvat e Bejkës i kisha parë me dhjetëra herë, por atë natë ishte e pamundur të orientohesha. Pas disa minutash munda të dalloja kurrizin e qenit. Vrapoja, gremisesha, ngrihesha përsëri dhe prapë bija. Dora që shtrëngonte zinxhirin, siç e pashë në mëngjes, më ishte gjakosur. Nuk doja të ndahesha kurrsesi nga qeni. Diku një gur më goditi kërcirin e këmbës dhe bërtita nga dhembja. Gudoja qëndroi një çast. Kaq kohë pata të merrja frymë fuqishëm. Pas kësaj vazhdoi vrapi i furishëm nëpër atë natë. Dëborë vazhdonte të binte qetë-qetë dhe mali, pas aq shumë ditësh e netësh, i kishte shpëtuar erës.

Nuk e di sa vazhdoi kjo maratonë. Kur ramë në një gropë të gjerë, Gudoja mbajti këmbët. Aty lehu e lehu pa pushim. Trupin ma kishin mbuluar rrëketë e djersës. Pas pak, atij iu përgjigjën të lehura të tjera. Një krismë e re pushke çau natën. Të lehurat u shtuan përsëri dhe Gudoja nisi vrapin. Pas një maje të vogël ramë në një pyll të dendur, një pyll i shkurter, fare i vetmuar në atë mal të zhveshur, që unë e kisha parë disa herë. Në buzë të tij ndeshëm me qenin tjetër të kopesë. Ai mbiu aty aq befas, sa unë dyshova se mos ishte vetë ujku. Vetëm Gudoja më qetësoi aty për aty. Të dy qentë qëndruan disa minuta përballë njëri-tjetrit. Munda ta diktoja «bisedën» e tyre misterioze, ngaqë sytë më ishin mësuar me errësirën. Nata lëshonte një dritë të zbetë. Qentë vazhdonin të nuhatnin njëri-tjetrin. E ndieja veten

valë të ngrohtë, ndërsa rrëketë e djersës zbrisnin nëpër trup e më lagnin çorapet. Ky qëndrim zgjati mjaft. «Pëshpëritjet» e qenve nuk kishin të mbarruar. Nuk dija nga duhej t'ia mbaja. Nëpër natë kishin heshtur të gjithë zërat. Befas qentë u larguan disa metra nga njëri-tjetri dhe i kthyen kurrizin pyllit. Gudoja m'u afrua fare pranë dhe u fërkua pas këmbëve të mia. Mblodha zinxhirin dhe i preka kokën. Pas një çasti qeni tjetër ia dha vrapit pa lehur. Gudoja nuk luajti nga vendi. . .

Qeni u kthye bashkë me Hatën.

Vetëm nga zëri munda ta dalloja që ishte ai. Gjithçka tjetër ishte shndërruar në një masë më të errët se nata. Sharku i zi dhe llabania rrumbullakosnin konturet e trupit të tij. Dallova dorën e tij në pushkë dhe pushkën përgjysmë nën shark.

— Erdhe?, — më pyeti me një zë të ngrohtë. — U lodhe, hë?

— Pësuat gjë?

— Ishte një lukuni. . . , — tha Hatja. — Duhet të na kenë rrëmbyer diçka. Nuk i numërojmë dot tani natën. E keqja është se duhet të jenë këtu rrotull. . .

— Ti shtive tri herë, — i thashë.

— Edhe në kam vrarë a plagosur ndonjë, vetëm nesër do ta gjej. Ashtu si edhe delet e shqyera. . .

— Po djemtë?

— Njëri. . . , — ai u përtyp disa çaste, — është në Guvat e Bejkës. Fle, ndoshta. Tjetri duhet të vijë tani. Duhet të hapim sytë. Mund të sulmojnë përsëri.

U drithërova. E ndjeva veten si në luftë. Ai tha: «Mund të sulmojnë përsëri», dhe mua më shkuan sytë vetëtimthi te pushka e tij. Bisha kishte avantazh

natën, ndërsa ne pushkën. Ajo donte të grabiste, ne duhej të mbronim. . .

— Eja, — tha Hatja. — Meqë t'u prish gjumi, sonte nuk ke për të fjetur më. Zëmë një shteg. . .

Djersa po më thahej në trup dhe të ftohtët e natës e të malit po më depërtonte në kockë. Duhej të lëvizja patjetër.

Nuk ecëm më shumë se dy-tri minuta. Në prag të pyllit zbardhnin dy shkëmbinj të mprehtë, përballë njëri-tjetrit, duke krijuar midis tyre një të çarë të thellë. Aty qëndruam. Kjo ishte edhe prita. Gudoja qëndroi në krah të Hates, i ulur në bisht, me këmbë në dëborë. Ngrita jakën e peliçes dhe u mbështeta pas shkëmbit. Flokët e dëborës më binin në fytyrë dhe unë, i etur, i lëpija me kënaqësi. Pritja vazhdoi gjatë. . . Më dukej sikur bishat nuk do të kalonin kurrë në atë shteg. Pra, kisha ardhur shumë vonë. Beteja, siç dukej, kishte mbaruar. . . Dalngadalë dëbora po rrallohej dhe nisën të dalloheshin zbetë konturet e maleve.

— Po gdhin!, — tha Hatja me zë të ulët.

Bëra një llogari të thjeshtë. Sulmi i prerë i bishave duhej të kishte ndodhur aty rreth orës tre pasmesnatës. Pra, kisha fjetur shtatë orë të mira.

Pas këtyre dy fjalëve, Hatja heshti për shumë kohë. Edhe Gudoja vazhdonte të rrinte në bisht, pranë të zot. Dëgjohej frymëmarrja ritmike e qenit. Vështrimi i tyre ishte ngulur drejt pyllit. Habitesha me këtë durim. Për vete isha mpirë. Doja të lëvizja patjetër, ose të bisedoja për diçka. Nuk mund të qëndronte njeriu kështu. Më shumë më habiste durimi dhe vëmendja e qenit. As lehu e as lëvizi. Që kur kishim zënë atë pritë, besoja se duhej të kishte ka-

luar mbi një orë. Çdo minutë që kalonte, forconte kontrastin e maleve me qiellin që po pastrohej nga retë.

Befas u dëgjua një ulërimë rrëqethëse:

— Uuuu!..

Lëviza nga vendi. Hatja zgjati dorën dhe më de-tyroi të ulesha përsëri. Gudoja ngriti veshët dhe sakaq qe ngritur në këmbë. Çobani ngjeshi kokën pas shkëmbit dhe nxori pushkën nga poshtë sharkut. Shtegu ishte katër-pesë metra i gjerë. Më tej, në të dy anët, vargu i shkëmbinjve shtrihej si një mur.

Dhe ajo që pritej ndodhi pas pak. I pari e kaloi shtegun një ujë i përhimtë, jo shumë i madh, kockë-dalë, me gjuhën përjashta e qimet e qafës të ngritura drizë përpjetë. Hatja mbërtheu me një dorë kokën e qenit dhe ia fshehu nën shark. Disa sekonda më vonë, katër bisha të tjera kaluan nxitimthi pas të parit dhe, pak metra pas pritës, vrapuan. Si u bënë bashkë, ngadalësuan hapin. Ecja e tyre tinzare më ngjethi shtatin. Nuk kisha parë kurrë ujë aq afër. Isha përpjorë nga kjo pamje, kur Hatja më zgjati pushkën. Ishte një belxhik i gjatë, i rëndë. Ngjeshja qytën pas supit dhe... shënova. Çastet e para nuk mora vesh nëse plumbi kishte bërë punë. Hatja ma rrëmbeu nga dora po aq me shpejtësi, futi një fishek tjetër dhe qëllloi. Gudoja, që qysh me krismën e parë ishte tërbuar, vazhdonte të lehte me furi. Befas i shpëtoi Hates nga dora dhe u vërsul në drejtim të ujëve. Bishat kaptuan një bregore të vogël dhe na humbën nga sytë. Ne vrapuam në drejtim të tyre. Qeni tjetër i kopesë, që ishte larguar sapo ne zumë shtegun, duhej të kishte sulmuar edhe ai, sepse të lehurat ishin shtuar tepër. Nën bregore shtrihej një

shpat i zhveshur me përrenj të cekët e bimësi të rralle. Kur mbërrimë aty, shtangëm në vend nga habia. Gudoja ishte mbërthyer me njërin nga ujkit dhe e kishte shtrirë përtokë. Ishte një përlëshje aq e tmerrshme, sa nuk mund të dalloje se cilët ishin këmbët e Gudos e cilët të ujkut. Të tjerët ia kishin dhënë vrapit, të ndjekur nga qeni dhe nga çobani i ri që vërviste gurët në drejtim të tyre. E keqja ishte se tani as që mund të shtije më me pushkë. Kishte rrezik të vrisje qenin në vend të ujkut. Qëndruam. Hatja shkëputi me forcë nga toka një fije të gjatë bari dhe nisi ta përtypte. Shikoja herë këtë skenë e herë çobanin. Dy-tri herë u bë gati të shtinte me pushkë, por e uli përsëri. Një çast ujku u shpëtoi dhëmbëve të Gudos dhe u sul të ikte. Por nuk i eci. Qeni u përdrodh rreth vetes dhe me shpejtësi i kaqi me dhëmbë bishtin. Klithma e ujkut ushtoi maleve. Ai u kthye me tërbim dhe, duke lënë bishtin nëpër dhëmbët e Gudos, iu hodh qenit përsipër. Këtu mori fund edhe durimi i Hates. Isha përpirë aq tepër nga përlëshja, sa vetëm krisma e pushkës që më ushtoi në rrëzë të veshit, më solli në vete. Përlëshja pushoi befasishëm. . . Para nesh dergjej kufoma e ujkut. Plumbi e kishte shpuar tejpertej. . . Nuk këmbuem asnjë fjalë, derisa mbërrita në Shterpas. Te sheshi ku ishte ngritur çadra jonë Hatja u ul mbi një gur, pasi e pastroi nga dëbora dhe nxori kutinë e duhanit. Ndeza edhe unë një cigare.

— Kështu pra!, — foli për herë të parë Hatja, sikur deri në atë kohë të kishte treguar ndonjë ngjarje. Psherëtiu. — Kështu, pra! — përsëriti. — Ti punon, lodhesh, përpiqesh për të mirën, po ligësia qëndron aty, te kufiri i lumturisë sate. Dhe, po s'mbaj-



te pushkë me vete, të ha kokën! Ja, kështu. Të ha kokën! — Hodhi tej nga shpatullat sharkun e zi dhe zbuloi trupin e tij të madh, si të kishte djersirë në mes të dëborës së maleve. — U thashë djemve të sakrifikonim sonte e të rrinim zgjuar gjithë natën. Njëri më dëgjoi, kurse tjetri jo. Fjeti si budallai. Tri shtigje të zëna u bëjnë ballë tri lukunive me ujër. Po ç'të bësh? Ka edhe ndonjë axhami, që nuk do të prishtë gjumin.

Ngriti kokën dhe vështroi kurorën madhështore të maleve të Gribës. Pastaj uli sytë poshtë dhe pa luginën. Në fushat buzë lumit mbillej gruri, ndërsa tyta e pushkës së Hates, si një antenë e errët, përgjonte kaltërsinë që mbulonte krahinën...

## KALTËRSI

Kishim gjashtë ditë që ndodheshim me pushime në fshat. Korriku qëlloi tepër i nxehtë dhe natën flinim me të gjitha dritaret hapur. Gjumi më dilte thujse që pa gdhirë. Dritaren e kisha përballë krevatit dhe përmes gjetheve të dendura të hardhisë dalloja ngjyrën blu të qiellit. Ato orë të mëngjesit për mua ishin nga më të këndshmet e gjithë ditës. Yjet dukej sikur i shuante flladi i ftohtë. Gjethet e hardhisë, që mbulonin kopanët e verdhë të rrushit, fëshfërinin ëmbël. Mëngjesi këtu as që mund të kuptohet pa këngën e zogjve, pa klithmat e rosakëve dhe pa atë aromë të athët toke të kripur që depërton në dhoma së bashku me flladin e mëngjesit. Pas pak, në rrugicën me kalldrëm u ndien hapat e kalimtarëve të rrallë. Horizonti nisi të hapej ngadalë dhe ngjyra blu e qiellit fitoi një shkëlqim thujse si të çelikut. Pastaj u përflak. . .

Gruaja flinte së bashku me vajzën tonë gjashtëvjeçare, Klean, aty, në cepin tjetër të dhomës. Mua më vinte t'ua prishja atë gjumë të ëmbël mëngjesi, për të shijuar edhe ato lindjen e diellit. Vajza jonë ishte me flokë të verdhë në të bardhë, sytë i kishte të mëdhenj dhe të kaltër. Buzët e plota me pak push, tani që flinte, i mbante shtrënguar fort. Një rrudhë

e lehtë i zbriste nga balli deri mbi hundën e shkurtër, dhe unë ndjeva një farë rrëqethjeje nga ky zemërim i heshtur i saj. Ndoshta shihte ndonjë ëndërr, sepse vetëm atje, në ëndrra, mund t'i çenohej lumturia.

Kishin kaluar më se pesëmbëdhjetë vjet që unë e kisha lënë fshatin dhe vija këtu rrallë e për mall. Me gjithë këto vite, ashtu si shumë njerëz të tjerë, nuk e kisha harruar kurrë fshatin. Jo vetëm se atje banonin njerëzit e mi, por sepse, me kalimin e viteve, fëmijëria më bëhej çuditërisht më e fuqishme, më e qartë. . .

Pas pak kaloi shitësi i qumështit, një djalë faqekuq nga fshati fqinj, dhe rrugica e shtrembër ushtoi nga zëri i tij i fuqishëm:

— Merrni qumësht!

Në fshatin tonë nuk kishim pasur kurrë bagëti; nuk kishim ku t'i kullosnim. Dimrit, fshatin e rrethonin ujërat e errëta të kënetës, ndërsa në verë toka e kripur çahet e copëtohet e zhveshur lakuriq. Edhe tani që kooperativa kishte ngritur ekonominë blegtorale, stallat gjendeshin në fshatin fqinj. Ai fshat ishte munduar gjithmonë të sillte te ne atë që na mungonte, qumështin, dhe të merrte prej nesh atë që i mungonte, kripën. Thirrmat e qumështshitësve të vegjël dhe të zbathur të së kaluarës më sillnin gjithmonë ndër mend diçka nga varfëria e dikurshme e fshatrave tona, diçka të hidhur, të errët, gjithë lagështirë, që më kujtonte vetëm dimrin.

Ndjeva se nuk mund të qëndroja më shtrirë. U ngrita lehtë nga krevati, u veshja dhe zbrita poshtë. Dëgjohej zhurma e detit. Me sy nuk dukej, por mua më erdhi keq që ajo zhurmë e thellë, si e nëndhe-

shme, premtonte dallgë. Edhe këtë e ndieja qartë. Kishte kohë që detin nuk e përfytyroja më të egërsuar dhe pastërtinë e tij, nuk e di sepse, e lidhja me fëmijtë. Klea i ngjante detit. Këtë krahasim ma impononte vetë natyra e saj. Sepse Klea e kishte pritur me shumë gëzim vajtjen tonë në fshat. Mbjaj mend se, me të mbërritur, kërkoi të bënim një shëtitje deri në breg të detit dhe atje thuajse u çmend me gëzimin e dallgëve. Edhe pushimet e viteve të tjera i kishim kaluar nëpër plazhe, po vajza nuk kishte treguar shumë interes për detin. Tani, befas, siç duket e pa veten mes një hapësire të pamatë, thellësia e së cilës shtohet me afrimin e muzgut. Unë dhe babai plak ecim dhe bisedonim, ndërsa Klea, sikur ta ndiente veten të plotëfuqishme, vraponte dhe hidhej pas vijave të shtrembra të dallgëve që lëpinin brigjet. Vegimin e asaj mbrëmjeje të parë në breg të detit e kam tani aq të gjallë. Flokët e saj si të bardhë fryheshin dhe shpupuriteshin nga era e detit. . .

Deti atë ditë ishte vërtet i shqetësuar. Dallgët kishin humbur kaltërsinë, dhe kreshtat e tyre të bardha vijëzonin ca masive uji gjyrë kafe. Bregdeti në ato anë të fshatit tonë është krejt i zhveshur. Dy-treqind metra më në thellësi të tokës shtrihet një brez i dendur plepash e akacjesh, të cilat i ndan nga deti një rrip zhukash të gjelbra. Kështu që, sa herë shkonim në breg të detit, merrnim me vete një çarçaf të bardhë dhe sajnim një tendë për hije. Atë ditë frynte shumë erë dhe tenda e kishte të vështirë të qëndronte në këmbë.

Bëra si bëra dhe u mundova ta ngrija këtë shtëpizë pas një dune të lartë rëre që fshihte pamjen e

detit. Ndërkohë Klea se nga kishte humbur. Mungesa e saj nuk na ra fort në sy, sepse bregu i detit në atë orë të mëngjesit kishte shumë fëmijë dhe ajo që ditët e para ishte miqësuar me ta. Hapa gropa të thella për të ngulur hunjtë e pregatitur posaçërisht që më parë. Gruaja po merrej me ushqimet që kishim sjellë me vete, sepse zakonisht rrinim në breg të detit derisa perëndonte dielli. Para meje erdhi e qëndroi Klea. Merrte frymë me vështirësi dhe thirri me të madhe:

— Babi. . eja të të tregoj një shtëpizë të bukur ku mund të rrimë shumë mirë. . .

E njihja aq mirë atë pjesë të bregdetit, sa isha i sigurtë se atje nuk kishte asnjë lloj «shtëpize». E kundërshtova vajzën dhe vazhdova të lidhja cepat e çarçafit.

Po jo, mor babi!, — ma ktheu ajo e vendosur. — Unë e pashë vetë. Ka edhe një dritare të vogël që vështron nga deti.

— Po ku është ajo shtëpizë?

— Nuk është shumë larg së këndejmi.

— Po kush rri atje, Klea?, — e pyeta, më shumë për t'i ushqyer fantazinë.

— Nuk kishte njeri. . .

Desha s'desha, iu binda. E ndoqa vajzën pas. Nuk na u desh të bënim shumë rrugë. Pas një dune fare të vogël, majë së cilës kishin mbirë ca ferra të dendura, pashë papritmas një kasolle të vogël, ndër-tuar midis rërës. Qesha me fantazinë e Kleas. Në të vërtetë, kasollja dukej si një lodër mes hapësirës së gjerë e të zhveshur të bregdetit dhe çatia e saj, mbuluar me fier, zgjaste përpjetë fijet e thara, si flokë të shpupuritur nga era. I erdha rrotull dhe, kur i gjeta

atyre që ngrohin jetën buzë kaltërsisë së detit, mund të dalloje një dritë të gjallë, gati verbuese, që më kujtonte ngrohtësinë në vitet kur qielli ishte sterrë. Tani, gjysmë i zhveshur, me krahët e hollë dhe të rreshkur nga dielli, me damarë të kërcyer mavi, më dukej gati si im atë. Ai vazhdonte të qëndronte akoma në këmbë, në prag të derës dhe pas tij, nën rrezet e diellit përvëlues, fëmijët, të gjithë leshverdhë e sykaltër, kishin heshtur, për të ndjekur më me vëmendje këtë takim midis nesh. Mbi supin e tij dallova befaz Klean, që doli në krye të turmës. Vëreja se në fytyrën e saj vazhdonte të mbetej po ai preokupim që i njoha së largu. E zhveshur, si të gjithë fëmijët e fshatit, leshverdhë e sykaltër si ata, ajo e shfaqte haptas origjinën e saj, megjithëse kishte lindur shumë kilometra larg bregdetit. . .

— Klea!, — i thirra që brenda kasolles.

Xha Lekoja ktheu kokën.

— Vajza, — i thashë. — E njeh?

— Si mund ta njoh?, — buzëqeshi ai. — Të gjithë këta levrekë njëlloj janë, si të kapur me të njëjtin karrem. . .

Ai u kthye nga fëmijët, kapërceu pragun e kasolles dhe u ul në rërë.

— Sillma pak torbën, Tako!, — më tha mua.

Ky emër i fëmijërisë më ngjalli sërishmi furinë e kujtimeve të shumta, dhe për një çast qëndrova i heshtur. Pastaj mora trastën e rëndë prej mushamaje të trashë dhe ia zgjata.

— Urtë. . . urtë!, — tha xha Lekoja. — Kam për të gjithë. Yje, iriqë, xhixhivalle, kandila, midhje. . . plot, plot.

Dhe vërtet, kur nisi të zbraste torbën e madhe,

në vend të peshqve, vura re gjithfarë kafshësh deti, akoma të gjalla, që tani nisën të lëvrinin në rërën e thatë.

— Mua... mua... mua!, — bërtisnin fëmijët.

U ndala pranë tij dhe nisa ta vështroja. Ishte po ajo dashmirësi e shprehur nga një fytyrë plaku, siç ia njihja në fëmijërinë time të shprehur nga fytyra e një burri... Veç, atëherë ndante falas me tepsinë e bakërtë ata pak peshq që zinte ujërave të kënetës për të ngrohur barkun e fukarenjve, ndërsa tani shpërndante lodra si plak i Vitit të Ri, që del nga thellësitë e detit!

Vetëm Klea nuk thërriste. Me siguri, gjithë ato lodra i dukeshin të frikshme, sidomos, besoja, iriqët dhe kandilat e detit. Dhe ai duhet ta ketë njohur vetëm nga kjo druajtje.

— Ti je e Takos?, — tha papritmas dhe zgjati dorën ta kapte nga këmba e zbathur.

Klea u tërhoq një hap. Plaku qeshi.

— Tako!, — më thirri pastaj fort. — Merre pje-llën tënde dhe zhyte dy-tri herë në det sa t'i dalë frika!

— Klea!, — i fola vajzës, kur e vura re që përpiqej të çante turmën dhe të dilte nga ai rreth i ngushtë.

Si ikën fëmijët të kënaqur, xha Lekoja hodhi trastën e zbrazur në kulm të kasolles dhe hyri brenda e më tha:

— Ta dija se do të të gjeja këtu, do të isha munduar të zija ndonjë koce të majme... .

— Mjafton që u takuam, — ia ktheva. — Kemi plot për të ngrënë. Ja, tani vjen gruaja dhe do të na pregatisë një drekë të mirë që... .

— Të gjitha të mirat mbase i ke, or djalë, — m'u përgjigj aty për aty, — por shije deti nuk ma ha mendja të kenë të ngrënat e tua!

— Ke të drejtë, — iu përgjigja. — Atë shijë nuk e kanë.

— Mirë, — ma ktheu plaku, — po ti i do akoma peshqit si dikur?

— Ngordh për ta!, — i thashë.

— Eja në darkë në shtëpinë tjetër... Kam edhe një kasolle të tillë në buzë të kanaleve. I mban mend kanalet?

Si nuk i mbaja mend! Fëmijëria ime u ndesh me ujin e thellë së pari në ato kanale. Atëherë mushkonjat të pinin gjakun si ushunjëza. Po mirë që ishin ato kanale për t'u larë; zhytur në ujin e ngrohtë, të fëlliqur, mushkonjat sikur kishin frikë të afroheshin. Pasi dilnim prej andej, të sulmonin miliona mushkonja... Në fytyrë ndienim një masë kripe të na tkurrte lëkurën dhe të na digjte sytë. Atyre kanaleve, më pas, dallgët e detit u kishin mbushur derdhjen me rërë dhe sipërfaqja e kënetës shtoej...

Hyri Klea me gruan. Kur panë plakun që ishte shtrirë në kashtën e freskët, mbetën një sekondë të druajtura, po xha Lekoja nuk u dha shkas të heshtnin.

— Eja, nuse e Takos, eja! Urdhëroni si në shtëpinë tuaj. Veç... në je ti nga qyteti, vajzën mos ma bëj t'i dridhen gjunjët para një iriqi deti. Kuak!, — klithi befaz xha Lekoja dhe bëri të kapte këmbën e vajzës.

Gruaja qeshi me të madhe, ndërsa Klea ia dha vrapit jashtë kasolles.



Xha Lekoja u ngrit ndenjurr dhe i dha dorën gruas. U ul edhe ajo.

— Do t'i kaloni këtej pushimet sivjet ë?, — pyeti ai.

— Po, — tha gruaja. — Këtu është shumë bukur...

— Jo edhe aq, xhanëm!, — kundërshtoi xha Lekoja. — Mbase plazhi i Durrësit është më i mirë. Këtu akoma nuk ka hotele, restorante, nuk ka birrari, por... në u largofshit të gjithë ju së këndejmi dhe të mos ktheni më kokën pas, kështu ka për të mbetur plazhi ynë... Veç ka ujë të kthjellët dhe rërën më të pastër në botë.

Ky qortim i hapur më ngjalli një ndjenjë turpi. Ishte e vërtetë që, me gjithë vizitat e rralla, sidomos në ditët e lejeve të zakonshme, ne po largoheshim çdo ditë e më tepër nga fshati ynë, që na kishte rritur dhe ushqyer me varfërinë e tij të dikurshme, që na kishte nisur për në shkollë me opinga dhe valixhe dërrase dhe na priti të ktheheshim me diploma në xhep. Dhe ne ikëm larg... Natyrisht që atdheu është i madh dhe fshati ynë një pjesë e tij. Por... përsëri, në qortimin e xha Lekos, sepse ndieja që largësia mund të merrte trajta më të gjera në të ardhmen. Këtë e tregonte qartë ftohtësia që shfaqti aty pari Klea ime, Klea me sy të kaltër, që kishte frikë nga xha Lekoja plak dhe nga iriqët e detit.

— Kjo është e vërtetë, — iu përgjigja i druajtur.

— E vërtetë, e vërtetë, — përsëriti ai, — po nuk mjafton vetëm malli për fshatin, mor djalë! Po ç'u bë ajo zuzarja e vogël?

— Klea?

— Çohu, nuse, e gjeje, se do të sillem ndryshe me të!

Kur doli gruaja, ai më tha:

— Tako djali, në ike për vete dhe bëre fole në qytet, vajzës ngulja në kokë se e ka gjakun nga buza e detit. . . Ka një të mirë ajo. Ngjyrën e ujit dhe floririn e rërës i mban gjithmonë me vete. Sa herë të shohë flokët dhe sytë në pasqyrë, do t'i kujtohet fshati. Mbase, ku ta dish, vjen një ditë dhe ngulet këtu. . .

E vështrova përsëri gjatë. Ai për vetë nuk ishte larguar kurrë nga fshati, veç dy-tri milje me barkë nëpër det, nga kthehej përsëri brenda ditës në brigjet e zhveshura. Dhe jo se nuk kishte pasur rast. Kur ishte djalë i ri, plevitosej ujërave të kënetës për pak kile peshq, me të cilat mbante gjallë familjen dhe, kur i vente mbarë, të tepërtat nuk i kishte shitur kurrë, por i ndante derë më derë nëpër familjet e varfra të fshatit. Atëherë mund të ishte larguar nëpër dhera të huaja, ose në ndonjë qytet të largët. Por ai nuk i kishte lënë kurrë ato brigje.

Erdhi vajza me gruan. Atë kohë ai bëri sikur nuk i vuri re dhe ktheu kokën nga dritarja e vogël. Klea i pa kurrizin e zhveshur dhe u mbështet pas supit tim. Në shikimin e saj vazhdonte të mbetej po ai shqetësim që i dallova pak më parë.

— Kjo është shtëpia e peshkaqenit plak!, — tha befaz xha Lekoja, pa kthyer kokën. — E ke dëgjuar ti, Klea?

Ajo u gjallërua papritur dhe më shikoi mua sikur donte të më thoshte: «E, a nuk të thashë unë?»

— Po!, — tha vajza me zë të lartë.

— Peshkaqeni do të rrijë këtu edhe pak. . . Sa

të ngopet duke parë vajzën e bukur me emrin Klea, pastaj do të shkojë përsëri në det. E di ti me se vjen këtu peshkaqeni?

— Jo, — Klea mblodhi supet.

Atëherë ai u kthye nga ajo. Në sytë e tij të kaltër dallova përsëri po atë dritë të ngrohtë që më jepte aq shumë në fëmijërinë time dhe besova se edhe Kleas do t'i kishte bërë mirë.

— Me barkë!, — tha ai. — Eja të ta tregoj.

Ajo u afrua pranë dritares. Xha Lekoja e mori në krahë për t'i treguar varkën e peshkaqenit. Klea qeshi.

— Pse, ti je peshkaqeni?

— Po, — u përgjigj xha Lekoja. — Veç një peshkaqen i mirë, që i do shumë fëmijët. Do të vish me mua në det?

Unë dhe gruaja shkëmbyem një vështrim. Tek ime shoqe dallova një farë shqetësimi.

— Të hani njëherë drekën!, — tha gruaja.

— Sa ta pregatisë mamaja, unë dhe Klea kthehemi. Nuk kemi për të vajtur larg.

Vajza u ngazëllua dhe kërceu jashtë kasolles. E pashë nga dritarja se si vrapoi drejt varkës dhe hipi në të.

— Mos u tremb, nuse!, — tha xha Lekoja. — Peshkaqeni plak i do shumë fëmijët, veç i pëlqen t'i lagë njëherë në ujërat ku noton gjithë jetën. Nuk i bën keq, jo! Kështu do ta kujtojë detin më shpesh.

Unë i rraha shpatullat e pakta.

Disa minuta më vonë shpresoja se Klea po shijonte ngazëllimin e dikurshëm të fëmijërisë së t'et.

Pas drekës, ai u ngrit të shtrihej në hije të varkës, që e kishte tërhequr bashkë me Klean deri në

rërën e thatë. Ndërsa ne të tre ramë të flinim në kasollen e vogël.

Aty nga ora pesë pasdite u zgjova pas një gjumi të këndshëm. Klea dhe gruaja flinin akoma. Deti ishte egërsuar përsëri dhe dallgët kishin nisur t'i zhvatnin tokës brigje më të gjera. Në varkën e anuar nuk gjeta njeri. Vështrova përgjatë bregut dhe larg dallova një figurë të vogël njeriu që ecte ngadalë, ndalonte, përkulej për të kërkuar diçka dhe ecte përsëri. Pas pak xha Lekoja m'u afrua pranë dhe në dorë i dallova torbën e madhe që e zvariste përtokë.

— Mblodha ca xhixhivalle për çupën!, — më tha.  
— U zgjua?

I thashë se flinte akoma dhe ai qeshi i kënaqur.

— Na, merri këto dhe zbrazi në derë të kasolles.  
Kur të zgjohet, le t'i gjejë atje...

— U mundove!, — i thashë, duke i marrë torbën nga dora.

— Mos të ta dëgjoj më atë fjalë!, — më qortoi përsëri. — Një pensionisti si unë, nuk i mbetet gjë tjetër, veç të kujtojë thërrimet e bukës që ka ngrënë gjithë jetën dhe të kënaqë pasardhësit e tij të lumtur. Mos vallë pse ndryshuan kohërat, të mos i kujtojmë më ditët e zeza?

— Jo, — iu përgjigja. — Ato do t'i kujtojmë gjithmonë.

— Ti, — ma ktheu plaku, — po jot bijë nuk u ka parë as hijen!

— E drejtë, — thashë. — Kur iku pak më parë në det me ty, m'u kujtua fëmijëria ime barkzbrazët...

— Më rrofsh!, — tha plaku. — Shko tani dhe derdhe torbën te dera, se unë po iki. Do të vish në darkë në kasollen e kanaleve?

— Po, — iu përgjigja. — Me se do të peshkojmë?  
— Ti merr grepat e tët eti sa për t'u engledisur. Unë për vete ruaj akoma vallkonë e vjetër.

Dhe iku. Nuk duhej të kishte bërë as njëzet hap, kur u kthye përsëri dhe më arriti pranë kaso-  
lles.

— Tako, — më pëshpëriti, — merr edhe vajzën me vete. Nuk ka mushkonja si atëherë... mos ki merak. Edhe në e zëntë gjumi, do të kemi me se ta mbulojmë. — Lëvizi njëherë krahët në ajër dhe u largua pa pritur përgjigjen time.

... Pa perënduar akoma mirë dielli, unë dhe Klea u nisëm për rrugë. Nuk shpëtuam dot nga qortimet e gruas dhe ironitë e nënës, kur u thamë se do të niseshim së bashku. Por Klea, sa e mori vesh për se bëhej fjalë, iku nga shtëpia më parë se unë. Megjithatë, ato më ngarkuan me trikora e xhaketa, sikur do të niseshim për në Polin e Veriut. Babai vështronte gratë dhe nuk fliste. Vetëm kur kishin marrë fund përgatitjet, ai më kujtoi të merrja me vete edhe ndonjë gjysmë litër raki, sepse muhabeti nuk shtyhej pa të.

Mbrëmja po binte ngadalë, ndërsa sofa e kuqe e diellit ishte zhytur përgjysmë në det. Sipër harqeve të kodrave, buzëmbremjen po e përshëndeste hëna. Përreth shtrihej një hapësirë e rrafshhtë. Toka kënetore, e tharë, por akoma e kripur, ishte çarë në plisa të mëdhenj. Si lamë fushën, unë dhe Klea u futëm në ranishte. Ranishtja ishte një hapësirë e gjerë ngjyrë floriri që ndante fshatin nga deti. Aty-këtu zhukat e dendura i mënjanoja me dorë që të mos i shponin vajzës kërcinjte e këmbëve. Rëra e kish-

te humbur me kohë nxehtësinë e ditës dhe Klea ecte z bathur, me sandalet e vogla në dorë.

Shtëpiza e dytë e xha Lekos, në të vërtetë ngjante me të parën si dy pika uji. Vetëm se dritarja nuk shikonte nga perëndimi, po nga veriu. Plaku kishte bërë gati një stivë shkarpash për zjarrin që do të na duhej natën e, në kohën që mbërritëm ne, ishte zhytur deri në brez në kanal dhe po i rregullonte fundin vallkosë së tij. Klea e pa që doli nga uji, i llan-gosur me baltë të zezë deri përmbi gju dhe picërroi sytë e kaltër.

— Mirë se erdhët. . . mirë se erdhët!, — uroi xha Lekoja duke shpëlarë duart në kanal. — U lodhe, xhan?, — shtoi pastaj, duke iu drejtuar vajzës.

— Ne bëmë shëtitje, — tha Klea. — Sa bukur që ishte!

— Po xhixhivallet të pëlqyen?

— Shumë, — u përgjigj Klea. — Ja, disa i kam me vete.

Dhe zbrazi nga xhepi i fustanit nja pesë a gjashtë guaska të kuqe me vijëzime të drejta, që u ngjasin anëve të një çatie në miniaturë me kulm në mes, e mbuluar me tjegulla të kuqe.

Lashë plaçkat në kasolle dhe dola të hidhja grepat. Buzë kanalit kishte mbirë bar i egër. Atë ditë kanali m' u duk shumë i ngushtë dhe i cekët. Në fëmijëri unë atë e pata krahasuar me një lumë të madh, dhe thellësia e tij më kishte kallur frikën. Mbaja mend, se si një ditë, e ndjera gjyshe, si nuk kishte lënë cep të fshatit pa më kërkuar, kishte ardhur deri këtu të më gjente. Mirëpo shokët më paralajmëruan për ardhjen e saj dhe, ngaqë e dija se ajo do të më merrte me vete, leva shpejt e shpejt fytyrën me bal-

të të zezë dhe, kur mbërriti gjyshja pranë meje, i thirra nga mesi i kanalit me zë të ndryshuar:

— *Takon kërkon, moj gjyshe?*

— *Po, të keqen!, — tha e shkreta.*

— *Ishte këtu, po iku në shtëpi, — vazhdova ta gënjeja unë.*

— *Po ti si je bërë kështu, more ditëzi!, — u lemeris gjyshja.*

Po unë i ktheva kurrizin dhe me atë pak not bretkosë, që sapo kisha mësuar, isha larguar më tej. . .

— *Ka gjithë ditën pa ngrënë!, — tha edhe një herë gjyshja.*

Ky vështrim kujtimesh më kishte mbërthyer disa sekonda në vend dhe as vura re që plaku dhe Klea po ndiznin zjarrin. Vajza vinte e vinte përçark stivës së shkarpave dhe përplaste herë pas here duart nga gëzimi. Nuk vonoi shumë dhe shtëllungat e tymit nisën të kthenin kokën nga jugu. Flaka që mbiu pas pak, dalngadalë sa vinte e skuqej më tepër, ndërsa mbrëmja binte e hëna i ngjante një hurme të madhe të rrumbullakët.

Kanali ishte fare i qetë dhe vetëm tufat e cironjve të vegjël e prishnin sipërfaqen e tij si një puhi e lehtë që valëzon ujin e errët. Grepat i kontrollova dytri herë, po asnjë prej tyre nuk kishte zënë gjëkafshë. Plaku dhe Klea erdhën në buzë të kanalit dhe qëndruan ndonja dhjetë metra larg meje. Një pulëbardhë e vetmuar fluturoi mbi kokat tona, ra befasi në kanal për të kapur ndonjë cirua dhe u zhduk në drejtim të detit. Xha Lekoja po i tregonte Kleas se si ziheshin peshqit me vallkonë e madhe dhe ajo, siç duket, ziente nga padurimi, sepse i tha plakut:

— *Pa nxirre njëherë nga uji.*

— *Edhe pak, — ia ktheu butë xha Lekoja. — Mba-*

se zë yt atë më parë ndonjë peshk dhe ke për t'u kënaqur. E, ore! — më thirri pastaj mua. — Si duket?

— Qenka ditë e keqe!, — iu përgjigja. — S'po e tund asnjë!

— Ti vështro të na prodhojë toka më shumë grurë, pa për peshkim, aha, nuk ke haber fare, o Tako djali.

Qesha.

— Si vajtët sivjet?

— Nuk kemi përfunduar akoma zonën malore, — iu përgjigja. — Fusha na kënaqi. Ishte vit i mbarë!

— Edhe ne këtej nuk do të dalim keq... Kam hall se mbase bie ndonjë pikë shi tani në gusht. Do t'i bënte mirë ullirit. Për besë, nuk mbahet mend vit më i mbarë. U thyen degët nga kokrrat. Po ti?, — plaku u kthye nga Klea. — Ç'do të bëhesh ti? Agrome si ytë atë.

— Jo, — tha Klea. — Unë do të bëhem piktores...

— Piktore?, — u habit plaku.

Edhe unë nuk ia kisha njohur këtë dëshirë vajzës sime, ndaj u ktheva më mirë nga ajo, të mësoja se çfarë e kishte nxitur të bëhej piktores.

— Po, — vazhdoi Klea, — ja, të bëj një hënë që del nga kodrat?

— Pa bëje... — e nxiti xha Lekoja.

Klea mori një shkop dhe nisi të vizatonte në rrërë vijën e lakuar të kodrave që kishte përballë. Herë pas here ngrinte kokën, mënjanonte me dorë flokët e gjatë dhe shikonte horizontin. Pastaj përkulej, diçka shkarraviste me shkop dhe... pas një hapi, vizatoi një rreth aq të përsosur, sa unë u habita.

— Nuk kam ngjyra!, — belbëzoi e pakënaqur. — Sa e bukur dukeet!

Unë dhe xha Lekoja vështruam njëri-tjetrin.



— Po mirë, — nguli këmbë plaku, — ç'të pëlqen të vizatosh më shumë... qytetet apo fshatrat?

— Kodrat dhe... hënën dhe... detin dhe... kanalin!, — u përgjigj Klea.

— Po tjetër?

— ... dhe peshkaqenin e mirë!

Plaku qeshi me të madhe dhe e përqafoi vajzën, i puthi flokët, pastaj sytë bojë deti e së fundi hundën pipiruve.

Aty nga ora tetë e mbrëmjes, drita e hënës, që binte në kanal, u pëkund befas dhe copat e verdha u përpoqën pas bregut ku qemë ulur. Vallkoja ishte zgjuar nga gjumi, dhe plaku më tregoi se duhej të kishte zënë shumë peshq.

— Zhvishu!, — më urdhëroi.

Pas pak unë dhe ai u futëm në ujën e ftohtë dhe kapëm, secili të tijin, dy hunjtë e trashë ku ishte lidhur rrjeta-kosh, në të dyja anët e kanalit... Ajo që shndriti përsëri mbi ujë, ishte një gjë aq e bukur, sa Klea, që na vështronte nga bregu, klithi e gëzuar. Peshqit e shumë të përpëliteshin të burgosur në rrjetën e dendur, ndërsa luspat e tyre dhe cipat e ujit ndërmjet katrorëve të vegjël prej spangoje, sa ndeshën me rrezet e hënës, shndritën si miliona kristale argjendi.

Gjahu ishte i mbarë dhe ne nuk u kujdesëm të hidhnim më në ujë as vallkonë e plakut dhe aq më pak grepat e mi. Në fund të koshit ishin ngjeshur ndonja pesëmbëdhjetë copë ngjala të buta, që do të përbënin mezenë tonë të këndshme të darkës. Klea vërtitej rreth grumbullit të peshqve, mundahej t'i mbërthente, por ato i shpëtonin dhe i gërvishnin duart me fletëzat gjembaçe. Dikur njërin prej tyre e mbër-

theu fort prej bishti dhe e ngriti kokëposhtë duke bërtitur:

— Gjyshi... gjyshi Leko... shiko sa i madh!

Si një peshkatar i vërtetë, plaku i kishte të gjitha mjetet për të përgatitur një darkë të këndshme buzë ujit. Ai nxori nga zjarri prushin e kuq dhe mbi të rreshtoi heshtat metalike, ku ishin mbërthyer ngjallat e buta. Pastaj u fut në kasolle, nxori prej andej një batanije të madhe, e shtroi dhe e ftoi vajzën të ulej mbi të. Gjysmën e batanijes ia hodhi në kurriz, ndërsa përballë saj, zjarri i madh i shndriste fytyrën dhe i bënte bebëzat e syve të vajzës të dukeshin si një det në flakë.

Ishte një mbrëmje e freskët, mbushur me zërat e korit madhështor të karkalecave. Klea, si hëngri dy ngjala pa bukë, u mbështet në njërin krah dhe nisi të dremiste...

— Ky ajër kaq i pastër!, — fola unë. — Ndoshta vetëm ky na ka mbajtur gjallë në fëmijërinë tonë të vobektë...

— Këtë ajër thith edhe jot bijë me barkun plot!, — ma ktheu plaku. — Mbase nuk ka për t'i harruar ndonjëherë këto vise. Kujdesu, Tako! Të kisha një mbesë edhe unë, — ai psherëtiu, — për nder, do luftoja ta mbaja këtu në fshat, pa edhe sikur ç'të bëhej! Po ç'e do! Plaka më qëllloi shterpë dhe nuk ma dha dot këtë gëzim. Po... nejtë, plot kam! Të gjithë janë të mitë! Të gjithë...

M'u dhimbs kur e dëgjova të fliste kështu dhe, ngaqë doja t'i ndërroja rrugë bisedës, i thashë:

— A bëjmë një gjë, xha Leko? Tutje nga vjeshtërat hidhu e rri ca ditë tek unë... Për nder, do t'ia kalojmë mirë...

Plaku më pa një sekondë. Nga drita e zjarrit i dallova në sy një shkëndijë ironie dhe aty për aty ma ktheu:

— Falemnderit, Tako! Unë pres që ti të vish përgjithmonë këtu, kurse zotrote më fton në qytet. Unë për vete, nuk dua të shkoj gjëkund. Kur nuk ika atëherë. . . tani nuk luaj më së këndejmi. E di sa mirë ia kaloj? Pastaj. . . në ardhja te ju, ti dhe jot shoqe keni për të qenë në punë, dhe unë do të mërzitem vetëm. . . Atje nuk kam as shoqëri dhe plaku pa muhabete nuk rron dot. . . Falemnderit! Por ti do ma bësh qejfin më shumë sikur të kujtohesh pak më shpesh për fshatin, për babanë tënd, për mua, për. . . këto kanale. Ja, kështu! Dhe vajzën dërgoje herë pas here këndej. Helbete, jeni prindër dhe ju merr malli, po, ama, ajo ka nevojë të dijë se nga është e ku i ka rrënjët. . . Ti për vete ike nga fshati atëherë kur ne ishim gjithsekush për vete, kurse tani. . . jua kemi nevojën, o bir, edhe njëzet agronomëve si ti. . . Mirë, xhanëm. . . urdhërohesh nga detyra, e di, po. . . eja, eja edhe këtu. . .

Ai heshti dhe i nguli sytë vajzës. Klea flinte. Në fytyrën e saj të ndriçuar nga zjarri dhe hëna, rrudha e zbetë që ia kisha dalluar në mëngjesin e po asaj dite, para se të zgjohej, ishte zhdukur. Xha Lekoja u ngrit dhe hyri në kasolle. Pas pak doli përsëri, mori vajzën në krahë dhe e shtriu brenda. Kur doli, m'u duk si një gjysh i dhembshur që kujdeset për të ardhmen e mbesës së tij të dashur.

Ne çokitëm gotat e rakisë, ndërsa përreth, nata e butë e korrikut përcillte në qiellin blu hënën e plotë ngjyrë portokalli. . .

## DËBIMI I HIJEVE

Dikur këtu ishte kënetë, dhe ky ishte një fshat që jetonte pa asnjë pëllëmbë tokë. Midis ujit ngriheshin ca platforma të mbështetura në hunj të trashë, ngulur në tabanin e kënetës. Mbi ta lëvrinte jeta njerëzore, e etur për një copë tokë të vërtetë, për hapësirë të vërtetë... Në qoftë se rruzulli ka male, dete, kodrina, qiell të kaltër dhe ujë, shumë ujë, këtu do t'i gjenim të gjitha. Perëndimi ishte gjithmonë gjëmues, lindja e dhëmbëzuar me kodra, jugu dhe veriu pafundësi e rrafshhtë, e mbuluar me ujë. Malet shfaqeshin jo vetëm pas kurrizit të kodrave por, ashtu të zhveshura e gri, kishin mbirë edhe midis detit.

Në të vërtetë kishte shumë tokë rreth e rrotull. Nga lindja toka ishte e ëmbël dhe me pleh gjethesh ulliri, nga perëndimi ajo ishte e rrafshhtë dhe e shkretë, mbuluar me rërë të florinjte e zhuka të dendura. Kodrat dhe malet ishin toka të ëmbla e të vërteta, po të paarritshme. Dhe etja për tokë të vërtetë, ku të kishte hije dhe ujë të ëmbël, ku fëmijët të kishin mundësi të vraponin pa u lagur e mbytur, ku bari të ishte bar i vërtetë dhe jo leshterikë që mbijnë në fund të kënetës, ishte shndërruar në dhjetëra së-

mundje që shkurtonin jetën e njerëzve. Ky fshat kishte të lirë e të hapur vetëm perëndimin. Një ishull shkëmbor, si një gur i madh e i rëndë në prag të derës, dremiste në mes të ujit. Andej vinin erërat, siç vinin edhe dallgët. Andej frynte garbino, që në disa orë e thellonte kënetën dyfish dhe dyshemetë e kasolleve notonin në mes të ujit.

Më vonë ujërat i përpiu deti. Ky regresion ishte aq i ngadaltë, sa u deshën shumë breza që tokën ta preknin me dorë, ashtu akoma baltë siç ishte, dhe disa breza të tjerë që të shkelnin në të zbathur dhe të mos zhyteshin deri në gju në llucë. Kufijtë vetëm pas kësaj morën formë. Gurët e parë u rrokullisën në themele që kullonin akoma ujë.

Njëra nga shtëpitë u ngrit pikërisht me themele mbi ujë. Guri gipsor, gjithë kristale gri në të kaltër, nuk mbante më larg se gjysmë ore. Ai gjithmonë kishte qenë aty. Një shkëmb i bardhë, që cënonte horizontin. Kështu ishte dukur ai, kur vështrohej nga mesi i ujit.

Shtëpia mbeti për shumë vite e gurtë vërtet, por me baltë e pellgje uji në prag. Pastaj të zotët e hershëm ngritën dheun e ëmbël nga kodrat dhe me të vulosën baltën e kripur. I pari dru që u mboll aty, ishte një selvi. . .

Ujërat u terën, por aty, në një qoshe të shtëpisë me gurë, vazhdonte të qëndronte një kasolle e lashtë, me dysheme të ngritur nga toka, trarët e së cilës kishin nisur të kalbeshin nga lagështia. Banorët e saj ngurronin akoma të preknin tokën e vërtetë, sikur bazamenti i lagët të ishte një kore e hollë, hileqare, që fshihte llumin e ish-kënetës.

Ndërkohë shtëpia me gurë po lulëzonte. Gipsi

*u shfaq aty rreth e rrotull me gjithë ashpërsinë dhe kureshtjen që sillte me vete. Kufijtë e oborrit të kësaj shtëpie nisën të zgjeroheshin dita-ditës dhe t'i afroheshin kasolles së lashtë. Dheu i ëmbël sillej me mushka të forta, që merreshin me qira kushedi se ku. Kishte raste kur këtë dhé e sillnin vetë banorët që jetonin aty rreth e rrotull shtëpisë me gurë. Për këtë punë merrnin një shpërblim të vogël në natyrë. Sa më shumë dhé sillnin për shtëpinë me gurë, aq më shumë zgjeroheshin kufijtë e saj. Ky zgjerim shkatërronte gjithçka gjente përpara. Trojet e dala nga uji bëheshin pronë e shtëpisë me gurë. Por kasollja më e afërt rezistoi. Ajo nuk i dha shtëpisë me gurë as edhe një grusht dhé. Vitet sollën gjyqe, dëshmira të rreme, gjak, skamje dhe përbuzje për kasollen e vjetër, por ajo mbeti aty, në një qoshe të kufijve të dhëmbëzuar të shtëpisë së gurtë, gjersa koça i vuri pritë vërshimit të saj, e stepi në vend, nisi t'i shkurronte krahët. . .*

## 1.

Plaku nguli pas dërrasës qysqinë e rëndë dhe e tërhoqi pranë vetes. Gozhda e ndryshkur vajtoi me një krismë të thatë dhe e lëshoi dërrasën shpejt. Atij i theri në zemër. Ishte e para herë që vinte dorë të shkatërronte mallin e vet. Gjithmonë ishte munduar të shtonte diçka brenda atij oborri, të cilin e quante pronë të tij.

Vendosi dërrasën mbi një trung ulliri të vjetër, të mbështetur rrëzë murit dhe u përpoq ta thyente me këmbë. Luftoi kështu për disa minuta rresht. Pas kësaj, ahu i kalbur u copëtua atje ku e donte pla-

ku. Gozhdët i kishte në xhep. Ai pështyu përtokë dhe ngriti sytë e pa qiellin. Ishte fare i pastër. Nuk kishin mbirë akoma yjet, dhe flakërima e fundit e diellit kishte ngjyrosur dy fije të holla resh, që dukeshin si të palëvizshme. Ngriti dërrasën nga toka, e zvariti përgjatë oborrit dhe hyri në shtëpi. Në korridor mati me sy gjatësinë e derës së majtë, pastaj shtriu tetë herë pëllëmbën mbi dërrasë. Ishte e dyta që po ngulte kryq derës. Çdo gozhdë sikur e ngulte në mishin e tij. Në të gjitha skutat e shpirtit e ndiente se këto gozhdë po i hiqnin, me një farë mënyre, të drejtën e pronësisë mbi njërën prej dhomave të shtëpisë së tij.

Në fund të dhjetorit ishte shembur muri i avllisë. Në shkurt, një natë me shi e furtunë, befas, çatia kishte klithur vajtueshëm dhe muri i dhomës së mirë, siç e kishin quajtur gjithmonë, ishte thërrmuar si të ishte pa themel. Që nga ajo natë shtëpia i zbuloi të gjitha plagët sheshit. Mbi dyshtemenë e dhomës së shembur dukeshin tani copa tjegullash të thyera, blazë nga ajo e trarëve, copa patavrash të kalbura, gozhdë të ndryshkura, suva e rrëzuar. Kështu, dashur pa dashur, plaku u kujdes të ngulte dërrasën e parë në derën e dhomës. Një ditë i erdhën disa njerëz në shtëpi dhe e këshilluan t'i forconin trarët e çatisë me dy-tri shtylla të forta, sepse kështu kishte mundësi të shpëtonte, së paku, dhomën tjetër. Deshi s'deshi, ai u tha njerëzve të vinin dorë mbi selvinë e madhe në oborr. Këtë e pat shqiptuar me zë të shuar. Selvinë ai e donte thujse më shumë se shtëpinë, sado e çuditshme që mund të duket kjo. Por atë e prenë. Pas kësaj, çatia e dhomës së rrëzuar mbeti kështu e pa-

lëvizur, e zyrtë, sakate, e mbështetur mbi dy shtylla selvie.

Që pas shembjes së murit të avllisë nata i dukej shumë e frikshme. Dëgjonte se si era fërshëllente me trishtim e trazonte tjegullat. Kur kishte hënë, vezulli-mi i rrezeve të saj mbi copat e xhamave të dritares së vetme, të jepte përshtypjen e dhjetëra syve fosforishentë, të ngulur në errësirë.

Ai nguli dërrasën dhe lëshoi gurin afër derës. Gjithçka i dukej tani e gozhduar paq. Edhe dritaren e dhomës ku flinte, e kishte gozhduar me dërrasa të kryqëzuara. Me një farë mënyre ai po e fortifikonte më së miri shtëpinë; nuk kishte asnjë dëshirë që atje të futeshin të tjerët. Vetëm plevica po katandisej keq, duke ia shkukur një nga një të gjitha dërrasat.

«Nuk kam ç't'i bëj!, — tha plaku me vete. — Pa shkatërruar nuk mund të ndreqësh. . .»

Pas disa vitesh vetmie të plotë, një natë më parë, ai kishte ndier ca zëra pranë dhomës së shembur. Ishte shtrirë në rroba dhe po mundohej të afronte gjumin, kur dëgjoi një bisedë të shkëputur. U ngrit me nxitim të vinte veshin mirë, por pas kësaj nuk dëgjoi më asgjë. Kjo i mjaftoi, për të menduar se përpiqeshin ta vidhnin. Të zbulosh këtë fakt, duhet të marrësh masa. Kështu kishte bërë edhe ai.

Tani, pakëz i qetësuar, hyri ngadalë në dhomën ku flinte dhe ndezi kandilin. U hodhi edhe një herë sytë dritareve të gozhduara dhe u shtri në rroba. Musandra e madhe mbeti e hapur kanat.

Jeta lëvrinte këtu ngadalë, e druajtur, me një kob të madh mbi krye.

Këtu nuk kishte hyrë askush, prej shumë kohësh.



Të moshuarit s'e kishin përfytyruar kurrë në këtë gjendje këtë shtëpi. Të vegjlit ia kishin pasur zilinë, deri para disa javësh, selvisë së madhe. Tani që e prenë edhe atë — sikur e preu një dorë e padukshme, natën, nën kërcënimin e qenve të lagjes — askush nuk interesohet më për shtëpinë që po shkatërrohet. Vetëm postieri vinte një herë në muaj dhe sillte një copë letër, ku ishin shënuar, përveç emrit të plakut dhe fshatit, një shumë të hollash. Në shumicën e rasteve ai firmoste vetë në emër të marrësit, e lëshonte letrën aty, përfund derës së kalbur dhe largohej duke nxjerrë nga gjoksi një psherëtimë të thellë. Kokën nuk e ktheu kurrë ta shikonte për të dytën herë atë portë.

Sa herë që largohej, i uronte vetes të mos kthehej më kurrë këtu. Këtë kishte vite që e shpresonte.

Dikur kjo shtëpi i përkiste qytetit, sado që ndodhej në fshat. Kishte qenë pronë e ligjshme e tij, ndonëse e pashënuar në asnjë nga defteret e trasha të kadastrës. I kishte shërbyer gjithë jetën qytetit. Tani që po kalbej, po shkatërrohet, po nxihej, kërkonte ndihmë nga fshati. Po, nga fshati! Sepse selvia ishte e fshatit! E kishte rritur toka e tij!

Qyteti mbante gati një orë prej andej. Dikur thoshin se qyteti do të kishte falimentuar me kohë, sikur të mos ishte fshati. Që këtej ai pati marrë verë, raki, arra, bukë. Ai nuk i dërgonte fshatit asgjë. Sepse nuk kishte ç't'i dërgonte, veç dy-tri karrocave me katër rrota, të tërhequra nga kuaj që u numëroheshin brinjët, me të cilat sillte në fshat sende që zbraznin në skelën e qytetit vaporët e huaj.

Edhe vaji që dilte nga ullinj të fshatit, nuk shi-

tej gjëkund. Thoshin se e merrnin vaporët. Hidhnin në breg basma dhe merrnin vaj e vajguri.

Gjithçka e merrnin vaporët. . .

## 2.

Të nesërmen pasdite, Andrea doli i kërrusur nga klubi i fshatit, me një paqetë «Dajti» në njërën dorë, ndërsa mundohej të fuste në xhep shkrepësen. Te dera e klubit pështyu. Trupin e kishte të përthyer, fytyrën të gjatë, të thatë, të zhubravitur nga rrudhat. Sytë e vegjël, nën ca vetulla të trasha kaleshe, i dukeshin si dy copa thëngjij të zinj. Hunda e madhe me majë i ishte përkulur në drejtim të mjekrës së mprehtë që ngrihej përpjetë, duke lënë midis vetes dhe hundës një gojë të madhe, pa dhëmbë e me buzë të holla.

Mbi sofatin e portës së madhe të shtëpisë së tij një djalë i vogël diç po vizatonte me një laps kopjativ, por, sa pa plakun, u hodh poshtë dhe doli në rrugë. Futi duart në xhepa dhe po ndiqte me vëmendje lëvizjet e ngadalta të këmbëve të tij, që dukeshin sikur zvariteshin gati për të mbetur në rrugë. Kur kaloi ai, fëmija u mënjanua. Ai ktheu kokën dhe e pa me kureshtje. Kishte ditë që e shikonte mbi sofatin e ngushtë të portës, mirëpo nuk e njihte dot i kujt ishte. Njëherë kishte dashur ta pyeste, por ishte pënduar dhe pati hequr dorë. Tani i ndaloi përballë dhe i nguli sytë e zinj, të egër e pak të përlotur. Edhe fëmija e shikoi. Sytë e tij të kaltër shprehën atë çast një farë frike.

— Xha Andrea! . . . , — foli ai dhe u mundua t'i buzëqeshte.

Plaku nuk iu përgjigj. E vështroi edhe më. Fëmija u zmbraps e u fsheh pas një cepi muri.

Andrea hapi derën, e mbylli pas vetes, hyri në korridor e pastaj në dhomë. U ul këmbëkryq mbi rrobat e shtruara në njërën anë të vatrës dhe rënkoi. Për herë të parë u pendua që nuk i tha fëmijës një fjalë të mirë. Djali që gjente çdo pasdite mbi sofatin e portës, mund ta ndihmonte. T'i sillte ujë, për she-mbull. Fshati mbushte ujë në një pus të madh, dhe atij i priteshin këmbët të shkante deri atje.

Vendosi që të nesërmen t'i thërriste të afrohej. Atë mund ta gënjeje edhe me një karamelë, por Andrea nuk do t'i harxhonte kurrë njëzet qindarka për të.

Plaku ndezi një cigare...

Ai ishte shtatëdhjetë vjeç. Vitet ishin treguar të pamëshirshme me të. Fundja, shtatëdhjetë vjeç nuk është kushedi çfarë. Moshatarët e tij bënë akoma dru në pyll, ndërsa ai ishte kërrusur, ishte tharë e po sfilitej, megjithëse kishte rrojtur mirë dikur. Po jo gjithmonë besonte se ishte aq plak, sa ç'dukej në të vërtetë. Atij shumë rrallë i takonte të shihej në pasqyrë dhe, përveç ndjenjës që gojën e kishte pa dhëmbë, nuk mund të besonte se ajo po i shtrembërohej, po i futej brenda e buzët po i holloheshin çdo ditë.

Vetmia nuk është kurrë aq e tmerrshme, sa ç'mendojnë disa. Andrea mendonte krejt ndryshe: tani nuk e shqetësonte askush, askush nuk ndërhynte më në pasurinë e tij.

Atij i kishte mbetur akoma edhe një pasuri, një çek mujor prej tridhjetë dollarësh, që i vinte nga një afërm i tij, që e kishte lënë fshatin para lufte. Disa herë ai nuk ia kishte dërguar rregullisht këtë çek, dhe Andrea besonte se ky njeri po falimentonte.

Para lufte, bile edhe gjatë saj, Andrea e pati ndihmuar shumë këtë kushëri të parë. Ai llogariste se duhej të kalonin akoma edhe afro njëzet vjet të tjerë që kushëriri t'i lante borxhin. Kjo pat qenë një hua tregtarësh, që dikur pretendonin të bëheshin bor-gjezë dhe nuk kishte asgjë të përbashkët me gjakun që i lidhte. Me një farë mënyrë, plaku Andrea mendonte se kishte investuar një kapital, ndonëse shumë larg, që do t'i siguronte tani pleqërinë.

Gëzohej si fëmijë kur e gjente çekun përfund derës së kalbur, e zhubraviste njëherë, si ta provonte se sa i vlente lëkura, pastaj merrej disa orë të mira me të, duke e shtrirë e lëmuar në pëllëmbë të dorës.

Në shtëpinë që po shkatërrohej, ra nata. Pak më vonë se ora shtatë e mbrëmjes ai fillonte dialogje të tjera, të çuditshme me vetveten. Kështu nuk kishte biseduar kurrë me njerëzit. Minjtë zhurmonin nën tjegulla. Rrëzonin ndonjë copë blözë a myshk të tharë, kishte raste që zbrisnin edhe deri në dysHEME e strukeshin nën mbulesat e plakut.

Atë natë kishte hënë, dhe ai nuk u ngrit të ndizte kandilin. Sa të ngrihej hëna mbi çati, me siguri do ta kishte zënë gjumi. Fshati po bënte disa vjet me dritë elektrike, ndërsa ai rronte me kandil. Tani, në pleqëri, dritës elektrike ia kishte frikën. Nga çdo dritë e fortë trembej, po rrufeja sikur e ngushëllonte; dikur pati shpresuar se ajo do të binte mbi dyqanin e Filipit, të vetmit konkurrent të tij, dhe do ta bënte shkumb e hi.

Atë zakonisht nuk e zinte gjumi shpejt. Dhe mendohej. Në shumicën e netve kujtonte vetëm një ngjarje. Para saj çdo gjë tjetër kishte humbur në mje-

gullën e kohës. I dukej sikur jeta e tij kishte filluar në të dyzetat, kishte jetuar pak vite, pastaj i kishin thënë se do të vdiste. Vdekjen ai e priste nga dita në ditë, mirëpo kishin kaluar njëzet e pesë vjet dhe ajo nuk po dukej. E vërteta është se ai nuk donte të vdiste. Tmerrohej edhe tani, në atë moshë, aq më tepër kur mendonte se nuk do të vdiste si gjithë njerëzit. . .

Hëna u struk pas selvisë së madhe të kishës. Dhoma u zhyt në gjysmerrësirë, një errësirë gri, jo e plotë, nëpër të cilën plaku, pas pak, nisi të dallonte shumë sende. Iu kujtua përsëri fëmija që takoi dy orë më parë. «Ç'fëmijë!», — mendoi. Ai kishte parë fëmijë të tillë në shumë vende të botës, ku kishte qenë para të dyzetave, po fëmijët e fshatit të tij ishin më tepër çapkënë. Ata. . . me siguri nuk shkruanin me laps kopjativ nëpër sofatet e dyerve dhe nuk thërrisnin kështu: «— Xha Andrea!» (Eh, ndofta «zoti Andrea!»), as nuk mblidhnin kallinj gruri pas autokombajnave. . .

Nesër duhej t'i blente patjetër një sheqerkë. Po, para kësaj, duhej të pyeste i kujt ishte ai fëmijë. Ndofta i ndonjërit prej atyre, emrin e të cilëve e mban-te akoma në bllokun e borxhlinjve të dyqanit. Atëherë edhe një sheqerkë do të ishte e tepërt.

Papritmas dëgjoi një zhurmë, që iu bë se vinte nga dhoma e shembur. Mbajti vesh. U ngrit më mirë nga dysheku, mbështeti shpinën pas murit dhe shquu sytë nëpër errësirë. Dëgjohej kënga monotone, e zgjatur e karkalecave. Pastaj iu duk sikur dëgjoi edhe një pëshpëritje. U ngrit nga vendi, ra përmbys mbi dysheme dhe u zvarit kështu deri afër derës së dhomës.

Dëgjoi një zë që thoshte:

— Mos ki frikë...

— .....

— Shëët! Avash... Ja, afrohu më këtej.

Njëherë dyshoi se mos kjo bisedë bëhej në rrugë. Vuri veshin të dëgjonte më mirë. Ndjeu se si rrëshqiti diçka pas murit të dhomës tjetër dhe një tjegull luajti nga vendi. Ai i dallonte mirë tingujt që lëshonin tjegullat. Kishte vite që vetmia e detyronte të dallonte edhe tingujt më të lehtë të sendeve. Sidomos tingujt e natës.

Plaku ndjeu një frymëmarrje të vështirë. Ai që fliste, siç dukej, kishte vrapuar. Frymëmarrja sikur vinte nga thellësia e murit.

— Ti duhet ta kuptosh, — foli përsëri zëri. — Ai nuk bëri aspak gabim që ta tha aq haptazi. Fundja, nuk është ndonjë gjë e madhe.

— Nuk dua ta dëgjoj më këtë muhabet!, — u përgjigj më së fundi zëri i dytë.

Plaku dalloi zërin e një femre.

— Më duket se nxitohesh përsëri, — foli djali. — Në fund të fundit, ti duhet ta kuptosh drejt, sado që nuk është faji yt.

— Edhe ky gjykim nuk më pëlqen, — tha vajza. — Kemi dy mbledhje me radhë që po diskutojmë çështjen tonë. As ti vetë nuk ke bërë më shumë. Shko de, bisedo haptazi me babanë tënd!

— Po ti, Arta, premtove se...

— E kam të vështirë, më beson, e kam shumë të vështirë. As që guxoj t'i dal para syve.

— Eh, Arta, Arta!, — ngriti zërin befaz djali.

«Arta?! E kujt është kjo bishtdredhur, xhanëm?, — donte të dinte plaku. — E Petros? Nuk besoj! Kaq afër shtëpisë së saj? Kushedi, do të jetë ndonjë Artë

tjetër». Mbështeti duart pas murit dhe deshi të ngrihej. Ai nuk donte që shtëpia e tij të bëhej vend i takimeve të tilla. Muri i shembur e kishte fajin. «Shyqyr që nuk më ka mbetur gjë andej. Do të m'i për-lanin të gjitha».

— Mirë tani... Afrohu... ashtu... Kujdes!  
U thye një tjegull.

Ai dëgjoi se si njëri nga ata të dy qeshi me zë të ulët. Plaku nuk e dalloj se kush ishte, djali apo vajza. Sidoqoftë, atij i shkoi diçka nëpër mend dhe i uli duart nga muri në dysheme. Tani i ngjante një qeni që nuhat në errësirë.

— Ne nuk duhet të zemërohemi nga Kiçua, — tha djali pas pak. — Fundja, ai është shoku ynë dhe na do të mirën.

— ....

— Kaq shpejt?

— Më presin, — u përgjigj vajza.

— Kur zërat u shuan fare, Andrea psherëtiu thellë...

### 3.

Fëmija futi duart në xhepa dhe iku. Në shtëpi gjyshja Stamato, me macen në pëqi, dremiste, dhe ai, sa hapi derën, e pa dhe qeshi. Hyri në majë të gishtave, u ul mbi kanapënë përballë dhe një copë herë vështroi gjyshen. Shamia e zezë i shtrëngonte ballin dhe koka i dukej si një top llastiku i madh. Papritmas, ai e krahasoi me plakun Andrea. Për çudi, ndjeu se ata ndryshonin shumë nga njëri-tjetri, sado që të dy ishin pleq... Po ai pse nuk kishte nipër, xhanëm? Po mace pse nuk kishte? Cilin përkëdhel, vallë? Nga ana tjetër, fëmija mendonte se Andrea e kishte pisk

punën edhe me shtëpinë. Ajo, me siguri, do të shembur një ditë, ashtu fare papritur, siç ishin shembur dy mure, dhe do ta zinte plakun brenda. Këtë e kishte kuptuar kur pa dhomën e shembur të mbështetjes pas atyre dy shtyllave. Nuk u besonte shtyllave. «Vetëm muret mund të mbajnë një shtëpi në këmbë. Apo jo, moj gjyshe?», — pyeti gati me zë.

Djali vazhdonte të vështronte gjyshen dhe u argëtua ca me qimet e rralla që i kishin mbirë në cepat e buzës së sipërme. Ato përkuleshin herë lart e herë poshtë, nga fryma që nxirrnin buzët e mbledhura. Pastaj hapi çantën, nxori fletoren e detyrave dhe nisi të shkruante.

Dhoma ishte e ngushtë dhe e gjatë. Përbri minderit ku ishte shtrirë gjyshja, ishte krevati i Artës. Muret dukeshin shumë të bardha. Mbi krevatin e Artës varej një bandë, punuar me kryqe në stof të zi, që djalit i kishte pëlqyer gjithmonë.

Dalngadalë po errej. Ai u ngrit dhe ndezi drithën. Gjyshja u tremb dhe u zgjua. Macja vazhdonte të mbante sytë mbyllur.

— Paskë ardhur ti?, — pyeti ajo dhe hapi gojën.

Pastaj goditi lehtë në kokë macen dhe ajo u zgjua. U shtriq, kërceu në dysHEME dhe u fut nën minder.

— Ku bridhje deri tani?, — filloi të pyeste ajo. — Vajti ora pesë dhe ti akoma nuk ke bërë mësimet. Hajt, pa tani vjen yt atë dhe t'i shkul veshët!

Ai nuk iu përgjigj. Ngriti sytë dhe i buzëqeshi. Sikur të ishte e munduar të kishte gjyshen për mësuese, besonte se ajo do t'ia merrte shpirtin. «Detyrat... detyrat... detyrat...!» Pale, po ajo as që besonte sa herë që ai merrte ndonjë dhjetë! Kishte raste



kur babai kthehej nga mbledhja e prindërve dhe i rrihte krahët:

— *Mirë edhe këtë javë.*

— *Ç'mirë, more!, — ia priste gjyshja. — Ky bredh gjithë ditën e ditës dhe nuk mëson fare. Si i merr ato të shkreta nota të mira! Mos e mban gjë mësuesja me hatër? E shkreta! Ku ta dijë ajo se ky shkarravit nja dy orë dhe luan gjithë ditën?*

— *Gjyshe, po ja, moj, këtu ka gjithë ato dhjeta!*

— *Posi... posi... — ia kthente ajo me mosbesim.*

Ai e dinte se gjyshja nuk i njihte notat dhe ndonjëherë edhe tetat ia tregonte për dhjeta.

Tani plaka i shkoi pranë dhe vështroi për një kohë të gjatë se si ai i nxirrte shkronjat me penë. Pastaj shkundi një rrugicë, e shtroi përsëri në korridor dhe vajti e u ul në shkallinën e sipërme. Shtëpinë e kishin me dy kate, me qoshe guri dhe mure tullash. E vërteta është se kjo shtëpi po bënte, avash-avash, pesëmbëdhjetë vjet që ishte ngritur dhe tullat, që atëherë bëheshin në kaminot e fshatit, qëlluan jo edhe aq të pjekura. Shqotat dhe dimrat kishin nisur të thellonin llagëme në to. Petroja, i zoti i shtëpisë dhe djali i vetëm i plakës Stamato, pati menduar shpesh ta suvatonte nga jashtë. Në fillim i pëlqente shumë ai kontrasti i grisë në të kaltër i gurëve gipsorë të qoshes, me të kuqen e tullave dhe kishte vendosur të mos e suvatonte kurrë. Po ja që vitet e zhgënjyen dhe tani ai kishte vendosur ta zbukuronte shtëpinë nga jashtë.

Plaka Stamato shikonte fshatin. Atë mbrëmje të butë dhe të kthjellët pranvere gjyshja besoi, për herë

të parë, se fshati ishte rralluar shumë. Dikur shtëpitë e ngjeshura pas njëra-tjetrës formonin rrugë e rru-gica të dendura, me çati gri, gjithmonë me një mur të përbashkët. Kurse tani... Djemtë rriteshin, martoheshin, ndaheshin nga vëllezëria dhe secili hidhte themele të reja nën ullishta. Atje toka është e ëmbël e pjellore dhe, ndonëse plaka Stamato tani e kapërcen rrallë pragun e shtëpisë, e dinte se këto dhjetëra shtëpi të reja i qarkonin kopshte të vërteta, plot pemë dhe zarzavate. Veç, asaj nuk i pëlqente kjo zhvendosje e fshatit. Besonte se mbrëmjeve të verës, nën ullishta, duhej të kishte konupe, kurse aty era e athët e detit i shfaroste trumbat e tyre. Ky ndoshta mund të ishte një arsytim sa për të mbushur mendjen, sepse shkretëtirës së fshatit të vjetër s'kishte ç't'i pëlqejë më. Gjithë-gjithë aty kishin pemë para shtëpive vetëm katër-pesë familje, që e patën sjellë dheun e ëmbël nga larg, dhe oborri i pasëm i Shënededjelës, ku rriteshin tri qiparise trungtrasha, lëkurërrjepura, të gjata mbi njëzet metra, kordha të vërteta në formë, por që shumë prej degëve të tyre kishin vite që nuk jeshilonin më. Ishte edhe selvia e Andreas, që e kishin prerë tani së fundi. Këta katër drurë të vetmuar dhe kambanorja e lartë me pesë kryqe në majë, mbi çatitë gri, i patën dhënë fshatit dikur formën e një varreze vigane. Gjelbërimi ishte i pamundur. Kur u ndërtua shtëpia e parë nën ullishta, të gjithë thanë se ai vajti në fund të dynjasë, se i vetëm e pa gjithmonë do të ishte si bagëtia e ndarë nga kopeja e shumë llafe të tjera. Po tani, plaka e besonte plotësisht këtë tërheqje të fshatit.

Ajo po mbushte dalngadalë të njëqindtat. Në të ri të saj duhej të kishte qenë një grua truplartë, shu-

më simpatike, me trup të rregullt e të plotë. Një moshë të tillë e kishin arritur shumë pak pleq dhe për plakën Stamato flitej se do të thyente rekordin. Djemtë e rinj e ngacmonin shpesh Artën për gjyshen e saj dhe i thoshin se plaka ishte e denjë për një martesë tjetër tani në prag të njëqindvjetorit. Arta ishte tërë gjyshja. Këtë e thoshte gjithë fshati. Plaka shihte te vajza e re rilindjen e madhështisë së saj të dikurshme si grua. . . Në vitin 43 ajo grua ishte shtatëdhjetë e katër vjeç. Kishte pesë fëmijë të gjallë; katër të tjerë i kishte ngrënë dheu pa mbushur motin. . . Pikërisht atë vit, vdekja i rrëmbeu jo më një motak, po një trim tridhjetëvjeçar, nëpërmjet plumbit të të huajit. Ky ishte i shtati dëshmor i fshatit, që e kishte dhënë jetën thuajse në prag të shtëpisë. . .

... Mbledhja e Qarkorit kishte katër orë që kishte filluar dhe plaka Stamato rrinte fshehur pas një vandaku drurësh ulliri, të cilin e kishte hequr zvarë nga shtëpia e saj dhe e kishte sjellë deri te cepi i oborrit të shtëpisë së Andrea tregtarit. Këto dy shtëpi nuk i ndanin dot as dy hapa dhe, meqë tregtarin e vizitonin shpesh të njohur e të panjohur, plaka aty e kishte syrin. Këtë detyrë nuk ia kishte ngarkuar askush; ky ishte instinkti i nënave që ruajnë djemtë e tyre, paçka se sa mund të zgjaste kjo pritje. Stamatoja i trembej më shumë këtij tregtari fjalëpak, që dukej sikur merrej vetëm me punët e tij, sesa të gjithë ballistëve që vinin çdo ditë në fshat. Nata kishite dritë të pakët e, megjithatë, plaka mundej të dallonte se si në thellësi të reve zvarisej një gjysmë hëne që ato ditë ishte në të shuar. Kulla e lartë e kambanores së Shënedjeles dukej sikur nxitonte për-

mes qiellit. Kishte një zhvendosje resh nga perëndimi në lindje, dhe kjo lëvizje e fshehtë e natës sikur përpiquej të merrte me vete gjithë trupat e lartë e të hollë. Pas kambanores, në largësi të pandryshueshme lëviznin edhe katër selvitë e larta, tri të kishës dhe një e Andrea tregtarit. Ajo e dinte se në anën tjetër të shtëpisë bënte rojë Paskali, djali i saj i madh. Petroja, djali i dytë, ndonëse më i vogël, ishte brenda në mbledhje. Për këtë arsye vrojtonte e fshehur, sepse po ta diktonin të bijtë, do ta fushnin në shtëpi.

Shtëpia e Andreas ishte e heshtur, as dritaret nuk kishin dritë. Nga plevica e madhe në fund të oborrit sikur vinte një erë thartire, dhe plaka besonte se kutërbonin vozat e mëdha të bërsive të rrushit, që ishin zbrazur ato ditë. Ndiente pak ftohtë. Dritares së vogël të shtëpisë së saj, që shikonte nga ajo anë, i kishin hedhur një batanije të trashë, por plakës, ngaqë e dinte, i dukej sikur drita dallohej shumë nga jashtë. Aty bëhej mbledhja. «Përse nuk e ulin edhe pak fitilin e llampës?» — nisi të mendonte befas ajo. E përpirë nga ky ankth, nuk dalloi se si dy hije iu afruan portës së shtëpisë së Andreas dhe u futën në oborr. Dëgjoji vetëm kanatin e rëndë që u mbyll. Kjo krismë e solli në vete. Disa sekonda më pas ndjeu hapa të tjerë të lehtë. Shqeu sytë nëpër errësirë dhe, para se të vendoste për të lëvizur, dalloi të birin. Paskali u tërhoq zvarë përgjatë murit që rrethonte shtëpinë e tregtarit dhe doli afër rrugicës. Ra qetësi, kështu që plaka nuk i dha shenjë jete të birit. Ai u kthye përsëri, ashtu zvarë-zvarë, në tokën e ftohtë, dhe nëna ndjeu drithërima.

Ajo tundi një degë nga vandaku dhe gjethet e thara kërcitën. Paskali shtrëngoi pushkën e shkurtër.

— Jam unë!, — belbëzoi ajo.

— Ah!, — klithi lehtë Paskali.

Ata u mbloodhën aq pranë, sa ajo pati mundësi t'i mbyllte gojën me pëllëmbën e ftohtë.

— Po në qofshin një lukuni ujçerish?, — e pyeti pastaj.

— Kam urdhër të ngjitem në kambanore dhe t'i bie kambanës së veriut, — ia ktheu ai. — Është sinjali për territorialët.

— Dëgjove gjë pak më parë?

— U mbyll porta e Andreas, m'u duk, — iu përgjigj ai.

Plaka tundi kokën.

Ato dy shtëpi ishin aq pranë njëra-tjetrës, e megjithëkëtë jetonin krejt ndryshe. Shtëpia e plakës Stamato kishte mbetur në kufirin lindor të murit të madh që rrethonte shtëpinë e Andreas. Në 43-në ky kontrast ishte thelluar nga ngjyrat që përflaknin ditët. Kalaja e rrethuar me mur dridhej para kasolles së brishtë.

Atë natë ajo i vështronte këto mure dhe i duke-shin sikur po Tëkundeshin edhe ato. I bëri shenjë Paskalit të kalonte nga ana tjetër e shtëpisë, por pikërisht atë kohë u hap dera e pasme e kishës dhe një grumbull hijesh gjysmë të përkulura kapërcyen murin e ulët dhe u hodhën në rrugë. Paskali shënoi me pushkë. Plaka u bë njësh me tokën. Vandaku i druve u përmbys mbi të. Ajo e shtyu si mburojë dhe u zvarit disa metra përpara. Të shtënat u dendësuan dhe ja, pikërisht atë çast përbrenda oborrit të tregtarit u dëgjua një ulërimë rrëqethëse. Figurat e errëta që kishin dalë nga kisha, u stepën një çast. Plakës Stamato iu ngritën leshrat e kokës përpjetë. «Kështu

mund të ulërijë një i therur», — mendoi befas. Jehona e klithmës u end vetëm disa çaste mes zhurmave të luftës, por pa mundur t'i stepte ato plotësisht. Nata i mori me vete. Paskali shënoi përsëri. Plaka vësh-troi dritaren e shtëpisë së vet. Drita e fenerit nuk dallohej më. Prej andej buronin flakëza pushkësh. Ajo u ngrit në gjunjë dhe i nguli sytë të birit. Paskali ishte mbështetur pas cepit të murit që rrethonte shtëpinë e tregtarit dhe pushka e shkurtër dukej si një lodër në duart e tij. Plaka e shtyu më tej vanda-kun e druve. Shpërtheu një bombë. Drita e saj e verboi. Nata lëvizte me shpejtësi. Ajo u ngrit dhe vrapoi përpara. Krismat e pushkëve u dendësuan dhe klithmat pasonin njëra-tjetrën. Stamoto u gjend te dera e pasme e kishës. Një hije u shty në thellësi dhe mori përpjetë një palë shkallë të drunjtja.

Eci përpara me vendosmëri. Gati pa mend, ajo ngjiti shkallët e shumta të kambanores së lartë dhe në platformën e sipërme, ku vareshin kambanat e mëdha prej bronci, një njollë e zezë ishte shtrënguar pas murit. Plaka njohu priftin.

— Papu!, — klithi lehtë gruaja. — Bjeri kambanës së veriut.

— Aaaa... Hëëmm... — bëri prifti, pa lëvizur nga vendi.

— Bjeri!, — thirri ajo së dyti.

— E mallkuar!, — belbëzoi njeriu me raso.

Stamatos i vetëtiu në kokë ideja e vetëruajtjes. Pastaj me shpejtësi kapi gjuhëzën e rëndë të kambanës dhe e përplasi me forcë pas broncit. Krismat lanë kambanoren dhe u përhapën nëpër natë. Era e fortë i shpupuriste Stamos flokët e dendur dhe cepat e shamisë që i kishte shkarë nga koka.

Ajo platformë kishte pamjen e një ballkoni ajror dhe nata e bënte më të besueshme këtë ndjesi. Nën bronc lëvrinte një errësirë e dendur, kurse mbi sipërfaqe të tij, edhe në ato orë të mesnatës, dallohehin njolla gurrkali, që flisnin për oksidimin e bakrit në atë aliazh. Këto njolla vezullonin herë pas here dhe zgjasnin pejza rrezesh në tavanin kubik të kambanores. Plaka Stamato nuk kishte pasur rastin kurrë të hipte në një lartësi të tillë. Natyrisht që nuk ishte koha të sodisje fshatin prej andej. . . Një plumb u përplas befaz pas kambanës së veriut, bëri rikoшетë dhe u zhduk në errësirë. Plaka e ndjeu se e kishte diktuar. Tre plumba të tjerë depërtuan nëpër boshllëqet midis kambanës dhe dritares vigane dhe kaluan në anën tjetër. Ajo u mënjanua në qoshe. Prej andej pa një fshat të errët, si një grumbull breshkash të zeza, me çatitë-korraca mbi krye dhe vetëtima të ulëta plumbash që ngjasonin me xixat e një kovaçhane të errët. Kaq pa plaka Stamato. Dhe kjo do të mjaftonte për gjithë jetën. Në intervalet midis të shtënave ajo lëvizte sa nga një kambanë te tjetra dhe përplaste gjuhëzat pas qiellzave të thella. Këto katër gojë me zëra të ndryshëm shpërndanë mbi fshat simfoninë e alarmit. Një projektor lëvizi nëpër natë dritën e tij të shqetësuar dhe e përplasi pas kodrave. Stamatoja la gjuhëzat e rënda dhe uli shpinën. Prifti ishte zhdukur me kohë në thellësi të vrimës nga zbrisnin shkallët e ngushta. Ishin dendësuar krismat. . .

Prifti ishte pushkatuar të nesërmen, sapo ishte varrosur Paskali. Plaka, që kishte qenë e pranishme në këtë pushkatim, kishte belbëzuar:

— Ky nuk është zoti. Ky është djalli!

... Që prej asaj dite kjo grua u shtoi rrobave të zeza që kishte veshur disa vite më parë, pas vdekjes së të shoqit, shirita të hollë, të kuq. Çorapet e kishin këtë fill thua jse mbi kërcinj. Jeleku i ngushtë kishte dy vija të tilla: një në fund të gjatësisë së tij dhe tjetrën në mes të shpatullave. Fustani i gjatë me pala të shumta e mbante këtë vijë të kuqe një pëllëmbë poshtë brezit të gjerë që i shtrëngonte mesin. Vetëm shamia e kokës ishte krejt e zezë.

E veshur kështu, qëndronte edhe tani në krye të shkallëve dhe priste Artën. Ditët e fundit ajo vonohej shpesh dhe kthehej në shtëpi natën. Petroja e ngushëllonte për këto vonesa të së bijës, duke i shpjeguar se mbledhjet e rinisë bëhen zakonisht mbrëmjeve, pas punës.

Një natë më parë ajo kishte thënë e zemëruar:  
— Çdo natë mbledhje? Po është vajzë!

Arta mbërriti pak më vonë se vëllai i saj i vogël që kishte mbaruar mësimet dhe ishte ulur së bashku me gjyshen në krye të shkallëve. Ajo i kishte marrë të nipit fytyrën në pëqi dhe i kruante kokën. Fëmijës gati sa nuk i mbylleshin sytë nga kënaqësia. Ndaj, kur erdhi Arta dhe plaka u ngrit në këmbë, atij i erdhi inat me të motrën.

— Erdhe? Ku ishe?, — pyeti plaka me një vështrim aspak të ëmbël.

E reja u përkul pak dhe e puthi gjyshen në faqe. Ajo praronte ato ditë nga një zjarr i brendshëm që binte lehtë në sy. Atë mbrëmje pranvere, mbi pantallonat e llangosura me baltën e fushave, kishte veshur një bluzë të kuqe leshi, punuar me gërsheta shiritash, që reflektonte ngjyrën e saj në fytyrën po aq



të përflakur. Qerpikët e dendur e të zinj krijonin një kontrast të mrekullueshëm me këtë fytyrë.

— Në mbledhje!, — u përgjigj, pasi kishte heshur një çast. — Mamaja brenda është?

— Ka shkuar nga dajot e tu, — ia ktheu plaka. — Në këtë shtëpi ditët e fundit të gjithë ikin.

Arta i buzëqeshi dhe e puthi përsëri. Pastaj u fut brenda. Përshkoi korridorin dhe hapi ngadalë derën e dhomës ku flinte gjyshja. Në njërin nga cepat e dhomës, gjysmë metër poshtë tavanit, varej ikona e shën Dhimitrit. Përfund saj, kandili me vaj lëshonte një dritë të zbetë që i jepte shenjtit një ngjyrë të verdhë. Ikona, që në fëmijëri i kishte ngjallur Artës një druajtje të pakuptueshme, tani nuk i bënte më asnjë përshtypje. Me kalimin e viteve e humbi misterin që e rrethonte dhe u katandis në një copë letër të vizatuar. Sidomos pasi në fshat erdhën dritat elektrike, ikona e humbi fare interesin. Arta mbante mend se si, që ditën e parë kur vendosën llampën elektrike në dhomën e gjyshes, drita e fortë ia kishte hequr shën Dhimitrit velin e misteriozitetit.

Artës iu kujtuan këto dhe ndezi dritën. Në dhomë të gjitha hijet u shpërndanë. Kandili as që binte më në sy. Mbi aureolën ngjyrë ari të shenjtit vajza vuri re një njollë të errët. Kur u afrua pranë, e kuptoi se ikona kishte nisur të ciflosej. Edhe në vende të tjera boja ishte plasaritur.

Fiku dritën dhe doli. A duhej të bisedonte më parë me babanë, apo t'ia thoshte gjyshes? Arta qëndroi një çast në ballkon. Gjyshja ishte ulur përsëri në krye të shkallëve me kokën e të nipit në pëqi. Vajzës i vërshuan nëpër mend gjithë ato mbledhje që nisën

menjëherë pas Fjalimit të 6 Shkurtit të shokut Enver. . .

Këto po mendonte ajo, mbështetur pas parmakëve të ballkonit. Gjyshja qëndronte disa metra më tej, duke menduar për fshatin e vjetër që po rrallohej e bënte këmbë tutje, nën ullishta. . . Arta ndjeu druajtje për herë të parë nga ajo plakë që e donte aq shumë. Pra, ishte rritur dhe po i mbante të fshehta.

#### 4.

Pak vjet më parë, shtëpia e shkatërruar disa njerëzve u ngjallte në shpirt një lloj ftohtësie të trishtuar. Ata që kalonin nga ajo rrugicë, mundoheshin të mos kthenin kokën nga dera e saj. Ecnin kokulur, derisa kalonin gjithë gjatësinë e avllisë.

Pëshpëritej se fajin për këtë e kishte Luiza e Llazit. . .

Një ditë prej ditësh, dhjetë vjet më parë, nëpër fshat qarkulloi një oshëtimë fjalësh rrëqethëse. Në shtëpinë e Andreas, tregtarit të dikurshëm, kishte dalë një lubi. Këtë e tha e para Luiza. Shtëpia e saj dykatëshe, me çati të lartë, me mure të trasha, të pasuvatuara, si të një kalaje, ishte përballë shtëpisë së Andreas.

Kjo kishte ndodhur një mëngjes të largët e të zyrtë dimri. Luiza tregonte se kishte parë të ndalte këmbët para avllisë së bardhë, paksa në të majtë të portës së madhe, një kalë i madh, i zi, me këmbë aq të gjata, sa koka i arrinte lirisht deri përmbi degët e zhveshura të hardhisë që mbulonte oborrin. Luiza tregonte më pas se, kur kali ngriti dy këmbët e para dhe me lehtësi kapërceu murin e avllisë, theu

ca degë hardhie dhe ra në oborr. Zinxhiri që qëndronte mbi të, në ajër, paksa mbi kreshtën e thinjur të qafës, një zinxhir i ri, i trashë, tingëlloi rrëqethshëm. Pas kësaj të gjitha dyert e shtëpisë filluan të hapeshin dhe të mbylleshin me rrëmbim, sikur t'i shtynte një dorë e padukshme...

Ato kohë plaku Andrea, për herë të parë pas shumë vitesh, qëndroi disa ditë i mbyllur në shtëpi. Atëherë i rronte e shoqja, një grua e gjatë, e rreptë, si një burrë patriarkal.

Kjo e gjitha u zvarit në fillim si legjendë, por te disa njerëz, për ca kohë, zuri rrënjë.

Plaku Andrea e mbylli dyqanin, megjithatë, thoshin se vazhdonte akoma të bënte tregti...

Ishte vjeshtë e dytë. Në një qoshe të oborrit të madh, ngjitur me shtëpinë, ngrihej një plevicë e nxirë. Aty nxirrte rakinë thujse gjysma e fshatit. Rakia derdhej nga një sylinë e hollë metalike, përfund vozës me ujë, gjithë ditën, gjithë natën, deri në fund të dhjetorit. Andrea u merrte fshatarëve shpërblim në raki. Pastaj atë e shiste në qytet. Kjo ishte një tregti e leverdisshme për të, që nuk binte në sy. Fshatarët e nxirrnin rakinë me radhë. Në plevicë zjarrri nuk shuhej kurrë. Kishte pasur raste kur ndonjëri e mbaronte kazanin e fundit në mes të natës. Duhej patjetër të lajmërohej shoku i radhës. Kjo e gjitha bëhej pa zhurmë, me muhabete nën zë, në zagushinë e plevicës, me sy të fryrë nga gjumi e të lodhur nga tymi. Kur ngrihej në mëngjes, plaku Andrea gjente atje myshterinj të rinj. Ulej aty mbi një trung ulliri të trashë, provonte ballin e kazanin dhe bisedonte me të zotin e bërsive për kohën, për ullinjtë, për peshkun.

Në një nga këto net të errëta nusja e Lekos dha papritmas një alarm tjetër. Ajo tha se e kishte parë lubinë të dilte nga voza e madhe me ujë të ngrohtë. I paemri iu shfaq i veshur me të zeza, me mjekër të gjatë, rrethuar nga shtëllungat e dendura të avullit. Ai ishte ngritur një çast hopa, kishte mbetur pezull në ajër, diç murmuriti dhe. . . . humbi në errësirën që kishte pushtuar çatinë e plevicës. Gruaja e re ishte ngritur e llahtaritur e kishte shkuar në shtëpi, duke e lënë rakinë të derdhej përtokë. Muret e plevicës përflakeshin nga gjuhët e kuqe të zjarrurit që digjej nën kazan. Nusja e Lekos ishte duke dremitur, kur iu shfaq i paemri.

Pas kësaj fshati u bë kooperativë. Kazani në plevicë nuk nxehej më. Disa muaj më vonë vdiq e shoqja e plakut Andrea.

Në shtëpinë e shkatërruar ra nata. Një natë e bukur, e ngrohtë, me pak yje e hënën që ndriçonte aty në një cep të qiellit. Ai fillim pranvere i kishte netët shumë të ngjashme. Plaku Andrea ra të flinte. Po dremiste, kur ndjeu zërat e natës së parë. Hodhi mbi supe pallton e vjetër dhe u zvarit përsëri deri afër derës. Do të ishte i kënaqur sikur të kishte mundësi të dilte në korridor, po derën e kishte të mbyllur dhe, po ta hapte, ata do të dëgjonin zhurmën. . .

— Sot ka hënë të bukur!, — tha djali.

Hëna ndriçonte përgjysmë dhomën e shkatërruar. Aty-këtu rrezet e saj të zbeta depërtonin nën tjegullat e rralla dhe njollojnë petavrat e zeza të çatisë. Dhoma kishte marrë një pamje të verdhë, si errësira e nënujshme. Çdo send mbi dysheme lëshonte rreth vetes një hije të ftohtë, dhe konturi i murit

të shembur shënonte kufirin midis errësirës dhe dritës së verdhë.

Në anën tjetër gjithçka ishte zhytur në errësirë.

— Arta, u lodhe sot?

— Shumë, Tori... Beson? Na u këputën krahët nga kuckat që shkulëm. Pastaj futeshim me shat.

— Besoj se bisedove haptazi me Kiçon, apo jo?

— Ëhë... Kishe të drejtë. U fyeva kot... Po ai problemi që ngriti... Nasi për këtu... Është e vështirë, shumë e vështirë. Hajde të gjykosh tani për punë boshe... Fantazmat e kësaj shtëpie...

— ....

— Patjetër. Lena diç më tha. Babai mendon se këtu fshihet një gjë e madhe.

— ... natën... mbledhjes.

— Britma?

— Gjyshja duhet ta dinte më mirë...

— Mos e ngatërrojmë... kot... sepse...

— E lëmë kur të kthehemi nga hekurudha?

— Babai mund të mendojë keq, po të shkojmë së bashku. Ti e di...

— Kur do të marrë fund kjo punë?, — shfryu djali. — Ti gjithmonë e pasigurtë. Nuk më the një herë: po, do ta bëjmë!

— Kurse ti nevríkosesh kot. Ç'faj kam unë në këtë mes?

— Po sikur t'u them shokëve diçka?

— Çfarë?

— Që ti të vish në hekurudhë turnin tjetër. Të mos vemi bashkë. Ë, xhan! Ndoshta kështu qetësohen edhe ata të shtëpisë...

— E thua me të vërtetë?

— Jo, po. . . .

— . . .shët, mos qesh. . . Të lutem!

Plaku pështyu në errësirë. As nuk po i kuptonte fjalët e tyre. . . «Fantazmat», — tha ajo. Ku e ka fjalën, vallë? Cilin përgjojnë këtu? Puthen, apo i kanë dërguar të më përgjojnë?» Ndjeu të ftohtë. Afroi më shumë pas vetes pallton që po i rrëshqiste nga krahet. . . «Hekurudhë». . . ?

Andrea mbante mend se tridhjetë vjet më parë kishte pasur një hekurudhë që lidhte fshatin me qytetin. Ajo kalonte midis ullishtave, shinat shtrihe-shin mbi një trase zhavorri nja dyzet centimetra mbi tokë dhe vagonat tërhiqeshin nga dy kuaaj, që në mes të rrugës ndërroreshin me të tjerë. Ky tram, siç e quanin, ishte mjeti më modern i transportit atëherë dhe Andrea, që bënte pjesë në parinë e fshatit, kishte të drejtë të ulej në vagonin e parë, i cili kishte tri karrige të thurura me thupra shelgu të bardhë. Në të shumtat e rasteve, Andrea ndalonte në stacionin e fundit, që ishte në fund të rrugës që ngrihej mbi një tokë kënetore dhe mbaronte në skelën e vjetër të qytetit.

Andrea kishte pasur gjithmonë punë me skelën.

Aty ankoroheshin vaporët, që u përkisnin skelave të përtejdetit.

Këto të gjitha i shkuan nëpër mend vetëtimthi. Tani dëgjonte të flitej përsëri për një hekurudhë. Do t'i afrohej qytetit, vallë? Kishte kohë që besonte se, atë që thoshte kjo qeveri, e bënte. Ishte lodhur duke pritur ndryshime, që do t'i sillnin, së paku, dyqanin e tij.

Është e çuditshme por, sa herë sillte ndër mend dyqanin, i dilte parasysh selvia. Megjithëse tani e

prerë, ai e përfytyronte të gjatë e të drejtë, ngritur mbi kokën e... varrit të tij. A s'mund të ishte një lloj përmendoreje?

Fryeu era. Tjegullat lëvizën. Dhomën e pushtoi një ftohësi e befasishme. Ai u mbështoll më mirë me pallto. Për pak desh të kollitej. Kësaj iu shmang me shumë vështirësi. Ata që bisedonin, do ta kuptonin se i përgjonte dhe nuk do të vinin më aty. Kjo do të radhitej si një nga humbjet e mëdha. Vuri veshin të dëgjonte më mirë.

— Arta, dëgjomë! Mos më detyro të ndahemi në këtë aksion, që unë e kam pritur me aq padurim!

— Ti bëhesh fare fëmijë! Ç'të bëj unë? Mamaja edhe mbrëmë më porositi: «I thua atij që mos të të ndjekë pas tani në hekurudhë. Babai do të bëjë gjëmën, o korbë!». Kush mund ta dijë më mirë se ajo atë që mendon babai?

— Po unë nuk të ndjek pas. Ne shkojmë bashkë me të gjithë shokët.

— ...

Për disa minuta rresh nuk foli më njeri.

Plaku Andrea, sado që dëshironte të mos mbaronte kurrë ky dialog, prapëseprapë do ta përshëndeste babanë e kësaj bishtdredhure për qëndrimin e tij. «Pastaj, ç'donte ajo në hekurudhë, xhanëm? Hekurudhat i bën shteti. Po për hekurudhë nuk i thonë asgjë?», — mendonte plaku, aty, në një rën qoshe të derës, shtrirë përgjysmë, me gjunjë e bërryla të mbështetur në dyshtemenë e pafshirë.

— E ke të kotë, — tha prapë vajza. — Ka disa gjëra që janë të pamundura. Ata janë prindër dhe duhen respektuar.

— Ti duhet t'i respektosh në këshillat e mira, —

u përgjigj ai. — Ata e dinë prej kohësh që ne duhemi. Përse të na pengojnë?

— Ti e di arsyen!

— Ajo nuk është arsye!

— Për ata po!

— Një logjikë e tillë mua s'më nevojitet.

— Kaq arrin logjika e tyre!, — tha vajza, e fyer.

— Mendo si të duash, — iu përgjigj ai. — Edhe ti... asgjë nuk po bën. Në qoftë se premtove... Fjalimi i 6 Shkurtit ka shkundur gjithë Shqipërinë e babai yt vazhdon të kundërshtojë dashurinë e sinqertë të vajzës së tij.

— Të mos kisha bërë asgjë, nuk do të isha sot këtu me ty!, — ngriti zërin befaz vajza.

Ra heshtje.

Atë natë plaku Andrea nuk dëgjoi më ndonjë gjë interesante. Ato dy-tri fraza të fundit të djalit atij sikur ia ngatërroi era, sikur përziheshin me zhurmën e tjegullave. Ai priti shumë kohë aty prapa derës. Derisa i erdhi gjumi. Nuk ndjeu se si hëna kapërceu selvinë e kishës dhe lëshoi një rreze të vetmuar ngjyrë ari.

Plaku nuk e pa dritën.

Në ëndërr ai po shikonte perëndimin e diellit në breg të detit.

## 5.

Të nesërmen mbrëma, diellin që perëndonte ai po e shikonte i ulur aty, mbi gurin e lartë, që qëndronte prej shumë vitesh para portës së madhe të oborrit. Guri ishte i madh, me një vrëmë të rrumbullakët që i kalonte mes për mes. Në të vërtetë, gurë



të tillë në ato anë, nuk gjeje gjëkundi. Forma e tij, gjithë zaje të rrumbullakëta, të ngjitura me njëri-tjetrin, të bënte të mendoje se atë ose e kishin sjellë nga larg, ose ishte krijuar nga ndonjë dorë ustai. Ky gur ishte rrokullisur nga makina e vajit (siç quhej shumë vjet më parë punishtja ku shtypeshin ullinjët) dhe e kishin prurë këtu, në prag të portës së madhe të shtëpisë së të zot. Mbeturinat e kësaj punishteje dukeshin edhe tani, aty në njërin krah të kishës. Skeletet e saj të hekurta ishin bërë vend lodrash për fëmijët e fshatit. Plaku Andrea as që kishte mundur ta shiste dot. Ajo iu sekuestrua aty nga 47-ta, dhe godina e punishtës u prish dhjetë vjet më vonë. Gurët u hodhën në themelet e shkollës së re.

Herë pas here plaku i ulte sytë përdhe dhe ndiente se toka mbushej me njolla të kaltra, të kuqe, të zeza, që lëviznin në të katër anët e hijeve. Atëherë ai mbyllte sytë dhe mendohej të mos kujtonte diellin.

Prej aty ku ishte ulur, deti nuk dukej. Po plaku e dinte mirë se diellin do ta mbulonin valët. Ai habitej se sa shumë zmadhohej dielli në mbrëmje. Për këto gjëra mendoj aq shumë, sa u lodh. Papritmas ndjeu një hije të ftohtë t'i rrinte përballë. Ngri-ti kokën të vështronte.

Para tij qëndronte djali i vogël.

Plaku nuk desh i t'i buzëqeshte, por ja që kjo gjë i shpëtoi. I vogli hapi pakëz gojën. Iu dukën një palë dhëmbë të bardhë, pakëz të rrallë, si rruaza. Plaku ia pati zili. Atij për vete i kishin mbetur vetëm dy këllëfë në nofullën e sipërme. Me ta kafshonte jetën. Fëmija ngurroi një çast. Pastaj, siç duket, mori zemër nga buzëqeshja e plakut dhe foli.

— Xha Andrea!

Plaku lëvizi nga vendi. Ai deshi të pështynte, por e përmbajti veten. Sytë e djalit i pëlqyen shumë, ashtu si dy ditë më parë. I erdhi inat me veten që nuk e kishte në xhep atë të shkretë karamele.

— Hë, ç'më zgërdhihesh?

— Mirëmbërëma!, — tha djali.

Plaku tundi në ajër bastunin që kishte lënë aty mënjanë. Po nuk e tundi me zemërim.

Fëmija mendoj se atij i ra inati.

— Sheqerkën do të ta sjell nesër!, — i tha. Plaku besoi se fëmija nuk do të bindej aq lehtë.

— Falemnderit!, — iu përgjigj djali. — Ti je plak dhe nuk dua të harxhohesh. Mua më blen babi karamele!

— Të miat nuk të pëlqejnë, demek!

Djali qeshi. I qeshën edhe sytë. Në faqet ngjyrë trëndafili iu krijuan dy gropëza. Andrea donte ta provonte që atë çast. Për shembull, sikur t'i thoshte të vente në klub e të blente një paketë cigare, a do t'ia sillte vallë? Apo do t'ia harxhonte lekët për sheqerka? Ai e vështroi edhe një herë gjatë. «Ky duhet të jetë i zgjuar, — vazhdoi të mendonte. — Mua më duhet për shumë punë. Të paktën, të më sjellë një shtambë me ujë të ftohtë...».

— Më jep pak shkopin!, — iu lut djali, duke i ndërprerë mendimet.

— Cilin, shkopin? — pyeti plaku me kërcënim.

— Po, — tha djali.

— Që të ma marrësh?, — vërejti plaku.

— Jo, dua të të them... dua të të tregoj diçka...

Djali befas zgjati duart drejt shkopit. Plaku lëvizi nga vendi. E vërejti një hop, pastaj ia dha. Ishte

një shkop i drejtë thane, me një nyjë të madhe afër fundit, i lëmuar, që tani koha i kishte dhënë një ngjyrë të verdhë si të qiririt.

Djali e drejtoi shkopin nga qielli, e mbështeti fort pas supit, ngjeshi gishtin dëftues pas nyjes dhe i tha plakut Andrea:

- Unë di të qëlloj me pushkë.
- E pastaj?, — pyeti plaku, duke u dredhur i tëri.
- Do vras armiqtë!, — iu përgjigj djali.
- Po unë nuk jam armik! — klithi lehtë plaku.
- Ty nuk të vrasim!, — i premtoi djali.
- Sepse nuk jam armik!, — përsëriti me forcë plaku.

Djali qeshi.

Plaku, për të ndërruar bisedë, i tha t'i blente një paketë. Djali iku me nxitim. Vetëm atëherë ai sikur u lehtësua. Ia kishte ënda që fëmija të vonohej sa më shumë, bile do të bënte mirë të mos kthehej fare. Në djall ata lekë të mallkuar! Kështu do të kishte rast të mos e afronte më. Bastunin nuk do ta nxirrte më kurrë në sytë e tij.

Po errej. Djali erdhi, i lëshoi paketën në pëqi dhe iku.

Plaku dridhej. Ai dukej tani si kërcu i zi në prag të derës. U ngrit të futej brenda. Hëna nuk kishte dalë akoma. Në qiellin blu po mbinin yjet. Ai ndjeu të ftohtë. Qëndroi edhe një çast në prag të portës. Nuk kishte asnjë dëshirë të futej brenda. Vetmia atë natë e trembte. Megjithatë bëri si bëri dhe mbylli pas vetes portën e madhe, po nuk u fut në dhomë. Eci disa minuta nëpër oborr dhe sytë i vajtën te muri i she-mbur. Shtyllat prej selvie, që mbështeteshin pas trarëve, iu dukën të forta. Po sikur ta shiste atë dhomë?

Ndofta do të përfitonte diçka. Le ta kishte një mur të shembur! I zoti i ri le ta rregullonte. E çmoi dhomën e rrëzuar tridhjetë mijë të vjetra. E pse jo? Muret ishin të forta, të trasha, të lidhura me llaç të vërtetë gëlqereje. Tjegullat gjithashtu s'ishin shumë të dëmtuara. Trarët vërtet ishin kalbur ca, por, po t'i çaje, mund t'i përdorje. . .

Dhe nuk do të luante nga çmimi i tij. Fundja, tridhjetë mijë nuk ishin shumë, de! Bile ai do t'ia besonte dhomën vetëm një njeriu nga derë e mirë. Nuk mund të lejonte që të futej atje kushdo. Të paktën, ajo familje ta ndihmonte me ndonjë farë mënyre!

Ishte errur plotësisht dhe atij iu kujtua se mund të vinte djali e vajza. Një çast i erdhi keq që, duke shitur dhomën, do të hiqte dorë nga një lloj zbavitjeje e bukur: Ngurroi. Pastaj pështyu.

Kur ktheu sytë nga porta e oborrit, iu kujtua fëmija. U drodh. Vendosi që të nesërmen të bënte një tjetër muhabet me të, ku të mos flitej më për pushkë. Për shembull, mund ta pyeste se deri ku do të vinte hekurudha dhe se çfarë ishte Fjalimi i 6 shkurtit. Megjithëse për këtë të fundit ai nuk para besonte te djali. 6 shkurti mund të ishte ndonjë ditë feste që fëmija mund të mos e kishte mësuar akoma në shkollë.

Shtyu derën e u fut brenda. Atje ishte aq errët, sa ai, si të kishte humbur dritën e syve, eci duke prekur lehtë muret. Në dhomë ndezi kandilin. Drita e dobët mezi shpoi errësirën. Tavani mbeti i pandriçuar, sepse ai e vuri kandilin në dritaren e thellë.

Hëngri atë që i kishte mbetur nga dreka, pastaj u shtri. E ndiente veten shumë të lodhur, sikur kishte çarë dru gjithë ditën. Fëmija e dërrmoi kur i drej-

toi bastunin. Ai u tremb shumë, megjithëse vdekjen nuk e përfytyronte kështu.

## 6.

Fëmija shkoi në shtëpi, por, pa arritur akoma në krye të shkallëve, gjyshja Stamato seç i pëshpëriti në vesh, dhe ai u kthye përsëri. Shkallët i zbriti dy e nga dy dhe rrugicat i përshkoi me vrap. Në klub u hodhi një vështrim të shpejtë tavolinave, po të atin nuk e pa menjëherë.

Atë mbrëmje, më shumë se çdo mbëmje tjetër, klubi i fshatit ishte mbushur plot. Pranë banakut prisnin dhjetëra njerëz, që bisedonin me zë të lartë, shumë të tjerë kishin zënë vend në të thelluarat e dritareve, ose mbi vozat e vogla të birrës, rradhitur në një qoshe, pa bërë fjalë për ata që ishin ulur. Fletërrufetë e mëdha ishin shfaqur atë ditë që në mëngjes dhe kishin gjallëruar jetën e atij fshati. Disa prej tyre vareshin në anët e brendshme të xhamave të klubit.

Njëra nga fletërrufetë ishte varur në krahun e djathtë të banakut dhe atje mizëria e njerëzve ishte më e madhe. Në të ishte shkruar me shkronja të mëdha, të zeza emri i priftit dhe fshatarëve u dukej sikur ishin ngushtuar vitet dhe tashmë bëhej fjalë jo për një papa Andon, por për një Andon Sano të vërtetë, siç ishte para njëzet e pesë vjetësh. Këtij njeriu, që nuk i përmendej më gjëkund ofiqi kishtar, i llogariteshin një për një të gjitha të ardhurat e fituara me mashtrim.

Bisedat nisnin të qeta, mbeteshin diku, derisa gjendeshin shpjegimet e duhura, pastaj merrnin atë

vrull bubullues, që e sjellin vetëm ngjarjet e mëdha. Ai klub atë mbrëmje ishte shndërruar papritur në një sallë kuvendi. . .

Fëmija kishte përshtypjen se aty kishte plasur sherr dhe priste nga çasti në çast që njërezit të kaca-fyteshin. Ai qëndroi gjatë në këmbë aty pranë derës, por nuk ndodhi asgjë e tillë. Së fundi, ai pa të atin me dy fshatarë të tjerë dhe iu desh të çante turmën për të mbërritur deri te tavolina e tij.

— Babi, më tha gjyshja se në shtëpi ka ardhur xha Vangjeli, — i pëshpëriti ai Petros në rrëzë të veshit.

Petroja çokiti gotën me të tjerët, e ktheu me fund atë që i kishte mbetur dhe u largua duke mbajtur djalin për dore. Te dera e klubit dikush e ndaloi.

— Po manastiri?, — pyeti burri.

— Është dorë e rinisë!, — ia ktheu Petroja. — Këtu nuk ka të bëjë fare këshilli i fshatit.

Tjetri thithi fort bishtin e cigares dhe i liroi rrugën sekretarit të këshillit.

Në shtëpi gjyshje Stamatoja kishte vënë zhezvenë e kafesë në zjarr, ndërsa miku rrinte në minderin aty pranë. Petroja e ndjeu se Arta nuk ishte brenda dhe i erdhi mirë që vajza, sido që të vente puna, nuk do të mësonte gjë.

Vangjeli u ngrit në këmbë, po Petroja i kapi dorën dhe e detyroi të ulej përsëri. Biseda nisi me përtesë dhe plaka, që mbante sytë mbërthyer mbi filxhanin e kafesë, e ndiente se i biri e kishte të vështirë t'ia fillonte.

— Është ajo puna e fëmijëve. . . , — nisi papritmas Vangjeli. — Tani kështu ndodh gjithmonë, xhanëm,

dhe unë mendoj që ne nuk duhet të bëjmë ndryshe nga bota.

Petroja ndezi cigaren dhe fytyra iu skuq nga flaka e shkrepëses.

— Është e vogël dreqi!, — shfryu ai, jo pa nervozizëm.

Plaka Stamato ktheu kokën dhe pa të birin. Në vështrimin e saj kishte një dritë habie. «E vogël? — dukej sikur thoshin ata sy. — Po unë isha më e vogël kur u martova».

— Këtë punë duhej ta kishte bërë Viktori, — tha Vangjeli pa ngritur kokën. — Kot më solli deri këtu. Pse të prishim edhe miqësinë, xhanëm?

— Aspak!, — ia ktheu plaka. — Do ta forcojmë. Ja, pini tani këtë kafe. E kam parë atë çapaçul!, — shtoi ajo. — Mos është më e gjatë Arta jonë? Se, ndryshe, nuk ka lezet. . . .

Petroja qeshi për herë të parë. Jo, Viktori është më i gjatë. E kishte parë të luante basketboll me skuadrën e fshatit.

— Mbase e ke parë kur ishte i vogël — i tha Petroja me zë të lartë s'ëmës. — Dyert tona janë të ulëta për të hyrë ai. Duhet të thyhet në mes.

Buzëqeshi dhe Vangjeli.

— Epo, ç'ta zgjasim?, — pyeti plaka.

— Është punë e tyre, nënë!, — iu përgjigj Petroja duke psherëtirë.

— Të ish e tyre, nuk do kishe rrudhur buzët ti!, — ia përplasi befas plaka në sy të mikut.

Petroja u zu ngushtë dhe e vështroi të ëmën vëngër.

— Nuk më tha një herë!, — tha pa zëmërim. —

Dhe unë e marr vesh nga të tjerët dashurinë e sime bije!

— Epo, i vjen turp, de!, — ia ktheu plaka. — Si të të thotë: «dua burrë»? Mua çoç më ka thënë. Edhe mbrëmë. Erdhi e m'u fut në shtrat si ndonjë mace dhe më pyeti në e njihja atë çapaçulin tënd, Vangjo!, — guisi plaka.

Atmosfera ndryshoi menjëherë dhe Vangjeli vendosi të ndërronte muhabetin.

— Ç'bëhet jashtë, Petro?

— Na ngriti rinia peshë, o Vangjel! Edhe mirë bëjnë, xhanëm, — tundi kokën ai. — Ja, unë për vete, mund të kem njëzet vjet pa kunguar. E, në kam shkuar ndonjëherë pashkëve në kishë, këtë nuk e kam bërë për t'iu falur Krishtit, por për të bërë sehir.

— Ç'thua kështu?, — ia preu plaka. — Pse, ç'tuhet?

— Po ja, flitet për kishat, — iu përgjigj Vangjeli, — ç'i duam?!

— Ç'i duam... kishat?, — klithi lehtë plaka. — Shko tutje!

Petroja qeshi.

— E, moj e uruar, ç'i duam?, — nguli këmbë Petroja.

— Zot, sill mendtë e kokës!, — thirri së dyti plaka. — Aha, të gjitha të mira i bëtë, por, po prishët kishat, zëre se nuk keni bërë gjë. Lërnani të vdesim ne njëherë, pastaj bëni si të doni.

— Jo!, — iu përgjigj Petroja. — Rinia do t'i prishë pa vdekur ju. Nuk duan të ikni nga kjo botë të gënjyer. Ja, kështu, të gënjyer!

— Po ç'ju bëjnë kishat, xhanëm?



Vangjeli i nguli sytë plakës dhe i tregoi asaj shiritat e kuq të jelekut dhe e pyeti:

— A thua se ishin djaj ata që dolën nga kisha?

Plaka u drodh. Pse ia kujtonin tani atë ngjarje të madhe? Stepi një çast, i hodhi sytë Petros, pastaj vështroi fotografinë e dëshmorit, varur në mur...

— Po ai prift u pushkatua!, — tha me zë të lartë. — Ky mendim i erdhi papritur dhe ndjeu që u qetësua menjëherë. — Ky tjetri...

— Nuk janë fajtorë vetëm priftërinjtë, — ia ktheu Vangjeli.

— Po ata janë shërbëtorë të zotit, — klithi plaka.

— Edhe ai që u pushkatua, kështu e quante veten. Të kujtohet?

— Jo, xhanëm! Ncë!, — përplasi buzët plaka.

Erdhi nëna e Artës. Ajo hyri në dhomë pakëz me vrull dhe stepi një çast, kur pa atë mysafir brenda. Megjithatë e mori veten shpejt, e përshëndeti dhe doli përsëri nga dhoma. Priti në korridor të dëgjonte gjë nga bisedat e tyre, por më shpesh ndihej zëri i gjyshes Stamato.

Pas pak burrat dolën. Në fund të shkallëve ata qëndruan një çast dhe vështruan murin e shembur të avllisë së plakut Andrea. Që andej dukej edhe dhoma e shkatërruar, me trarë të mbështetur pas shtyllave prej selvie.

— Ra edhe kjo!, — tha Vangjeli, duke treguar shtëpinë e ish-tregtarit. — Dukej sikur do të rronte gjithë jetën. Bëri të liga sa deshi, dhe ja... tani...

— Perëndoi koha e tij, — iu përgjigj Petroja.

— Bleje këtë shtëpi, — e këshilloi miku. — Ndoshta nuk e ka të gjatë. Edhe ti zgjerohesh një çikë.

Shtëpitë e ke të reja, por pa një copë kopsht përpara... Të ka marrë frymën gjithë jetën ky mur.

— Jo, — kundërshtoi Petroja. — Le të shemben! Kështu e nisën, kështu le ta bitisin. Me kohë e ndreqim dhe bëjmë një kopsht fëmijësh.

— Epo?, — tha Vangjeli.

— S'kam ç'të të them, — iu përgjigj Petroja. — Do të bisedoj më shtruar me vajzën. Kështu bëj edhe ti. Dhe do të llafosemi përsëri.

— Mirupafshim!

## 7.

— Ka një mendim, shokë!, — thoshte ai që rrinte në krah të sekretarit të rinisë, në bangën e presidiumit. — Aksioni tjetër, pasi të vijmë nga hekurudha, le të jetë ndërtimi i serrave të ngrohta në ranishte.

— Po uji?, — ia priti dikush nga salla.

Pasoi një heshtje. Befas u ngrit Viktori, dhe trupi i tij i gjatë përshkoi korridorin midis bangave dhe u drejtua për në dërrasën e zezë. Mbledhjet e rinisë deri në atë kohë bëheshin në shkollë. Të nesërmen nxënësit e klasës së gjashtë do të gjenin një skicë të vizatuar dosido, ku tregohej deti, ranishtja dhe fshati. Viktori e mbushi me ikse të vogla zonën ku do të ngriheshin serrat dhe po aty shënoi gjashtë puse.

— Kjo është e ditur që ka ujë, — tha ai. — Ku pi gjithë fshati? A nuk është pusi në mes të rërës? Po ju, nuk mbani mend që, kur ishim të vegjël, hapnim puse tridhjetë metra larg nga bregu i detit dhe atje buronte uji i ëmbël? Cili nga ju nuk ka pirë nga ky ujë? Unë e kam bërë këtë propozim. Bisedova

edhe me agronomin. Ja, këtu bëhet një serrë e mrekullueshme, që do të pjekë domatet në prill.

— Pse, bëhet domatja në rërë?, — pyeti Arta.

— Po të ketë ujë, bëhet, — ia ktheu Viktori. — Xha Jani ka pasur dikur një vresht të tërë në mes të rërës. E mbani mend? Apo s'bëheshin pjeshkët!

— Përse u zhduk ai vresht?

— I ra filloksera dy vjet rresht!, — u përgjigj, në vend të Viktorit, Nasi, sekretari i rinisë. — Unë e mbaj mend mirë.

— Nuk mjafton biseda me agronomin!, — tha përsëri Arta. — Të ndërtosh një serrë nuk është e lehtë. Do shpenzime, dhe kjo punë do parë me kryesinë e kooperativës.

— Kjo është inisiativë!, — tha një djalë i shkurtër, që rrinte në bangën e fundit. A bindemi ne se bëhet? Po, do ta bindim edhe kryesinë.

Ndërsa te dera e klasës, jashtë, bëhej kjo bisedë me zë të ulët:

— Ja, të thashë unë? Janë tallur me ty! As që bisedon njeri për punën tënde!

— Po mua më thirri sot brigadierja dhe më tha të vija këtu për atë punën e lubisë që kam parë dikur në shtëpinë e plakut Andrea, — i tha nusja Lekos. — Pse të më gënjente?

— Hajde, moj, të ikim, se janë tallur me ty, po të them! Oj, tjetra! Nuk dëgjon, xhanëm? Ata flasin për serrat, ti dashke t'u flasësh për lubira.

— Jo, unë do të hyj njëherë. Ç'ke ti, fundja?

— Si, moj, ç'kam unë! Je në vete ti? E ç'do të thuash, edhe në hyfsh? Mban mend gjë?

— Mbaj, si nuk mbaj!

— Mblidh, moj, mendtë e kokës!, — çirrej me zë

të ulët Lekoja. — Është tallur brigadierja, të them. Kupton?

— Po unë e kam parë!, — nguli këmbë ajo.

— Më plase!

Gruaja u bë gati të trokiste, por i shoqi i mbajti dorën. Pastaj e mënjanoi dhe shtyu vetë derën. Që në prag të saj pyeti:

— E keni kërkuar gjë gruan time në mbledhje?

Në klasë u bë heshtje, pastaj Arta iu përgjigj:

— Të kishte ardhur nusja, Leko, jo ti!

— Këtu jam!, — iu përgjigj pas kurrizit të të shoqit gruaja e re.

— Eja, nuse, eja!, — thirri përsëri Arta.

Burrë e grua u ulën në njërin nga bangat.

— Po si ndodhi?, — pyeti Arta. — E pe me sytë e tu?

Lekoja u zverdh në fytyrë. Me gjithë sinqeritetin e pyetjes, atij iu duk se gruan e tij po e vinin në lojë.

— Ky është budallallëk, — thirri.

— Ngadalë!, — i tërhoqi vërejtjen Viktori. — Edhe ne e kuptojmë që është kështu. Po duam ta dëgjojmë. Kështu i mbushim mendjen njëherë e mirë edhe ndonjërit, i mbushim mendjen edhe gruas sate. Ç'të keqe ka?

Burri lëvizi në vend dhe mbërtheu me të dyja duart cepat e bangës, sikur donte ta shkallmonte.

— Po ja, — nisi e druajtur nusja e Lekos, — ne nxirrnim kazanin e rakisë të xha Andrea. Unë isha vetëm, fare vetëm. Duhet të ketë qenë afër mesnates.

— Po ti, Leko, ku ndodheshe?, — e ndërpreu dikush gruan.

— Ku di unë!, — tha Lekoja. — Edhe unë aty e gdhiva. Nuk mbaj mend të jem larguar... Pastaj, kanë kaluar dhjetë vjet qysh atëherë.

— Ti se nga kishë shkuar, — nisi përsëri gruaja. — Ndoshta në shtëpi, të shikoje djalin. Atëherë e kishim motak dhe vjehrra ishte e sëmurë. Të kujtohet?

Burri shtrëngoi buzët.

— Unë e dija këtë historinë e lubisë dhe, të them të drejtën, kisha shumë frikë atje. Plaka e Andreas erdhi të më shihte aty nga mbrëmja dhe më nuk u duk. Plaku as që hyri në plevicë. Sa iku Lekua, u kujdesa të shtoja zjarrin nën kazan. Voza e madhe donte ujë, por unë, ca nga frika e ca nga gjumi që më rëndonte sytë, nuk dola të nxirrja nga pusi. Duhet të kem menduar që këtë punë do ta bënte Lekua kur të vinte. Atëherë... atëherë më doli ai.

— Nga doli?, — pyeti një vajzë që rrinte në fund të klasës. Qetësia kishte pushtuar sallën. Viktori diçka shkarraviste në një copë letër. Arta i kishte ngulur gruas sytë e saj të mëdhenj.

— Nga voza!, — belbëzoi ajo, duke parë rreth e rrotull.

— Si ishte?

— Si prift!

Shpërthyen të qeshura.

— Ç'të tha?

— Se ç'më tha, nuk më kujtohet... tani...

— Ku shkoi?

— U zhduk në çast!

— Pse iku?

— Se bërtita!

— Mos flije në atë kohë kur doli ai?

— Dremisja...

— Mjaft!, — bërtiti Lekoja. — me sa kishte në kokë. — Tuhafe!

— Pse?, — pyeti guaja, e trembur.

— Sepse flije, ja sepse!, — ia ktheu i shoqi.

— Po unë u zgjova dhe erdha me vrap në shtëpi.

Të kujtohet?

— Më kujtohet... se rakia ishte derdhur e gjitha në shesh. E kupton tani se nuk ke parë asgjë? Nga humbi kjo lubi që nuk ka dalë më dhjetë vjet me radhë, që kurse u bëmë kooperativë dhe nuk nxjerrim më raki në plevicën e Andreas? Ku vajti?

— Ku di unë!, — iu përgjigj gruaja. — Por mos bërtit. Këtu jemi me rininë. Apo do një fletërrufe.

Burri buzëqeshi. U pa qartë se i ra inati.

— Hajde të ikim tani, Leta, — i tha asaj me zë të ulët.

— Daleni!, — i mbajti Viktori. — Si ishte veshur, the?

— Ishte si prift!, — tha gruaja. — Pak më ndryshe. Si të them unë e shkreta!

— Dhe doli nga voza? Nuk u përvëlua në ujët e valuar?

— Po kjo flinte, mor shokë!, — thirri Lekoja, i dëshpëruar. Gjurmë i trazuar, ngaqë kishte dëgjuar më parë se atje na dalkësh një lubi... Ëndërr!

Gruaja u çua në këmbë. Ngriti supet dhe vështroi rreth e rrotull.

— Mbase ngaqë kisha frikë!, — tha e pasigurtë. Pastaj burrë e grua dolën.

## 8

Të shtunën postieri erdhi përsëri. Plakun e gjeti në shtëpi. E ndjeu që në oborr se ai ishte brenda. Një

kollë e thatë, e vazhdueshme, dëgjohej deri jashtë në rrugë. Megjithatë ai nuk thirri. Çekun, si gjithnjë, e lëshoi përposh derës. Më pas u pendua dhe trokiti; trokiti disa herë, derisa ai që ishte brenda iu përgjigj.

«Paska filluar të shurdhohet», — mendoi posttjeri.

Në të vërtetë, ai dëgjonte, vetëm se nuk i pëlqente kur i trokisnin në portë.

Ata qëndruan disa minuta përballë njëri-tjetrit. Postieri ishte një burrë i shkurtër, i shëndetshëm, rreth të pesëdhjetave dhe nofullat e fuqishme i spikasin në fytyrë më shumë se gjithçka tjetër. Edhe kur i tha «mirëmëngjes», edhe kur i tregoi çekun, postieri thirri me zë të lartë. Plaku Andrea kjo gjë e zemëroi, por nuk e dha veten. Vetëm se e shikoi mikun ashpër. Atë çast sytë e tij iu dukën si të përbotur. Copa e letrës, akoma në dorën e postierit, e kllikoste. Sidoqoftë, nuk u soll edhe aq ashpër me të. Por as nuk e ftoi të futej në shtëpi. As postierit s'i shkoi ndër mend një ftesë e tillë.

Plaku vuri re se postieri po e shikonte me ngulm dhe e pyeti:

— Ç'më vështron ashtu?

— Kot ... — tha postieri. — Rruga e Livadhit në qytet po shembet. Atje i ke pasur dyqanet ti?

Plaku i mori çekun nga dora dhe i ktheu kurrizin.

Në darkë ai hyri në klubin e fshatit me një shishe të vogël në dorë. Kishte dy ditë që nuk kishte dalë nga shtëpia. Dhe, tani, që përjashta ai ndjeu diçka. Ishte ajo potere që atij i fuste drithmat në zemër. Dhe iu kujtuan: 46-ta, kur i morën vreshtat; 47-ta, kur

i konfiskuan makinën e vajit; 57-ta, kur i mbyllën dyqanin. Tani e dinte se nuk kishin ç'ti merrnin më Vetëm shpirti i kishte mbetur. Mos vallë zhurmonin për këtë?

Në klub zhurma ishte më e madhe. Ai diçka kup-toi, më së fundi, kur dëgjoji të merrej nëpër gojë kisha dhe emri i papa Andonit. Megjithatë kjo iu duk fare e pabesueshme dhe mendoi për ndonjë prapësi të priftit. Turma e madhe që shtyhej në cepin e djathtë të banakut i kishte zënë rrugën, dhe ai mezi mundi të çante përmes saj. Aty e shtynë, e shkelën dhe e lëkundën herë para herë mbrapa. Në banak zgjati shishen.

— Mbushe deri këtu, — i tha shitësit dhe shënoi me gishtin e trashë mesin e shishes.

Në shtëpi u kthye më herët se zakonisht.

Hijet mbështollën dhomën. I zhytur aty, thithte thellë atë ajër të rëndë. Pinte duke përplasur me zhurmë buzët e holla, mbllaçitej dhe fërkonte ngadonjëherë duart me kënaqësi. Këto ishin çaste të rralla kënaqësie. Përbrenda i lëvrinte edhe diçka tjetër. Priste nga çasti në çast të dëgjonte dialogun e çuditshëm të djalit me vajzën. Ky dialog, edhe pse ishte i pakuptueshëm, i nxiste një lloj ankthi të veçantë. Megjithatë ai sikur ishte mësuar tashmë me këta mysafirë të panjohur të brezit të tretë.

Shpesh, mëngjeseve, para portës së tij, ky brez kalonte gjithë zhurmë e gjallëri tek shkante në punë. Ai mendohej të dallonte në atë turmë laramane e të gëzuar djalin dhe vajzën, mirëpo nuk i dalloj kurrë. Të gjithë djemtë i dukeshin si Viktori dhe të gjitha vajzat si Arta. Habitej sa herë i shikonte kështu, kaq të gëzuar e të qeshur. Ai kishte kaluar një rini mi-



dis një pasurie dhe bollëku të madh, por nuk mbante mend të kishte qenë ndonjëherë kaq i gëzuar.

Tek pinte rakinë, këta rreshta të rinjsh i dukeshin sikur po e rrethonin nga të katër anët. Zhurma i kumbonte në vesh si në klub, një orë më parë. Zemërimi i kësaj turme sikur ishte i një lloji të veçantë. Ata kërkonin të hakmerreshin kundër tij, thujse duke qeshur. Veshët i gjëmonin.

U mundua ta largonte këtë zinxhir mendimesh, por ai nuk po i ndahej. Kujtoi se dy-tri herë kishte parë fëmijët e shkollës të ecnin nëpër rrugët e fshatit, duke mbajtur pishtarë në duar, kur kalonin para portës së tij. Thërrisnin. Ai mbyllte menjëherë portën e vjetër të rëndë, ngrinte me mundim hekurin dhe e ngjishte pas saj. Pastaj largohej i hutuar brenda në dhomë, derisa zhurma e fëmijëve platitej. Ai e ndiente se si ajo çante rrugët e ngushta të fshatit, humbiste tej, pas avllisë së Shënedjelës dhe ngrihej përsëri deri në qiell, kur fëmijët i afroreshin shkollës.

Të gjitha këto atë e turbullonin dhe e mundonin aq shumë, sa nga çasti në çast e ndiente veten nën atë copë trung, që kishte mbetur nga selvia e madhe.

Ishte fillimi i pranverës.

Ai bëri kryq sa dëgjoji tingullin e parë të kambanës së kishës. Kambana heshti. Dora i mbeti në gjoks. E mori me mend se ndonjë çamarrok kishte trazuar litarët.

Papritur ra dera. Trokitja ishte e lehtë, ritmike dhe në fillim plaku nuk e dalloi qartë se në cilën derë trokisnin. U ngrit dhe doli në korridor. Për habi të tij, dalloi se trokitjet vinin nga dhoma e shembur.

Qëndroi një çast pa folur. Kush mund të ishte ky budalla, që nuk e dinte derën e shtëpisë së tij?

— Kush është aty?, — tha me zë të prerë.

— Andrea... hape, jam unë.

— Kush ti?, — pyeti plaku me përçmim. — Ajo derë është e gozhduar.

U dëgjua se si njeriu prapa derës së gozhduar lëvizi. Kërcitën tjegullat e thyera. Pas pak trokitja u ndie në derën kryesore. Plaku Andrea ia hoqi shulin. Në prag u dha prifti.

— Ti?!, — u habit plaku.

Andon Sanoja e shtyu lehtë prapa plakun dhe i liroi rrugë vetes.

— Mbylle, — i tha pastaj Andreas.

Shuli kërciti përsëri.

Në dhomë ishte e vështirë të gjeje një vend për t'u ulur, dhe prifti, pa ç'pa, u ul këmbëkryq në dysheme.

— Erdha, — tha.

— Më mirë të mos vije, — tha plaku.

— Pse? Ne kemi qenë gjithmonë miq.

— Kemi qenë, — tha plaku. — Ti më harrove, sa fillove të vësh dhjamë. Vanë shtatë vjet që nuk je dukur më këtu. Ruajte veten. Ta ruaj edhe unë?

— Kam një hall, — tha prifti.

— Domosdo. E di. Për qejf nuk do ma shikoje më derën, gjersa të mbyllja sytë. Edhe atëherë.

— Do priset kisha, — tha prifti. Në gjysmerrësirën e dhomës sytë e tij të kaltër lëshonin reflekse, si sy maceje.

— E di.

— Me ata je dhe ti.

— Me asnjë, — tha plaku. — As me ty.

— Unë thashë se...

— Ti ke ardhur të thuash, — ia ktheu plaku. — Domosdo. Unë duhet të dëgjoj. Dikur flisja unë dhe ti dëgjoje.

— Ne jemi miq, apo jo? Unë t'i di të fshehtat, ashtu siç m'i di dhe ti.

— Përse e ke llafin?

— Ç'ta zëmë në gojë, — tha prifti.

— Sapo që fillove... — Një drithërimë e lehtë i përshkoi kraharorin. — E di ç'do të thuash, — tha pastaj shpejt e shpejt. — E pastaj?

— Bëjmë një meshë sot natën, unë e ti?!, — tha prifti. — Fshatit ndoshta i vijnë mendtë.

Plaku u mendua. Sytë e tij nisën të vështronin tinës fytyrën leshtore të priftit. «Erdhi të ma përmendë sot...», — tha me vete. — Ky është djall. E di kur duhet ardhur tek unë».

— Unë do të bëj një meshë më vete, — tha plaku.

Prifti e vështroi i habitur.

— Ti!

— Po, — tha. — Për vete e për ty! Nuk e kupton? Tani çohu e ik. Ndoshta mendon se unë rroj i vetëm dhe nuk më vjen njeri. — Ai tundi kokën. — Çohu tani! Po të gjetën këtu, fluturoi mesha.

— Ç'të bëj, — klithi lehtë prifti.

— Bëj diçka që t'u bjerë njerëzve në kokë sapo të hyjnë në kishë, — e këshilloi Andrea. — Perëndia hakmerret me ata që i përdhunojnë altarin. Çohu tani!

Prifti nuk luajti nga vendi. Vështroi dyshemenë e pafshirë, kandilin në dritare, rrobat e shtruarra në dysheme, musandrën e madhe të hapur.

— Edhe...

— Një kurban!, — tha Andrea, duke u ngritur vetë i pari në këmbë.

Prifti doli.

Ai u zverdh e u shtri në dyshek. Prifti me të vërtetë pati qenë mik i tij. Disa vjet më parë ai vinte shpesh tek Andrea dhe ishte i vetmi njeri në fshat që i shkonte pas qejfit. Ata bisedonin për dyqanin e Andreas, për zotin Dino, që lidhte e zgjidhte kontratat e dyqanxhinjve të fshatit me një shoqëri italiane, për Filipin budalla, që u pasurua dhe i hëngri paratë pa bërë prokopi, për priftin, që ishte pushkatuar atë natë të 43-së. Prifti dikur vinte thuajse çdo mbasdite tek ai. Sidomos para se t'i vdiste e shoqja. Mirëpo kishte disa vjet që nuk po vinte më... Tani e gjeti shtegun. «Qiraxhiu me hanxhinë gjithmonë piqen!, — përfundoi së menduari plaku Andrea. — Ku të shkonte gjetkë?»

Gjumi e zuri shumë vonë.

Në mëngjes u zgjua nga një zhurmë e fortë, që iu duk sikur buçiste aty brenda oborrit të tij. Në mes të zhurmës dalloi ca të goditura metali dhe menjëherë mendja i shkoi për keq. U ngrit me nxitim dhe doli jashtë. Hapi me frikë portën e madhe të oborrit. Aty mbeti i shtangur.

Djem e vajza, burra e gra, ishin vërsulur në oborrin e pasmë të Shëndjelës. Shkulnin gurët «e shenjtë». Dy vetë po thyenin atë çast kryqin e madh të kambanores dhe pas pak, — siç iu duk plakut, krenaria e ftohtë u flak poshtë. Turma gumëzhinte. Së bashku me gëzimin, plaku Andrea shikonte t'i vetë-tinte në sy një flakë zemërimi. Kërcitën mbështetëset e forta të kambanave, që, për ato një shekull, kishin përhapur mbi fshat e deri te lundrat e vogla të

peshkatarëve në kënetë tinguj të trishtuar. Dhe kambanat ranë njëra pas tjetrës. Për të fundit herë ato lëshuan tinguj, por këtë radhë të mbytur. Ato u këputën e u ngjeshën pas tokës si gurë të rëndë. Kur binin kambanat, ai mbyllte sytë i tmerruar. Katër kambana! Ç'prift budalla! Nuk e parashikoi këtë? Tani mirë t'i bëhet! Megjithatë, thellë në vetvete e ndiente se prifti nuk duhej të ishte aq budalla. Mëkati ishte i llahtarshëm. Dënimi duhej të bëhej i tillë. . Prifti me ankth e trupin të mbushur me mornica. . . «Po vetë. . . zoti?». . . — tha pastaj me vete. Ndjeu se po i merreshin mendtë. U mbështet pas portës.

Por kaluan minuta, orë dhe asgjë nuk po ndodhte. Kambanorja ishte cunguar keq. Kryqet, në të dyja anët e kulmeve të çatisë, u prishën edhe ato. Pas disa orësh oborri i madh i kishës, që kishte fshehur deri atëherë mistere që trembnin njerëzit, me ca varre priftërinjsh të vdekur dhjetëra vjet më parë, u shndërrua në një lulishte të bukur. Dikur pregatiste parcelat e parkut të ardhshëm, ku do të zhurmonin fëmijët, një tjetër sillte lule nga oborri i shtëpisë së vet, të tjerë hapnin gropa për pemë. . . Një grop atje më tej nxirrte nga dera e pasme e kishës ikonat e pluhurosura, midis të cilave plakut Andrea i ra në sy ajo që paraqiste darkën e Krishtit para martirizimit. Dy djem të shëndetshëm morën me mundim një kryq të madh, e mbështetën pas murit dhe, duke fshirë djersët me shami, vështronin njëri-tjetrin. Një grup tjetër po prishte kurizin e jashtëm të ajodhimës, ku mendohej të hapej një derë e veçantë për skenën e vatrës së kulturës.

Të gjitha këto ai i vështronte nga pragu i portës. Tek priste të shfaqej «mrekullia e djallit», ankthi i

tij mbetej si një teh i mprehtë thike që i ngacmonte kraharorin. Më pas gjithçka u qetësua. Atij po i dridheshin gjunjët.

Hyri brenda. Dielli pranveror po kthehej nga përrëndimi. E ndiente veten shumë të lodhur. Ja që ky nuk ishte fundi i botës! «Një prift është gjithmonë më budalla se një tregtar!», — mendoi, duke u zvaritur nëpër oborr.

Papritur dëgjoi se dikush trokiste në portën e madhe. Ishte gati mbasdite dhe prifti nuk mund ta bënte një budallallëk të tillë. Kushdo tjetër do të ishte i parrezikshëm. Megjithatë, njerëzit i dukeshin të gjithë të egër e hakmarës. Dita nuk ishte e zakonshme. Mposhti vitet që i rëndonin këmbët dhe nxitoi të hapte portën. Por atje mbeti i shtangur. Para tij qëndronte fëmija i vogël. Ai e vështroi plakun drejt në sy dhe gati duke belbëzuar tha:

— Mirëdita!

Plaku nuk ia ktheu përshëndetjen. E pa me egërsi. Por kësaj radhe fëmija nuk u tund nga vendi. Poshhtë duarve të plakut, të mbështetura te porta, vështroi një copë herë brenda në oborr dhe pyeti:

— A ke ikonë në shtëpi?

Plakut nuk iu durua më. Shfryu:

— Po, kam!

— Atëherë ma jep mua ta çoj me të tjerat. Atje...

Andreas iu errësuan sytë. U hoq mbrapsht dhe u fut brenda.

## 9.

Sulmi mbi kishën, që kishte filluar atë mëngjes, i ngjante sulmit mbi një kështjellë të fortifikuar mi-

rë. Ndryshimi i vetëm ishte mungesa e krismave të armëve. . .

U hapën dyert e rënda: Dielli pranveror zgjaste drejt perëndimit hijen e kambanores së lartë. Kjo ngrehinë, që sundoi qiellin njëqind vjet me radhë, ishte si një gisht dëftues drejt qiellit, me pesë kryqe të mëdha në çati. Në pjesën e sipërme zotëronte një piramidë majëhollë, ndërsa në katër faqet e saj ishin skalitur në beton trekëndësha të lartë me kryqe të vogla në kulmet e sipërme. Lartësia e kambanores i kalonte të njëzet e pesë metrat dhe para disa vitesh ajo mbahej si Everesti i fshatit. Kjo majë u kalua kohët e fundit nga një shtyllë e tensionit të lartë, që u pasua pastaj nga disa dhjetëra të tjera, dyqind metra larg njëra-tjetrës.

Në fillim, para se të hapej dera e madhe e kishës, kyçur me tre dryna të mëdhenj, zotëroi gjithkund heshtja. Fshati ishte grumbulluar i tëri. Pranë derës ndodheshin mbi tridhjetë të rinj. Çelësat i kishte prifti. Atë ishte e kotë ta kërkoje në fshat. . .

- *Kanë frikë!*
- *Punë që s'bëhet kjo!*
- *Ndalon ligji, vallë?*
- *Le ta shqyejmë, more!*
- *Pa hidhu ti. . . Ta mban?*
- *Zot, shpëtona fëmijët!*

Befas dikush çau turmën dhe u drejtua për nga grupi i të rinjve. Njerëzit njohën sekretarin e Partisë të fshatit. Nuk u dëgjua se ç'foli ai me të rinjtë, vetëm se disa minuta më vonë një sqepar nisi të shkallmonte mbajtëset e hekurave të drynave dhe. . . dera u hap. Pasi një heshtje e gjatë. Edhe në kishë filloi puna në rregull. Vetëm një incident u dha shkas

përsëri hamendjeve. Tek hiqeshin nga vendi llampadarët e rëndë të qirinjve, njëri prej tyre u këput befas dhe ra me zhurmë në dyshtemenë me pllaka guri. Më pas u vu re se zinxhirit të hollë, që mbante llampadarin, i ishte hapur një hallkë. Ishte, pa dyshim, dorë njeriu.

Ndërkohë, gjithçka që ishte ndriçuar gjer atëherë vetëm nga drita e qirinjve, tani po dilte në dritën e diellit.

Viktori ngulte këmbë që ikonat duheshin dje gur të gjitha qysh atë ditë, ndërsa Nasi, sekretari i rinisë, kundërshtonte.

— Ndonjëra mund të ketë vlera të mëdha artistike. . . ato i kanë krijuar artistë të dalë nga populli, — tha ai.

— Neve na duhen piktura me vlera të shëndosha ideore, — kundërshtoi Viktori. — Ç'të mëson kjo «Darkë e Krishtit»? Asgjë! Sado e përsosur të jetë. Atëherë, pse ta mbajmë kot?, — kundërshtoi Viktori.

Arta dëgjonte herë njërin, herë tjetrin. Sapo kishte mbaruar parcelën e saj dhe në kënd të murit kishte mbjellë një trëndafil të kuq, që çelte qysh në janar. Pastaj qëndroi para ikonave. Më e madhja e tyre dukej që ishte më e re se të tjerat. . .

*. . . Atëherë ajo nuk duhej të ishte më shumë se gjastë-shtatë vjeçe. Luante përpara shtëpisë, kur vëmendjen ia tërhoqi një grup fëmijësh, moshatarë të saj, të cilët përpiqeshin të hipnin mbi murin e pasëm të kishës. Pastaj ata qëndruan pranë një vrimë të hapur në mur. Gati pa e kuptuar as vetë, Arta e vogël ishte bashkuar me ta dhe, ndërsa të tjerët ngriheshin në maja të gishtave për të vështruar për-*



mes vrimës, ajo, falë trupit të gjatë që kishte qysh atëherë, dalloj pas akacjeve të dendura një njeri të çuditshëm.

Ishte pranverë dhe bari i harlisur kishte nisur të zgjaste shtatin. Matanë murit dikush ngjyrote një beze të bardhë me një shkop të hollë dhe dalngadalë nisën të dukeshin figura njerëzish. Fëmijët ndenjën rreth vrimës në mur ndonjë or, pastaj u larguan. Arta u kthye përsëri të shikonte jo aq pikturen, sesa piktorin e çuditshëm.

Ky ishte një burrë trupmesatar, me flokë krejtësisht të bardhë e mjekër të gjatë e të thinjur. Nën qepallat e dendur thelloheshin dy sy të vegjël, të kaltër, që kishin një shkëlqim qielli të pastër. Hunda e tij e kthyer gati puthisej me mustaqet e dendura, të cilat, së bashku me mjekrën, linin të dukej midis tyre një vizë e kuqe buzësh, që humbisnin e shfaqeshin sipas lëvizjeve të nofullës. Burri mbante veshur një dolloma të hollë ngjyrëkafe me mëngë të gjera, të cilën e shtrëngonte në mes me një litar kërpi sa një gisht. Në këmbë mbante sandale, dhe shputa e dobët dukej si e mbuluar nga një cipë e hollë mëndafshi. Kur vizatonte, ai mbështeste pas telajos dorën e majtë dhe mbi të kryqëzonte të djathtën, që mbante penelin. Kështu që lëvizjet e dorës që vizatonte ishin gati të padukshme. Njëherë, kur u ul të pushonte mbi një arkë të vogël, mbështetur pas murit, Arta vuri re se si i dridheshin duart e dobëta dhe mëngët e gjera të dollomasë.

Ai punoi shumë ditë me radhë aty, pas murit të kishës, dhe përfundoi një sërë tablosh e portrete shenjtorësh.

Që prej asaj kohe për Artën shtatëvjeçare humbi

*misteri që i rrethonte ato piktura aq, sa njëherë, kur gjyshja Stamato ishte gjunjëzuar para ikonës, i kishte thënë:*

*— Nëno, unë e di kush e ka bërë këtë vizatim!*

*Plaka i shtrëngoi dorën kaq fort kësaj fëmije rrebele», sa vajza bërtiti. Dhe atë e nxorën jashtë nga kisha. . .*

Tani e kishte parasysh përsëri këtë tablo, ashtu si dhjetë vjet e ca më parë, kur piktori plak e kishte punuar me duar të dridhura nga pleqëria. Atë njeri aq të dobët e të drobitur Arta e kishte kujtuar gjithmonë dhe tani mendonte se ai mund të kishte qenë një artist i madh, pavarësisht se kishte pranuar të vizatonte këtë tablo. «Ndoshta ishte i uritur. . .», — i vetëtiu nëpër mend. Mjegulla e fëmijërisë u shpërnda befas dhe ajo sikur i dalloj qartë sytë e tij të thellë e të vuajtur. Ndaj asaj nuk i vinte mirë t'i hidhnin gjithë ato punime pa i parë me kujdes. Megjithatë e kuptonte Viktorin e saj si asnjëherë tjetër. . .

Ikonat erdhën e i morën pas disa orësh. Mbeti aty pas murit vetëm kryqi i madh me Krishtin të mbërthyer.

Aty nga dreka vajza u nis për në shtëpi e lodhur, por e kënaqur.

Në kohën kur ngjiste shkallët, iu kujtua gjyshja Stamato. Ikona e shën Dhimitrit qëndronte akoma në dhomën e saj dhe një mbrëmje më parë ajo s'kishte dëgjuar t'ia hiqnin.

— Ju mos e shikoni, — pat thirrur plaka. — Unë e kam në dhomën time.

Kur hyri Arta, gjyshja po krihej pranë dritares.

Ajo mënjanoi me dorë ato pak leshra të thinjura dhe i hodhi së mbesës një vështrim gjithë inat:

— E, a u kënaqët?

Arta buzëqeshi.

— Shumë, — iu përgjigj ajo. — Dhe, siç e shikon, jemi të gjithë shëndoshë e mirë.

— Do ta gjeni më pas, po hë!, — ia ktheu plaka. — Dora e zotit është e gjatë dhe i kalon vitet..

— Si nuk e pamë gjëkundi, xhanëm?, — nisi përsëri Arta.

— Pa m'u hiq sysh!, — thirri plaka duke rrëmbyer nga vatra mashën.

Arta u fsheh pas derës dhe prej andej zgjati kokën e i tha gjyshe:

— Kush është më i madh, Krishti apo shën Dhimitri?

— Krishti, domosdo!, — iu përgjigj plaka.

— Po kur i hoqëm ikonën Krishtit dhe nuk bëri zë, shën Dhimitri do të jetë bërë si pulë. Ç'thua?

— Lipsu!, — bërtiti plaka.

— Unë do të bëj një provë. A, të keqen Arta ty, moj gjyshe! Të kam xhan, moj gjyshe! Të kam shpirt! Më vjen turp edhe nga shokët e shoqet. Si thua?

— Është marrosur kjo!, — tha plaka me zë të ulët. — Goxha vajzë! Pret edhe të fejojhet, pale! Pa të dëgjon ai djali e ta rregullon samarin. Firifiu fare të jetë, moj korbë?!

— Kush, Viktori?

— E, ai, po kush?

— Vërtet që do të ma rregullojë samarin, po nuk e hoqa shën Dhimitrin tënd nga muri!

— Një mendje keni. Kalamaj, ç'pret!

— Si thua?

Plaka filloi të mplikste flokët. Arta u ul mbi minder. Pa në mur fotografinë e madhe të xhaxhait tek buzëqeshte hijshëm. Iu duk sikur edhe ai ishte në një mendje me të. Plakës nuk i vinte mirë t'i përmendje të birin e vrarë. Atë e kishin vrarë para syve të saj dhe i dukej sikur, po të qe përpjekur pak më shumë, ajo mund ta shpëtonte të birin. Arta i dinte të gjitha këto, por atë ditë nuk mund të gjente argumente më të forta për t'i mbushur mendjen gjyshes.

— Po Shëndejela?, — pyeti befas, duke i mbajtur sytë gjithmonë mbi fotografinë e dëshmorit.

Plaka i nguli vështrimin vajzës dhe ktheu kokën edhe ajo nga fotografia.

— Ç'do të thuash?

— Që fshehu ata kriminelë, ja, ç'dua të them!, — thirri Arta. — Ata që na vranë xhaxhanë, që na dogjën më pas shtëpinë, që deshën të na zhduknin. Ku ishte zoti atëherë, që i la të futeshin në shtëpinë e tij dhe të bënin krime të tilla?

— Ata i fshehu prifti, — tha plaka, me zë të dritëruar.

— Dhe prifti u pushkatua!

— Po kishën ti e quan shtëpi të zotit, moj gjyshe! Jo!, — ngriti zërin vajza. — Unë do ta zhdok shën Dhimitrin tënd, moj gjyshe. Dhe atje, në krye, do të vë fotografinë e xhaxhait. Dhe s'ka për t'ia ndriçuar më fytyrën një kandil meit, por një dritë e fortë elektrike. Ja, kështu!

Plaka stepi.

Vajza kishte hyrë në dhomën tjetër. Kandili me vaj ishte në të shuar. Arta hipi mbi sepetin e gjy-

shes, i fryu flakëzës së zbetë dhe ndezi dritën elektrike. Pastaj hoqi nga muri portretin e shenjtit.

Plaka as që u ngrit të hynte në dhomën e saj. Mbeti për një kohë të gjatë duke vështruar gajtanin e kuq që i rrethonte kërcinjtë e këmbëve.

10.

Fëmija të nesërmen trokiti përsëri në derën e plakut Andrea. Trokiti disa herë. Si nuk mori përgjigje, u ul mbi sofatin e portës. E dinte që ai ishte brenda. Ai erdhi këtu, sepse nuk donte ta egërsonte plakun. Do t'i lutej përsëri për ikonën. Po atë ditë mësuesja i kishte thënë se plaku trembej nga ikona. Po nuk duhej të kishte asnjë frikë. Këto ajo ia tha kur ai e pyeti se si duhej t'i mbushte mendjen plakut.

Fëmija ishte truplartë për moshën që kishte. Fytyrën e kishte të gjatë, pakëz të hequr dhe sytë e kaltër i vetëtinin. Ai qëndroi gjatë para portës. Trokiti edhe disa herë të tjera dhe u largua.

Para disa ditësh plaku e kishte pyetur se ç'ishte 6 Shkurti dhe deri ku do të vente hekurudha. Ata ishin ulur, si zakonisht, mbi sofatin e portës së madhe. Kur kishte ardhur djali, e kishte gjetur plakun Andrea duke lexuar një gazetë. Ai ndenji disa minuta duke parë se si duart dridheshin së bashku me gazetën. . .

— Bastunin nuk e kam me vete, e dogja!, — kishte thënë ai.

Djali as që e kuptoi. Nga toni i tij i butë mendoi se plaku po bëhej i afërt. Dhe i kishte vajtur pranë ngadalë. Pastaj hipi mbi sofatin e portës dhe i tha

plakut se, po të kishte nevojë, mund ta ndihmonte.

— Nesër dua dy shtamba me ujë! — Këto fjalë ishin si një urdhër i prerë. Por djali nuk i kuptoi kësh-tu. Ndryshe, as që do ta ndihmonte.

Dhe ishin ndarë për atë ditë.

Tani, duke u ngritur nga sofati, mendoi se ai njeri nuk do të ndryshonte kurrë. Gjithë jetën kishte qenë i egër. As djali nuk donte të kishte të bënte me të.

Ndërkohë plaku Andrea qëndronte shtrirë. Ai i kishte dëgjuar mirë të trokiturat në portë dhe, sado që nuk e dinte kush që, prapëseprapë kishte vendosur të mos e hapte. Për afro njëzet e katër orë e kishin mbërthyer një palë ethe të forta dhe koka i digjte. Dhoma i dukej si një varr i madh, i zbrazët, i nxirë. Ai kishte zënë një vend fare të vogël, thujse të parëndësishëm në atë varr, por, nga nxehtësia e ethe-ve, aty ndiente zagushi. Pas kaq vitesh, më së fundi, tani që largoi edhe fëmijën, e ndjeu veten plotësisht të braktisur. Thellë, në skutat më të errëta të shpirtit, e ndiente se nuk duhej ta lëshonte veten kësh-tu. Dhe mendoi se duhej të bënte diçka për të shpëtuar nga kjo torturë. Mjaft kishte mbetur aq i vetmuar. Në gjendjen që që krijuar, prifti mund të ishte një mik për të qenë. «Një aleat... është më shumë se asnjë...» — Psherëtiu. Me ndihmën e zotit apo me forcat e veta ai duhej të luftonte të bënte diçka, të ndihej dora e tij, si njëherë e një kohë, të mos mbetej në atë shkallare të fundit, ku nuk e ndante veçse një hap nga gremina...

U ngrit nga shtrati dhe, nën rrezet e hënës së gërryer nga njëra anë, doli nga shtëpia dhe u fut në oborrin e kishës. Qipariset e lashta psherëtinin. Duke

u dridhur i tëri nga ethet, i mbështjellë me po atë pallto të vjetër e të zhubravitur, ai ecte përmes parcelave të bukura të lulishtes së re, me sy të ngulur në një pikë. E dinte që ikonat që nxorën nga kisha i kishin marrë të gjitha. Kishte mbetur rastësisht atje, pas murit, vetëm kryqi i madh me Krishtin të kryqëzuar. U ul pranë Krishtit. Instiktivisht, ashtu siç ishte, i përkulur, nisi të lutej nëpër dhëmbë, duke menduar se kështu do të afronte më shpejt orën e hakmarrjes. Sikur t'i lutej Krishtit t'i falte mëkatin? Por... lutja i mbeti në gojë. Asnjëherë ai nuk kishte qenë aq fetar sa atë natë. Kur kishte akoma dyqanin, ai i urrente priftërinjtë që vinin ta bezdisnin gjithmonë për atë ndihmë të mallkuar që duhej t'i jepte kishës. Bile, dy-tri herë kishte synuar t'i shtinte në dorë ulla të tilla. Rrallë, ndoshta vetëm në pashkët e mëdha dhe në krishtlindjet, kishte shkuar në kishë. Këtë e bënte që të harxhonte disa qindarka për qirin në sy të bashkëfshatarëve. Nuk mbante mend sa kohë mund të kishte pa kunguar dhe tani, ky gjak i shenjtë që shkonte rrëke nga këmbët dhe duart e Krishtit të kryqëzuar, i shtonte dhembjen dhe pendimin.

I zhytur në ato mendime, ai nuk e ndjeu për një kohë të gjatë të ftohtët. Pastaj mbeti si i ngurosor. Një rrymë e akullt që i depërtoi në trup e solli në vete. U ngrit dhe u tërhoq mbrapsht.

«Ky Krisht duhet të jetë budalla!, — mendoi befas, gati i marrosur. — Përse nuk hakmerret, xhanëm?»

I vërshoi gjaku në kokë... Prishi parcelat e bukura të lulishtes, shkuli me egërsi lulet dhe i shtypi me këmbë. Me duart që i dridheshin nga pleqëria dhe

nervozizmi, rrëmbeu nga toka një gur dhe e përplasi pas një peme të re. Pema u lëkund, po nuk u thye.

U kthye në shtëpi i dërrmuar. «Bëra ç'desha, — murmuriste me vete. — E lehtësova këtë rrugë të llahtarshme. Nesër me siguri do të vijmë të më mbërthejnë në grykë».

Ai u dogj nga ethet tërë natën. Fliste përçart. Në mëngjes e zuri gjumi. U zgjua vetëm kur dielli ishte ngritur shumë lart. Gjithçka kishte ndodhur natën, tani i dukej si ëndërr. Pastaj e mbërtheu përsëri ankthi i hakmarrjes së njerëzve kundër tij. Prandaj trokitjet e rregullta dhe të ngadalshme të fëmijës atij i tingëllonin në vesh si qindra goditje të fuqishme mbi portë, sikur porta do të çahet ato çaste dhe turma e zemëruar do t'i zinte frymën.

Por kaloi pothuajse dita dhe, për çudinë e tij, asgjë nuk po ndodhte. U ngrit disa herë nga dysheku të mbështeste veshin pas portës. Hapat e njerëzve në rrugë herë shtoheshin e herë rralloheshin. Askush nuk e kthente kokën të hidhte sytë andej nga shtëpia e zyrtë.

Ra nata. Ai digjej nga ethet. Aty nga ora tetë atij i ra në vesh biseda e djalit me vajzën. Kishte etje t'i dëgjonte, por tani e shikonte se nuk do të mundej t'i afrohej derës së dhomës. Zërat vinin të shkëputur. Gjithkund zotëronte një heshtje e thellë. Papritur dëgjoi shkoqur fjalën «kishë» dhe u rrëqeth. Mos e kishin diktuar? U ngrit me mundime të mëdha dhe u mbështet, ashtu si shumë herë të tjera, pas derës së dhomës.

— ... hyri brenda në shtëpi, — thoshte vajza. — Bisedoi gjatë me babanë. Sot, më duket. . . Ty, të tha gjë...



— Po... pastaj... do të desha që më parë të sqaronim këtë çështje...

— Me siguri e thua?

— Shëët!

Vajza qeshi.

— Të prishte lulishten?... Maskarai!

Plaku u tendos i tëri për të dëgjuar.

— Mundet që kafshët..., — tha vajza, — nuk dalloheshin gjurmë të tjera.

— Përkundrazi. Ishin gjurmë të qarta njeriu. Kafshët nuk i shkulin lulet. Këtu matanë...

Sa më shumë këmbëngulte djali në mendimin e tij, aq më tepër dridhej plaku, aq më tepër ai bëhej haptazi një armik i tij. Përkundrazi, vajzën filloi ta adhuronte.

Që në mesditë kishte filluar të frynte erë e ftohtë që paralajmëronte kohë të keqe. Era depërtonte tani në të gjitha anët e shtëpisë së shkatërruar, duke u grindur me tjegullat dhe pemët jashtë në rrugë. Plaku dridhej nga të ftohtët. As që e ndiente se ishte në dysheme dhe kishte dëshirë të dëgjonte akoma.

— Ftohtë?, hë? — pyeti djali.

— Po!, — tha vajza me zë të lartë. — Kam ftohtë!

— Shëët! Mos na dëgjon ai...

— Me siguri, ia ka këputur gjumit...

— Po nuk flë fantazma, — tha djali.

— Vërtet... këtu lidhen e mpliksen disa gjëra... Ne nuk duhet... tani me kishën edhe këtu...

— S'ka tjetër.

— Plaku?

— Lulishtja është prishur nga njerëzit e shtëpive

që janë rrotull kishës, — tha djali. — Copat e baltës të mbartuara nga këpucët të sillnin deri te porta e...

— Fantazma dhe kisha... — tha mbyturazi vajza.

Plaku nuk i dalloi qartë fjalët e fundit.

«Siç duket, tani ajo është strukur në gjoksin e tij», — mendoi plaku.

Tani armike për të u bë vajza. Plaku pështyu.

Heshtja që pllakosi pas këtyre fjalëve ishte aq e gjatë, sa plaku mendoi se ata duhej të ishin larguar. Mirëpo nuk luajti nga vendi. I ulur këmbëkryq pranë derës, u mundua të ndizte një cigare. Por ajo nuk i shijoi. Ethet po e vinin poshtë.

## 11.

«Këta i rregulluan punët me njëri-tjetrin, — mendoi plaku kur u struk përsëri në rroba. — U bënë edhe prindërit e tyre fëmijë si këta!», — shtoi ai me inat.

Rënkoi. Dorën e dobët me damarë të kërcyer e mbështeti pas ballit. Koka i digjte. U mbështoll më mirë me jorgan dhe u kthye në njërin krah. Hënë nuk kishte. Pas pak kandili u fik nga era dhe dhoma u zhyt në errësirë.

«Ja ç'do të thotë të jesh i verbër», — mendoi përsëri ai.

Në atë masë të errët rrymat e ajrit, që depërtin nga të çarat e dritareve, përplaseshin lehtë pas mureve dhe e mbushnin dhomën me fërshëllima të mbytura. I dukej sikur në atë hapësirë të pamatë, të zezë, endej një shpirt që në të vërtetë nuk zinte asnjë vend... Muret as që dalloheshin.

Pak nga pak konturet e shtrembra të dritareve plaku nisi t'i dallonte qartë, mbushur me atë dritë të pakuptueshme që lëshon nata, sado e errët që mund të jetë. Mendja i fluturoi nëpër vite. Ishte e para herë, ndoshta, pas kaq vitesh, që ai donte të mendonte për atë që i shfaqej gati çdo natë. Tani ishte i sigurt që njerëzit do të vinin ta merrnin dhe ta vrisnin para trugut që kishte mbetur nga selvia e gjatë... A ia vlente të trembej për këtë? I pëlqente që, nën zjarrin e etheve, të kujtonte edhe një herë atë jetë të kaluar, kur mendonte se nuk kishte asnjë armik, përveç Filipit budalla, dhe tani i vinte çudi se si atëherë, aq i pasur dhe i përkrahur nga autoritetet, nuk e shfarosi atë njeri.

*... Tre vjet pasi kishte hyrë Italia, Andrea besoi se më së fundi kishte ardhur dita që ta nxirrte pasurinë e tij nga caku i një tregtari të vogël. Lidhjet me qytetin i forcoi më shumë. Netve të ngrohta, kur shtrihej nën selvinë e madhe me një gotë raki e një pjatëz me turshi përpara, ai ëndërronte për një port të ri, diku afër fshatit, duke i detyruar, kësisoj, ata të doganës të hiqnin dorë nga taksat mbi mallrat që kalonin nëpërmjet portit të qytetit. Ngandonjëherë ai ëndërronte edhe për gjëra më të mëdha.*

*Një ditë, në dyqanin e Filipit ishin hedhur ca trakte. Andrea, kureshtar, kishte vajtur me vrap deri tek ai dhe kishte lexuar njërën prej tyre. Filipi, i verdhë si limoni, ishte afruar ngadalë dhe priste një fjalë të mirë nga Andrea. Ky kishte qeshur. Dy-tre fshatarë që ishin në atë kohë në dyqan, qenë ngritur të iknin. Ai kishte qeshur. Befas ishte dëgjuar një krismë arme. Filipi vërtetoi shpejt e shpejt se plumbi kishte goditur në mish. Të nesërmen u bë një cere-*

moni varrimi për një tradhtar. Merrnin pjesë dhjetë vetë. Filipi e Andrea u mbyllën në shtëpi.

Disa ditë më vonë në qytet u vra një kolonel italian.

Fshati po përgjysmohej. Shtëpitë digjeshin sikur të ishin lodra fëmijësh. Tek Andrea vinin të blinin vetëm gratë. Dy-tre pleq hidhnin ndonjë kupë me verë, çanin arra me gurët e peshores dhe pëshpërisnin me zë të ulët. Djemtë luftonin në male. Në Tërbaç, Gjorm e Kuç bëheshin përleshje me armiqtë. Këtë e vërtetonin edhe kamionët e shumtë që transportonin ushtarë dhe zhurma shurdhuese e mortajave që rrihnin kodrinat e përrenjtë nën Majën e lartë të Gribës.

Çmimet rriteshin në mënyrë të çuditshme. Andrea qahej se kjo e gjitha vinte për faj të Filipit budalla, që nuk dinte ç'ishte tregtia. Ai nuk mund ta mbyllte dyqanin e të falimentonte para kërcënimeve të Filipit.

Fshati vuante për bukën e gojës. Një grusht oriz, për fëmijët që i shpëlante barku, zor se mund ta gjeje gjëkund. Në depon e errët të Andreas grumbulloheshin thasë me oriz, dhe ai priste një kohë më të përshtatshme për t'i shitur. Njerëzit nuk kishin me se të blinin. Kështu, u hap libri i madh i borxheve me kapakë kartoni të ashpër.

Ato ditë të vështira, një mbrëmje erdhi në fshat një njeri i çuditshëm. Thoshin se ishte shqiptar nga origjina, po kishte vite që banonte diku, në një vend të huaj. Atje kishte ngritur një fabrikë vere. Ai tregonte gjithë mburrje se fiaskot, që mbanin stampat e tij, qarkullonin në gjithë botën. Sipas tij, këtu ai kishte ardhur të rrinte ca kohë e të përfitonte nga

përvoja e fshatarëve në nxjerrjen e verës. Shumë ditë me radhë ai i provoi të gjitha llojet e verërave. Më shpesh shkante në dyqanin e Filipit. Atje linte dhjetëra napolona, bisedonte me fshatarët për bërshin e rrushit, për fuçitë e drunjta, për mushtin dhe për vetë verën.

Që në fillim Andreas nuk i pëlqeu ky njeri. Antipatia e tij nisi të forcohej, kur ai filloi të miqësohej me Filipin, që «s'kishte haber nga qytetërimi dhe nuk e kishte kaluar kurrë pragun e qytetit më të afërt». Sa herë që i huaji nxirrte portofolin e zi dhe e linte pa teklif mbi tavolinë, sytë e Andreas lëshonin xixa. Rastiste që vinte edhe në dyqanin e tij. Atëherë antipatia kthehej në servilizëm. Dritaret me hekura të dyqanit mbusheshin nga jashtë me fëmijë të rreckosur, që prisnin me sy të çakërdisur nga uria t'u hidhte ndonjë lëmoshë tregtari i madh. Andrea afrohej fshehurazi në dritare dhe me shpejtësi u përplaste në fytyrat e vogla një kovë me ujë të ftohtë. Pastaj zinte e bërtiste me sa kishte në kokë:

— Rreckamanë! Të ndyrë!, — i shante ai fëmijët, që largoheshin nga dritarja gjithë inat e rrobat qull. Pastaj kthehej nga «paskaniku» dhe i murmuriste me përulje:

— Na ndjeni, zoti Nikos. Këta maskarenj. . .

Të huajit i vinte mirë kur i thërrisnin kështu, sepse, në të vërtetë atë e quanin Niko, dhe buzëqeshte me kënaqësi, gjithmonë i ngopur e faqekuq nga vera e tepërt që pinte.

Ky i huaj nuk dihej ku i kalonte netët. Andrea disa herë ishte matur ta ftonte në shtëpi, por asnjëherë nuk kishte arritur t'i bënte ftesën. Ai largohej

nga dyqanet sikur ja, do të kthehej përsëri pas një çasti, e në të vërtetë zhdukej për gjithë natën. Meqë e nisi mirë me Filipin, shumë nga njerëzit e interesuar mendonin se gdhiehej tek ai. Këtë e përgënjeshtroi me forcë vetë Filipi disa ditë më vonë. Disa të tjerë besonin se i huaji shkonte çdo mbrëmje në qytet.

Një mëngjes herët, disa fshatarë e panë të dilte nga dyqani që kishte bilardo dhe, meqë e dinin se aty mblidheshin vetëm kumarxhinjtë, besuan se ai luante gjithë natën bixhoz. Kishte raste që shoqërohej edhe me postkomandantin, një burrë trupshkurtër, thatim e nevrík sa nuk bëhej më. Kur nisën ta shihnin me të, fshatarët filluan ta urrenin. U dukej sikur diçka po kurdiste pikërisht tani që lufta ishte ndezur anembanë vendit.

Pastaj nuk e panë më ditë të tëra.

Një mbrëmje dhjetori me shi e furtunë ai u kthye përsëri në fshat. Këtë radhë jo i gjallë, po një kufomë e prishur dhe e copëtuar, që e mbanin mbi supe karabinierët. E lëshuan aty mbi sofatin e kishës. Prifti ishte vrarë tri ditë më parë. Por, edhe sikur të ishte gjallë, rregullat e kishës nuk lejonin të futeshin brenda kufoma të copëtua. Aty mbeti dy ditë me radhë, i rrethuar nga karabinierët dhe qentë e fshatit.

Fshati u torturua. Pas vrasjes së priftit, vdekja e Nikos nxiti hysterinë e shkatërrimeve. Shumë herë në ditë karabinierët zvaritnin para trupit të tij herë njërin dhe herë tjetrin, sikur donin të nxirrnin kriminelin nga ballafaqimi me kufomën. Për këtë çështje erdhi vetë kuestori i qytetit. Ai banoi disa ditë në shtëpinë e Andreas. Ata rrahën fshatarë dhe do-

*gjën shtëpinë e plakës Stamato. Por fshati heshti si shkëmb.*

*Pas dy ditësh erdhën një veturë luksoze dhe një kamionçinë, që qëndruan para kishës. Fëmijët, ishin nga s'ishin, u grumbulluan të gjithë. Nga vetura zbriti një oficer madhor, që nuk ishte italian, por që shoqërohej prej tyre. Trupin e të vrarit e futën në një arkivol të bukur, veshur me kadife të kuqe, dhe e ngarkuan në kamionçinë. Nuk e shoqëroi asnjë prift.*

*Atë ditë Andrea derdhi një pikë lot. Po nuk qau për Nikosin. Pas kësaj, gjithë jeta e tij do të fillonte të bënte atë rrugë të gjatë e rraskapitëse drejt vdekjes.*

*Nikosin e vrau ai. Portofoli i të huajit atë natë ishte i mbushur plot.*

## 12.

Plaku Andrea u përpëlit gjithë natën nën zjarrin e etheve. Fytyra e përgjakur e Nikos i shfaqej në trajta të ndryshme.

Në të vërtetë, atë natë ai donte ta sillte ndër mend këtë ngjarje me të gjitha hollësitë... Pastaj iu kujtua se si në kohën e pushtimit gjerman deshi të largohej fare nga Shqipëria, por nuk mundi. Të huajt e rinj nuk patën kohë as të merrnin frymë. Mezi mbushën vitin. Dhe rrugët u mbyllën papritur. Atëherë e ndjeu veten përgjithmonë si peshku në stere...

Në mëngjes herët, para se të shkonte në shkollë, fëmija trokiti përsëri në derën e tij. «Zemërim fëmijësh!» Mësuesja thoshte se ikonat hiqen me këmbëngulje.

Dita ishte e hapur. Re të vogla, të bardha po strukeshin horizontit. Megjithatë frynte garbino, dhe vija që ndante qiellin nga deti ishte e trubullt. Gropëza e gadishullit i ngjante një vaske të mbushur me shkumë resh të pista. Ai ndenji i dëshpëruar aty, derisa ra zilja e shkollës. Pastaj iku me vrap.

Plaku i dëgjoi të trokiturat. Kësaj radhe ai kishte dëshirë ta hapte portën dhe ta ftonte atë që trokiste të hynte brenda. Por nuk pati fuqi të ngrihej. Kur nuk i dëgjoi më të trokiturat, qau.

Gjithë ditën vuajti shumë. Një kollë e fortë po i çante mushkëritë. Nga pasditja sikur u qetësua pak. Me mundime të mëdha thujse zvarë, u ngrit dhe u hoqi dyerve shulet e ndryshkura. Po qe se do të vdishte, të paktën të mos qelbej në mes të shtëpisë. Dikush do të kujtohej të hynte, po të ishin dyert të hapura. Dy orë më vonë u bë përsëri keq. Frymëmarrja iu vështirësua.

Në mbrëmje, një hije kapërceu murin e shembur të avllisë. Qielli ishte nxirë dhe nga deti dëgjoheshin bubullima. Derën e shtyu me forcë, po, për habi të tij, ajo u hap më lehtë nga ç'pritej. Në dhomë, nën dritën e zbetë të kandilit, ai pa dikë që po përpëlitej në rroba, si të ishte një krimb vigan.

— Adre!... Andre!, — thirri me zë të ulët.

— Eh... — murmuriti zëri poshtë rrobave.

— Jam unë, prifti... Dëgjon? Erdha përsëri.

— Vo... onë... shumë voo... në!

— Ç'ke, xhanëm?

— Bëra sa munda... edhe pa ty... pa ty!, — tha plaku.

— Ç'bëre? Dëgjomë... U dogja fare... Diçka...

— Asgjë!, — tha befas plaku me forcë. Dhe sytë



iu hapën sa s'bëhej më. Prifti, i tmerruar, u tërhoq mbrapsht, qëndroi një çast me duart hapur dhe u largua. Plaku buzëqeshi hidhur dhe u mendua të pështynte. Pështyma iu var buzëve dhe i zbriti nën mjekër.

13.

Dëbora që ra atë natë ishte ngjarja më e këndshme për atë fshat që ndodhej aq pranë detit. Po shpejt cipa e saj e hollë nisi të grisej vende-vende nën rrezet e një dielli verbues. Pulëbardhat e vetmuara suleshin përballë një tramundane të lehtë, gati të pandjeshme, që kishte fuqinë e një flladi dhe ftohtësinë e vetë dëborës. Muaji që pat hyrë në mesnatë, premonte kohë të mirë dhe punë të mbara.

Po fshati e pa dëborën akoma të pagrisur. Në oxhaqet e thelluara në mure zjerret përvëltonin fundet e nxira të tiganëve me petulla. Valixheve po u merrej pluhuri dhe bravat e tyre po vajoseshin. Djemtë dhe vajzat po niseshin për në hekurudhë. Rreth zjarreve vazhdonin bisedat e ndërprera një natë më parë. Flitej për shina të gjata e të rënda, për qyteza të përkohshme, për udhëtimet e shpejta që i shtonin jetës mirësitë.

Petroja, ulur këmbëkryq mbi postiqe, në anë të oxhakut, po u tregonte fëmijëve për rrugën Kukës-Peshkopi. Vëllai i vogël e shikonte Artën gjithë zili. Pa le të shikonte ajo se ç'do të bëhej ai pas pesë vjetësh! Gjyshja Stamato ngjiste e zbriste shkallët si një tridhjetëvjeçare.

— Nuse!, — thirri qysh në prag të derës. — T'u

dogjën, moj e bekuar, nuk i shikon? Oj, u hutua tjetra, sikur po nxjerr vajzën nuse! Një muaj është. Po ta kishe në shkollë të lartë?

Ra dielli, çatitë nisën të pikonin dhe fshati e nxori në shesh gëzimin e mbyllur brenda shtëpive. Turmat u përdrodhën rrugicave të ngushta dhe vërshuan në rrugën e madhe. Te sheshi, një banderolë e madhe, e kuqe, me shkronja të bardha, u uronte rrugë të mbarë aksionistëve. Vajzat, faqekuqe nga shëndeti dhe të ftohtët, putheshin me njëra-tjetrën. Djemtë, më të përmbajtur, ishin grumbulluar grupe-grupe. Prindër e fëmijë kapeshin nga duart e vullnetarëve sikur të donin t'u jepnin edhe një pjesë nga fuqia e tyre. Dy sy të kaltër endeshin më gjatë mbi turmë. Më shtatgjati basketbollist kërkonte më shtatgjatën punëtore. Xha Vangjeli la të shoqen me plaçkat dhe tërhoqi të birin për dore.

— Mirëmëngjesi krushk!, — buçiti pas pak zëri i tij gazmor. Le ta dëgjonte gjithë fshati!

Arta e Viktori ulën kokat. Fëmija lëshoi dorën e së motrës dhe mati me sy shtatin e të kumatit.

— Më ngjan si atëherë!, — tha Petroja. — Të kujtohet? Njëzet vjet të shkuar. Natyrisht që nuk ishim kaq shumë!

Krisi kënga. Njerëzit erdhën e u shtrënguan vetiu. Një fisarmonicist çamarrok, balukelëshuar mbi sy, u ndodh në mes të rrethit të sapokrijuar. Vallja nisi në fillim me tre djem. Më pas u duk se sheshi ishte fare i vogël dhe njerëzia u ngushtua rrugicave. Por... një çast ra qetësi. Pastaj kaloi një valë murmuritjeje e lehtë. Pak më tej, katër njerëz nxituan me një arkivol të zi mbi supe. Në të gjithë lëvizjen e tyre kishte diçka të shpejtë, të bezdisshme, si një

hije, që na bie në fytyrë atëherë, kur kemi aq dëshirë të ngrohemi në diell.

Befas plaka Stamato shkoi e i ra në sup fisarmonicistit:

— Bjeri, djalo!

Sheshi u zgjerua dhe një valle e ngadaltë përco-lli tingujt. Plaka e gjithë fshatit drodhi trupin, dhe shiritat e kuq të fustanit iu valëvitën këmbëve. Shamia i shkau nga koka dhe balli zbuloi thinjat.

Artës i shkuan morrnica nëpër trup. Shikoi Viktorin. Në vështrimin e saj lëvizi me shpejtësi një hije. «Vdiq?», — pyesnin ata sy. Viktori i buzëqeshi lehtë dhe i tregoi me sy plakën. I shtriu dorën dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u ndodhën që të dy në shpinë të gjyshes. Vallja u zgjerua edhe më...

Ishte fillimi i prillit i vitit 1967.